ISSN 1857-6443

## Korrja e grurit
Ende i paqartë çmimi grumbullues

Fq.6



## OPOZITA BOJKOTON
Parlamenti sot ratifikon marrëveshjen

Fq.3



## Sa i sigurt është Botërori në Rusi?

Fq.15




www.koha.mk

# Koha



## Peshku më i shtrenjtë në botë

Fq.10

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3392 · E mërkurë, 20 qershor 2018 · 17°c | 28°c · 15 DEN

EDITORIAL

## Nevoja për një standardizim të ligjërimit fetar



Nuk janë raste të rralla kur xhamitë në Maqedoni, Kosovë, por edhe në Shqipëri, janë shndërruar në vatra konflikti në mes të besimtarëve. Ndodhë që një grup i tyre të bojkotojë imamin e emëruar nga autoritetet zyrtare fetare, kurse grupi tjetër ta pranojë. Para dy vjetësh kishte ndodhur një ngjarje aspak e këndshme në një xhami të Gjilanit. Xhemati i kësaj xhamie ishin...

Fq.2

RAJON

## Vajza e Azem Hajdarit: Akti i shëmtuar

Fq.14

STUDIME

## Adhuruesit e filmave horror janë më të zgjuar se të tjerët!

Fq.12



### PARALAJMËROHEN KUSHTËZIME PËR INFERMIERET

# PROBLEMI NË MAQEDONI E JO NË GJERMANI



**Kuadri mjekësor nuk do të ikte jashtë vendit, sikur shteti të siguronte kushte që do të ishin përafërsisht të njëjta me vendet ku ata synojnë të shkojnë. Gjermania i ka ligjet e veta dhe nuk ka gjasa të pranojë kushtëzime nga Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë**

Fq.7

## Honoris Causa për Akademik Ferid Muratin

*Shkup, 19 qershor* - Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup ka dekoruar me Çmimin e nderit, "Honoris Causa" nobelistin me prejardhje shqiptare Akademik Ferid Murad dhe njërin prej shkencëtarëve më të famshëm në botë, posedues i shtatë licencave medicinale në Ohajo, Masachuset, Virxhina, Kalifornia dhe Teksas dhe autor i mbi 400 punimeve në rreth 150 revista prestigjioze. Për hulumtimin e thelluar të efekteve të "guanozim monofosfatit ciklik të sintetizuar me veprim enzimash", bashkë me kolegët Robert Rochford dhe Luis Ignarro, Akademik Muradi është fitues i Çmimit Nobel për mjekësi në vitin 1998. Honoris Causa (Doktor Nderi i Shkencave) është çmim që UNT e ndan për herë të parë, për çka rektori i këtij Universiteti, prof.dr. Aziz Pollozhani e konsideroi Akademik Muradin edhe si pjesë...

Fq.5



EDITORIAL

# NEVOJA PËR NJË STANDARDIZIM TË LIGJËRIMIT FETAR



Emin AZEMI

"Pyetni njerëzit e dijes për gjërat që nuk i dini" (Kur'an, En-nahl 43). Dhe njerëzit gjithmonë do të ballafaqohen me mosdijen, përderisa nuk do të vendosin të përkufizojnë se çka i bëjnë të ndjehen keq në raport me dijen kur ajo nuk është e kristalizuar. Mbase ky kristalizim nuk mund të bëhet individualisht dhe parcialisht, por në rrugë institucionale...

Nuk janë raste të rralla kur xhamitë në Maqedoni, Kosovë, por edhe në Shqipëri, janë shndërruar në vatra konflikti në mes të besimtarëve. Ndodhë që një grup i tyre të bojkotojë imamin e emëruar nga autoritetet zyrtare fetare, kurse grupi tjetër ta pranojë.

Para dy vjetësh kishte ndodhur një ngjarje aspak e këndshme në një xhami të Gjilanit. Xhemati i kësaj xhamie ishin konfrontuar fizikisht dhe ishte dashur ndërhyrja e besimtarëve të tjerë për t'i ndarë, kurse policia kishte arrestuar dy nga ta.

Shkak i konfliktit në xhaminë e Gjilanit kishte qenë falja e vakteve në mënyrë të ndarë - pasi grupi i parë përfundon namazin, duhet të hyjë grupi tjetër. Dhe do të ishte gjithçka e tolerueshme, siç thonë besimtarët, sikur konflikti të mos ishte fizik si pasojë e refuzimit të imamit të kësaj xhamie që t'i përshtatet traditës fetare.

Në sheriatin islam, janë tri veprime që janë bërë pas vdekjes së Profetit Muhamed: Tubimi i Kur'anit në një vend ( në Mus'haf ), grumbullimi dhe shkrimi i hadithеve në libra (edhe pse Profeti Muhamed e kishte ndaluar shkrimin e hadithеve gjatë jetës së tij), dhe themelimi i medh'hebeve (shkollave juridike), që janë katër - Hanefij, Malikij, Shafi'ij dhe Hanbelij

Sikundër dihet, këto shkolla juridike nuk kanë ekzistuar në kohën e Profetit Muhamed dhe as në kohën e sahabëve (shokëve të tij), sepse besimtarët në atë kohë për cdo çështje i drejtoheshin vet Profetit, kurse pas vdekjes së tij sahabëve. Mirëpo me kalimin e kohës, Islami filloi ti zgjerojë kufijtë e tij edhe jashtë siujdhesës Arabike. Popuj e fise të ndryshme filluan t'i adaptohen doktrinës së këtij religjioni, mirëpo ky proces nuk kaloi pa probleme dhe për pasojë lindi nevoja e formimit të shkollave juridike, si përgjigje ndaj çështjeve e dilemave që nuk ishin të precizuara në Kur'an. Zakonisht këto dilema ndërlidheshin për çështje dytësore e jo thelbësore, por që shkaktonin konfuzion dhe përplasje të shumta mendimesh e qëndrimesh.

Dijetarët e ndryshëm islamë kanë pajtueshmëri të plotë në mes tyre kur konstatojnë se shkollat juridike (Medh-hebet) janë sikurse një pemë me katër degë të cilat ushqimin e tyre e marrin nga një rrënjë,dhe rrjedhimisht argumentet dhe fetvat e tyre i marrin nga të njëjtat rrënjë apo nga një burim, dhe ai burim është Kur'ani dhe hadithet e Profetit Muhamed.

Nëse me shkollat juridike nënkuptohet shumësia e dallimeve që kishin dijetarët në kuptimin e çështjeve të sheriatit, të cilat nuk kishin argumente të prera nga Kurani apo hadithi, por në përmbajtjen e tyre mund të kishte më tepër se një kuptim, atëherë shtrohet një pyetje shumë esenciale që i përket rrethanave tona: Sa këto shkolla juridike mund të jenë burim konfliktesh e përçarjesh, nëse hoxhallarë të ndryshëm, të shkolluar në vende të ndryshme arabe, për një çështje të caktuar japin më shumë interpretime. Kjo aq më tepër kur divergjencat apo mospajtimet janë baza kryesore e shkollave juridike islame, e që nuk kanë të bëjnë aspak me bazat e besimit islam, por vetëm me legjislaturën, apo praktikën e saj në jetën e përditshme.

Rrethanat historike, sociale e psikologjike kur u themeluan këto shkolla juridike shpiejnë në arsyeshmërinë logjike të ekzistimit të tyre për të ruajtur unitetin brendafetar të myslimanëve para më shumë se 1000 vjetëve. Por edhe gjeografia dhe diversitti fisnor e etnik i muslimanëve para më shumë se 1000 vjet, ishte një ombrellë e mjaftueshme që kapërthente brenda vetes të gjitha këto shkolla juridike, me të gjitha nuancat dhe divergjencat e mundshme të tyre.

Tani, në rrethnata tona, në një gjeografi kaq të ngushtë, pa ndonjë diversitet etnik, cili është funksioni dhe kapaciteti absorbues i gjithë këtyre shkollave juridike dhe a mund të bëhet një standardizim (unifikim) i normave e rregullave juridie islame, duke marrë prej të gjithave vlerat më fundamentale, brenda një program unik, i cili do t'iu shërbente teologëve të ndryshëm ta interpretojnë Islamin pa patur nevojë të na japin interperetime të ndryshme se është apo jo, bie fjala, e lejueshme të martohesh me vajzën e axhës. Ose, është apo jo haram të festuarit e ditëlindjes?!

"Pyetni njerëzit e dijes për gjërat që nuk i dini" (Kur'an, En-nahl 43). Dhe njerëzit gjithmonë do të ballafaqohen me mosdijen, përderisa nuk do të vendosin të përkufizojnë se çka i bëjnë të ndjehen keq në raport me dijen kur ajo nuk është e kristalizuar. Mbase ky kristalizim nuk mund të bëhet individualisht dhe parcialisht, por në rrugë institucionale, me çka juripsrudenca islame do të standardizohej si një kod i përbashkët ligjërimi publik. Gjithçka tjetër që të asocon në polisemantikë interpretimesh, krijon terren të përshtatshmëm për hasmëri, përçarje dhe largim(ftohja) në mes veti të besimtarëve. Ky, fundja, nuk është misioni i pastër i asnjë religjioni, pra as i Islamit, por as funksioni praktik i vendosjes në një harmoni hyjnore-tokësore të veprave e vullneteve njerëzore.



**VËREJTJE DHE KËSHILLA PUBLIKE KOMENTUESIT TË TELEVIZIONIT TË MAQEDONISË**

"(Nga ndeshet Brazil-Zvicra 1:1, Suedi-Kore Jugore 1:0)
-NUK shqiptohet e shkruhet "Skuadra e Petkoviq", por "Skuadra e Petkoviqit"
Nuk shqiptohet "së bashku me Neimar" por "sëbashku me Neimarin"
Nuk shqiptohet "topi për Seferoviq" por "topi për Seferoviqin"
Nuk shqiptohet "pa problem për Jan Somer", por "...për Jan Somerin"
Nuk shqiptohet "topi për Zuber" por "Për Zuberin"(Në rast tjetër, saktë e theksonte "topi për Mirandën"!)
Nuk shqiptohet "me golin e Kolarov" por "me golin e Kolarovit"
Vërejtjet me qëllim të mirë hasën në vesh të shurdhër dhe gazetari vazhdon me të njëjtin avaz edhe në ndeshjen vijuese të ditës tjetër, prandaj po e përkujtoj se:
Nuk shqiptohet "topi për Lustig", por "...për Lustigun"
Nuk shqiptohet "për ekipin e Daevu", por "për ekipin e Daevusë"
(I njëjti thotë në rast tjetër drejtë: "Lojtari i Tokios"! Çudi si nuk e kupton se është njëjta rasë lakimi!)
"Edhe një tjetër mundësi për Berg" por "edhe një tjetër mundësi për Bergun"
P.s.Nuk do të ishte keq ky komentator të na tregonte në bazë të cilave rregulla të gjuhës shqipe vepron kështu që edhe ne t'i mësojmë!)", ka komentuar në profilin e tij në Facebook, shkrimtari dhe gazetari Daut Dauti, disa nga lëshimet më të shpeshta që i bëjnë raportuesit e ngjarjeve sportive.



**GRUSHTI I DIPLOMACISË E GODET RËNDË VMRO-në**

"Diplomacia ndërkombëtare e ka grushtin e rëndë. Këtë e ka dëshmuar edhe me zgjedhjen e datës për nënshkrimin e Marrëveshjes për zgjidhjen e kontestit për emrin e shtetit të Maqedonisë me Greqinë, 17 qershor 2018.
Udhëheqësve dhe mbështetësve të partisë nacionalshoviniste proserbe dhe proruse, OBRM-PDUKM (VMRO-DPMNE), shënimin e përvjetorëve të ardhshëm të themelimit të kësaj partie, më 17 qershor 1990 në Shkup, ua ka lidhur në fyt përmes kësaj date kur u nënshkrua marrëveshja për ndryshimin e emrit të shtetit, të cilën pjesëtarët dhe simpatizuesit fanatikë të kësaj partie e konsiderojnë si kapitullim të projektit dhe ideologjisë së tyre, përmes së cilës kanë qeverisur gjatë kohë me shtetin e Maqedonisë, nga viti 1991 deri më 2016. Historia e sajuar përmes falsifikimeve, pa argumente dhe me porosi nga jashtë, sigurisht që një ditë, herët ose vonë do të dështojë, siç kanë dështuar edhe shumë projekte të tjera politike për rritjen e ndikimit serb, grek dhe rus, për dominim dhe ekskluzivitet etnik, kulturor dhe fetar të tyre mbi rajonin e Maqedonisë", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, dr.Abdulla Memeti.

NËSE NUK E KENI DITUR...

## SA I VJETËR ËSHTË VAU I DEJËS?

Deja (ose Danja) ka qenë qytet mesjetar i ndërtuar në shekullin XI-XII në pikën ku del Drini nga malësitë. Përmendet si seli peshkopale e varur nga kryepeshkopata e Tivarit bë shekullin XI dhe si qendër e rëndësishme rrugore e doganore. Deja zotëronte rrugën e karvaneve që shkonte nga Shkodra në Prizren dhe jepte të ardhura të rëndësishme që paguheshin aty për kalimin e Vaut të Dejës. Nga fillimi i shekullit XIII qëndroi nën sundimin serb. Me formimin dhe forcimin e principatës së Balshajve Deja u mor nën kontroll prej tyre. Më 1396, Gjergji II Strazimir Balsha ia kaloi Venedikut. Në vitet 1423-1443 kaloi dy herë në dorë të osmanëve. U çlirua prej tyre në 1443. Deja është qyteti për zotërimin e të cilit u konfliktuan ashpër familjet feudale Dukagjini dhe Zaharia, konflikt që çoi në vrasjen e Lekë Zaharisë më 1445. Pas vrasjes së tij, e ëma ia dorëzoi Dejën, Venedikut. Kërkesa e Skënderbeut për ta marë në dorëzim shkaktoi luftë me Venedikun. Mbeti në duart e Venedikut deri në fillim të vitit 1479 kur u pushtua dhe u shkatërua nga osmanët. Prej atëherë nuk u rimëkëmb më.

Pas miratimit me procedurë të përshpejtuar të nevojës për propozim-ligjin për ratifikimin e marrëveshjes finale me 69 vota "pro" dhe "40", gjatë seancës së të martës propozim-ligji kaloi në Komisionin për çështje evropiane. Deputetët e opozitës nuk do të jenë prezent në këtë komision pas braktisjes në mënyrë demonstrative të seancës. Deputetët e Lidhjes Socialdemokrate dhe ato të partive shqiptare mbështetën propozim-ligjin, me përjashtim të deputetit të LSDM-së, Ferid Muhiq

OPOZITA BOJKOTON PARLAMENTIN



# SOT RATIFIKOHET MARRËVESHJA

Koha — Evis HALILI

*Shkup, 19 qershor* - Ratifikimi i marrëveshjes me Greqinë pritet të përfundojë në seancën e së mërkurës në Parlament. Pas miratimit me procedurë të përshpejtuar të propozim ligjit për ratifikimin e marrëveshjes finale me 69 vota "pro" dhe "40" gjatë seancës së të martës propozim ligji kaloi në Komisionin për çështje evropiane. Deputetët e opozitës nuk do të jenë prezent në këtë komision pas braktisjes në mënyrë demonstrative të seancës. Deputetët e Lidhjes socialdemokrate dhe ato të partive shqiptare mbështetën propozim ligjin, me përjashtim të deputetit të LSDM, Ferid Muhiq. Propozim ligji u prezantua në seancën e së martës nga ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, i cili ndër të tjera u shpreh se marrëveshja e arritur është një shans që u jepet qytetarëve për t'u deklaruar për të ardhmen e tyre në referendumin që do të zhvillohet në vjeshtë. Përpara se VMRO-DPMNE të braktiste seancën, koordinatori i grupit parlamentar, Dragan Danev e quajti marrëveshjen mes dy vendeve gjenocid dhe tentativë për të mohuar realitetin. Sipas tij ky akt kapitullimi me të cilin cenohet kushtetuta sjell ndryshimin e identitetit dhe një dëm të parikuperueshëm.

"Kjo marrëveshje është e njëanshme, me detyrime vetëm për palën maqedonase dhe jo të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Imponohet emër i ri i shtetit, si rezultat i një marrëveshje bilaterale të shantazhuar", ka thënë Danev. Ndërsa koordinatori i LSDM, Tuntev ka deklaruar se kjo marrëveshje siguron të ardhmen evropiane të Maqedonisë, që nënkupton ftesat për anëtarësim në NATO dhe BE, dhe garanton identitetin dhe gjuhën maqedonase. Lidhur me akuzat e VMRO-DPMNE se me këtë marrëveshje anulohet edhe vendimi i Tribunalit të Hagës në favor të Maqedonisë për kontestin e emrit Tuntev u shpreh se opozita është duke keqpërdorur foltoren e parlamentit. "Me këtë marrëveshje dhe shansin për referendumin i kemi dhënë mundësi qytetarëve që të vendosin vetë për të ardhmen e shtetit të tyre. Kemi në dorë shansi historik që gjeneratat e reja të ardhmen ta shohin në shtetin e tyre", ka thënë Tuntev.

Sesa do të vazhdojë bojkotimi i parlamentit nga deputetët e VMRO-DMPNE do të vendosin organet e partisë, ka thënë deputeti Antonio Milloshovski. Sipas tij kjo marrëveshje është antikushtetuese dhe poshtëruese në aspektin kombëtar. Milloshovski ka fajësuar qeverinë që i shmanget debatit për këtë marrëveshje dhe të cilin e ka propozuar me flamurin evropian për të shkurtuar procedurat dhe shmangur diskutimet. Gjatë prezantimit të ligjit ministri Dimitrov e ka arsyetuar procedurën e përshpejtuar me mundësinë që marrëveshja të ratifikohet në Këshillin e Evropës, më 28 qershor.

PROTESTË E QETË PARA PARLAMENTIT

## Pleqtë kundër emrit të ri

Shkup, 19 qershor - Rreth 100 protestues, kryesisht qytetarë të moshuar, të martën para Parlamentit të Maqedonisë në mënyrë të qetë e shprehën pakënaqësinë e tyre lidhur me ratifikimin e Marrëveshjes për ndërrimin e emrit, e cila ditë më parë u nënshkruar mes palës greke dhe asaj maqedonase. Për dallim nga protestat e ditëve më herët, ku numri i protestuesve arriti deri në 2000 qytetarë, kësaj radhe pjesë e protestës në masë të madhe ishin pensionistët. Të organizuar përmes rrjeteve sociale, protesta e ditës së martë nuk zgjati më tepër se një orë. Duke mbajtur pankartat me moton "tradhtarë" dhe "vdekje o liri", protestuesit maqedonas për të cilët i papranuar është emri "Republika e Maqedonisë së Veriut", vazhdimisht brohorisnin se kjo Qeveri duhet të jep dorëheqje për mashtrimin e madhe që i ka bërë popullit. "Kjo çka po ndodh sot është një revoltë e popullit maqedonas për zhvillimit e fundit në vendin tonë. Veprimet e fundit të Zoran Zaevit janë në kundërshtim me kushteton dhe paraqesin një përdhunim klasik të shtetit. Nënshkrimi i marrëveshje të Prespës, të cilit ne sot ia vumë flakën tregon qartë se ne nuk



jemi të barabartë me shtetin grek. Pushteti i aktual duhet ta ketë parasysh një gjë, se pas dhunës së ushtruar ditë më parë nga policia, ku mbet të lënduar shumë qytetar situatë mund të del nga kontrolli. Ata duhet të kenë të qartë se historikisht askush nuk i ka dalë përballë popullit dhe aq më pak Zaevi. Emrin dhe identitetin nuk na e kanë ndërruar me shekuj. Një skenar të tillë për një vjet në pushtet nuk do ta merr as Zaevi", tha Strasho Ollumçev, kryetar i Këshillit të përgjithshëm maqedonas. Të indinjuar, protestuesit maqedonas të martën edhe para Qeverisë vazhduan të brohorasin "Zaevi të varet në litar". Paralelisht me këto parulla, ata kërkuan nga deputetët e VMRO-DPMNE-së të japin dorëheqje nga mandati i tyre dhe t'ju bashkëngjiten protestave qytetare. Kështu, pasi Parlamenti e votoi rendit e ditës për ratifikimin e marrëveshjes me Greqi, grupi prej 100 protestuesish u nisën në drejtim të selisë së VMRO-DPMNE-së, ku edhe kërkuar takim me kryetari e kësaj partie, Hristijan Mickovski. Ndryshe, ditë më parë në rrugën "11 Tetori" para ndërtesës së Parlamentit, u regjistruan trazira të mëdha dhe incidentet mes protestuesve dhe policisë, me çka sipas protestuesve, u lënduan mbi 50 qytetarë dhe disa polici. (O.Xh)

## Marrëveshja, hap i madh për gjithë Ballkanin

*Uashington, 19 qershor* - Analisti politik Daniel Server vlerëson se marrëveshja të cilën Maqedonia e nënshkroi me Greqinë nuk është vetëm hap i madh para për të dyja vendet por edhe për gjithë Ballkanin, lajmëron korrespodenti i MIA-s nga Uashingtoni. Në deklaratë për MIA-n Server tha se nëse marrëveshja kalon edhe në dy parlamentet dhe në referendumin në Maqedoni "kjo do ta përmirësojë stabilitetin dhe do ta bëjë rajonin më atraktiv për investuesit e huaj". "Mbetën edhe dy çështje të rëndësishme lidhur me luftën dhe paqen e Ballkanit, ajo është normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe përpjekjet që të krijohet shtet funksional në Bosnje. Ju jeni shumë afër fundit të procesit për vendosjen e paqes në rajon se sa që janë në fillim", theksoi Server. Daniel Server është profesor në universitetin Xhon Hopkins në Uashington. Ai është ish-përfaqësues amerikan në Bosnje në rolin e ndërmjetësuesit ndërmjet kroatëve dhe boshnjakëve në bisedimet për Marrëveshjen Paqësore të Dejtonit. Për momentin e udhëheq programin për menaxhim me konflikte të universitetit dhe në vitet e fundit ishte shumë kritikues ndaj BE-së dhe bënte thirrje për përshpejtim të procesit të eurointegrimit të vendeve si Maqedonia, Bosnja dhe Kosova.

## Negociatat me BE-në do t'i ndajmë me miqtë tanë

Prishtinë, 19 qershor - Maqedonia ka fituar përvojë të jashtëzakonshme përmes aktiviteteve shumvjeçare në kuadër të procesit për Stabilizim-Asocim me Bashkimin Evropian, ndërsa në periudhën e ardhshme, me fillimin e negociatave me Unionin Evropian këto përvoja do të shumfishohen, deklaroi zëvendëskryeministri i Republikës së Maqedonisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani në takimin e djeshwm në Prishtinë me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Enver Hoxhaj. "Si fqinjë më të afërt me kënaqësi këto përvoja do ua përcjellim kolegëve tanë nga Kosova, me qëllim të përshpejtimit dhe progresin e perspektivave Evropiane në tërë rajonin", theksoi Osmani, duke shtuar se së shpejti pritej një takim i përbashkët Qeveritar mes dy vendeve, si sinjal i veçantë i marrëdhënieve të mira mes dy vendeve. Bashkëbiseduesit theksuan angazhimin e dy vendeve për perspektivat evropiane të rajonit, sepse është në interes të përbashkët përkrahja e ndërsjellë në procesin e integrimeve në BE. Si dëshmi e këtij suksesi fqinjësor, ata e theksuan edhe vendosjen e gurëthemelit të përbashkët të dy shteteve, më saktë vendosjen e gurëthemelit në vendkalimin e përbashkët Bellanoc-Stançiq, ndërsa edhe shprehën kënaqësi për progresin e ndërtimit të rrugës Shkup - Bllacë, projekt ky që së bashku me autostradën Prishtinë - Bllacë, ndërtimi i së cilës është në vijim do të shkurtoj udhëtimin mes Shkupit dhe Prishtinës nga dy orë në më pak se një orë. Paraprakisht, zëvendëskryeministri Osmani realizoi takim edhe me kryetarin e Kosovës, Hashim Thaqin, ku u bisedua për perspektivat e të dy vendeve në gjithë Ballkanin Perëndimor, si dhe për pritjen e samiteve të ardhshme të Bashkimit Evropian.

Në takim, siç kumtoi shërbimi qeveritar për shtyp, të dy palët kanë shprehur kënaqësi nga nënshkrimi i marrëveshjes për zgjidhje të kontestit të Maqedonisë dhe Greqisë për emrin dhe për partneritetin strategjik, duke e vlerësuar si të dobishëm jo vetëm për të dy vendet, por edhe për rajonin

ZAEVI OPTIMIST NË IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJES ME GREQINË

# TA SHFRYTËZOJMË MOMENTIN PËR JETË MË TË MIRË



*Shkup, 19 qershor* - Kryeministri Zoran Zaev priti delegacionin e Zyres për shërbime të projekteve të Kombeve të Bashkuara (UNOPS) kryesuar nga zëvendësja e sekretarit të përgjithshëm të KB-së dhe drejtoreshë ekzekutive e UNOPS-it, Greta Faremo. Në takim, siç kumtoi shërbimi qeveritar për shtyp, të dy palët kanë shprehur kënaqësi nga nënshkrimi i marrëveshjes për zgjidhje të kontestit të Maqedonisë dhe Greqisë për emrin dhe për partneritetin strategjik, duke e vlerësuar si të dobishëm jo vetëm për të dy vendet, por edhe për rajonin.

Drejtoresha e UNOPS, duke cekur se është krenare që ka takim me kryeministrin e Maqedonisë në ditë historike, e transmetoi mbështetjen e fuqishme nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Zyra për Shërbime Projektuese e Kombeve të Bashkuara (UNOPS) për rrugën e Maqedonisë për aspiratat euroatlantike. Faremo theksoi se posaçërisht është e kënaqur që me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, kanë këmbyer letra për hapjen e Zyrës projektuese të UNOPS-it në Shkup, që do të thotë rritje e bashkëpunimit në sigurimin e shërbimeve në infrastrukturën e qëndrueshme, furnizimet e qëndrueshme dhe menaxhimin e qëndrueshëm me projekte, të cilat përfshijnë ndërtim të shkollave, rrugëve, urave dhe spitaleve, si dhe furnizim të mallrave dhe trajnim të personelit lokal. Në takim, kryeministri Zaev e theksoi rolin e UNOPS-it si partner i rëndësishëm për zhvillimin e Maqedonisë, i cili në realizimin e misionit të vet mbështetë projekte në infrastrukturë, furnizime, menaxhmentin financues dhe resurset njerëzore.

Ai e ceki rëndësinë e jashtëzakonshme të UNOPS-it në këmbimin e praktikave më të mira për reformat të cilat Maqedonia tashmë i ndërmori për sigurimin e fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian.

Kryeministri Zaev dhe përfaqësuesja e UNOPS-it u dakorduan se me rëndësi të jashtëzakonshme është realizimi i projektit qeveritar të vendosjes së Garancës për të rinj, si masë për rritje të punësimit të të rinjve, posaçërisht në mjediset rurale, ku tashmë po realizohen projekte infrastrukturore të cilat do ta përmirësojnë standardin e të rinjve, por edhe do t'i bëjnë konkurrentë në tregun e punës. *(E.H)*

## Mungesa e Alimit e anuloi seancën për "Titanik 3"



*Shkup, 19 qershor)* - Për shkak të pjesëmarrjes së obligueshme të deputetit Ejup Alimi në seancë parlamentare, dje nuk u mbajt seanca gjyqësore për lëndën "Titanik 3". Seanca e re gjyqësore është caktuar për më 28 qershor, kur dëshmitarët e rastit duhet të japin deklarata para Gjykatës. I akuzuari Alimi, i cili është deputet në Kuvendin e RM-së, e ka informuar gjykatën se duhet të marrë pjesë në seancën e djeshme për ratifikim të marrëveshjes për emrin ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. Në lëndën "Titanik 3" të akuzuar janë Ejup Alimi dhe Ismet Guri, sepse si anëtarë të Komisionit Komunal Zgjedhor në Çair "kanë shkatërruar material zgjedhor". Të akuzuarit në seancën paraprake thanë se e kuptojnë aktakuzën që e prezanton prokurorja Fatime Fetai, por se nuk ndjehen fajtorë. Sipas PSP, të dy të akuzuarit me veprimet e tyre drejtpërdrejtë të ndikojnë në rezultatin zgjedhor dhe kanë pasur instinkt kriminel që të falsifikojnë vullnetin zgjedhor të banorëve të Çairit me qëllim që ta realizojnë fuqinë politike. Avokatët e të akuzuarve para Gjykatës janë shprehur se me më shumë fakte gjatë procedurës do të dëshmojnë se klientët e tyre nuk janë fajtorë, si dhe se në momentin kontestues të aktakuzës nuk kanë pasur kurrfarë funksioni me çfarë do të ndikonin për të kryer vepra penale për të cilat i akuzon PSP-ja.

## Me Marrëveshjen më pak qytetarë do të ikin nga shteti

*Shkup, 19 qershor* - Krizat migruese duhet të ndërpresim t'i shohim si probleme momentale, me të cilat përballemi sot, e me shpresë se do të ndalen nesër. Ato u bënë përditshmëri e jona dhe sipas të gjitha analizave, konsiderohen si një nga fenomenet kyçe që do të ndikojë ndaj stabilitetit të botës, porositi ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në hapjen e Shkollës verore ndërkombëtare të quajtur "Menaxhim në kushte të krizës migruese". "Kur Maqedonia u gjet në rutë të tillë ]të refugjatëve dhe kur shpërthyen trazira në Lindjen e Afërt, por edhe kur valës migruese i'u bashkangjitën njerëz të cilët kanë vendosur ta ndërrojnë vendin ku jetojnë për arsye ekonomike, ne pamë çka do të thotë të ndërtoni institucione të cilat do të përballen me këtë krizë migruese. Si shtet u ballafaquam me sfidën, por qartë është se duhet t'i zhvendosim prioritetet tona drejt shkathtësive të cilat më parë nuk i kemi pasur", theksoi Shekerinska. Në fjalorin e krizës migruese, siç tha ministrja e Mbrojtjes, Shekerinska përkujtoi kur para dy ditësh ajo me kryeministrin dhe disa ministra tjerë në Liqenin e Prespës me barkë e cila nuk ka qenë e mbingarkuar me sukses arritën në fshatin grek Psarades. Sipas saj, marrëveshja është vendim i vërtetë sepse, siç tha, nënshkrimi i kësaj marrëveshje do të thotë se më pak bashkëqytetarë do të ikin nga ky shtet dhe do të kërkojnë ekzistencë në vende tjera. Theksoi se kjo marrëveshje do të thotë integritet më të madh dhe më shumë mundësi për të rinjtë në Maqedoni, por edhe se i jep mundësi rajonit në kohën kur tërë bota konstaton se siguria sërish është kthyer si pikë e parë në rend të ditës. Shkolla verore, sipas organizatorëve të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" nga Shkupi, ka për qëllim të ndikojë në rritjen e kapaciteteve të shkathtësive të përhershme dhe kompetencave të pjesëmarrësve në program dhe në krijimin e mekanizmave të rinj për koordinim dhe menaxhim.

## Jankullovska do të gjykohet ndaras, Mijallkovi thirret në amnistinë e Ivanovit



*Shkup, 19 qershor* - Gjykimi për lëndën e PSP-së "Target-Fortesa", do të vazhdojë pas pushimeve, më 31 gusht kur këshilli gjyqësor do të deklarohet sipas propozimeve të cilat dalin nga vendimi i Gjykatës Supreme në Athinë për heqjen e paraburgimit të ekstraduar për të akuzuarit Goran Grujevski dhe Nikolla Boshkovski.

Prokurorja e PSP-së, Lençe Ristoska, propozoi procedura për Grujevskin dhe Boshkovskin të ndahet, me provë se e kanë dorëzuar propozimin për ndarje të procedurës së tyre dhe duke i marrë parasysh deklaratat e nxjerra dje. Këshilli gjyqësor në drejtim të ekonomizimit vendosi që procedura kundër Boshkovskit dhe Grujevskit të ndahet dhe të vazhdojë kundër të akuzuarve tjerë në këtë rast. Paraprakisht këshilli gjyqësor e ndau edhe procedurën për ish ministren Gordana Jankullovska, sepse është në muajin e nëntë të shtatzënisë. Avokati Lupço Shvërgovski paralajmëroi se pas marrjes së vendimit me shkrim nga Gjykata greke dhe përderisa ajo bazohet në aktin për amnisti të presidentit Gjorge Ivanov, do ta propozojë klientin e tij Sasho Mijalkov, i cili ishte amnistuar nga presidenti, e njëjta të vlejë edhe për të. "Të drejtat e fituara post festum nuk mund të pezullohen as me Ligjin për amnisti. Nëse i marrim parasysh këto aspekte, ndërsa vendimi i gjykatës në Greqi se është pranuar në tërësi dhe ka të bëjë para se gjithash me amnistinë si të vetëm dhe të parevokueshëm, vjen në përfundim se tërësisht është realizuar që procesi gjyqësor të ndërpritet", tha Shvërgovski. Për këto arsye, Shvërgovski propozoi që Gjykata të sjellë vendim prejse mbrojtja do të disponojë me vendim të shkruar nga Gjykata greke dhe përderisa përputhet me tezën e mediave, atëherë të sjellë vendim që procedura kundër Sasho Mijalkovit të ndërpritet. Prokurorja Ristoska në raport të propozimit për ndërprerje të procedurës tha se Kodi penal parasheh kushte nën të cilat mund të ndërpritet procedura dhe se ato nuk janë plotësuar. Në raport të kërkesës për anulim të seancës së djeshme, Ristoska tha se me pikëpamje të procedurës së ndarë kundër Boshkovskit dhe Grujevskit, vendimi i Gjykatës në Athinë nuk ka kurrfarë vlere për këtë procedurë.

Avokati Petar Vasilev deri te Gjykata e dorëzoi vendimin e Gjykatës Supreme në Athinë për heqjen e paraburgimit të ekstraduar për Grujevskin dhe Boshkovskin.

*(O.Xh)*

UNT DEKORON NOBELISTIN SHQIPTAR

# HONORIS CAUSA PËR AKADEMIK FERID MURATIN

"Dua ta dini se vendi i të parëve tuaj mburret me ju. Jeni qytetar nderi i Komunës së Çairit, një institucion shëndetësor në Gostivar mban emrin tuja, Doktori Nderi i Shkencave në UEJL, tani edhe në UNT. Gjithë kjo është shprehje e respektit për kontributin tuaj të çmuar", u shpreh ministri i Arsimit, Arbër Ademi. Ai, i kërkoi Akademik Muradit të vizitojë më shpesh Maqedoninë, që "të na motivojë dhe të na sugjerojë rrugët kah duhet të shpijmë dijen, shkencën dhe inovacionin"



Koha — Laura PAPRANIKU

*Shkup, 19 qershor* - Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup ka dekoruar me Çmimin e nderit, "Honoris Causa" nobelistin me prejardhje shqiptare Akademik Ferid Murad dhe njërin prej shkencëtarëve më të famshëm në botë, posedues i shtatë licencave medicinale në Ohajo, Masachuset, Virxhina, Kalifornia dhe Teksas dhe autor i mbi 400 punimeve në rreth 150 revista prestigjioze. Për hulumtimin e thelluar të efekteve të "guanozim monofosfatit ciklik të sintetizuar me veprim enzimash", bashkë me kolegët Robert Rochford dhe Luis Ignarro, Akademik Muradi është fitues i Çmimit Nobel për mjekësi në vitin 1998.

Honoris Causa (Doktor Nderi i Shkencave) është çmim që UNT e ndan për herë të parë, për çka rektori i këtij Universiteti, prof.dr. Aziz Pollozhani e konsideroi Akademik Muradin edhe si pjesë të themelimit të UNT-së. Duke u ndërlidhur me sistemin e brishtë arsimor në gjuhën shqipe në Maqedoni, Pollozhani tha se megjithatë ne nuk mund ta quajmë veten si të pafat.

"Nuk mund të jetë pa fat një popull që ka nxjerrë dy figura si Nënë Tereza dhe Ferid Murati, puna dhe vepra e të cilëve i ka shërbyer dhe do ti shërbej çdo herë njerëzimit", nënvizoi Pollozhani dhe shtoi se nuk është e rastësishme që një universitet si UNT-ja, që mban emrin e një nobeliste të lindur në Shkup, nderon me Çmimin "Honoris Causa" një shkencëtar dhe një nobelist të lindur gjithashtu në Maqedoni, fakti që të dy janë shqiptarë dhe që për më tepër nuk e kanë fshehur asnjëherë përkatësinë e tyre kombëtare, na bën ende më krenarë.

"Jam i sigurt se studentët tanë përveç nderimit dhe vlerësimit për arritjet shkencore që lidhen me emrin e nobelistit tonë, te shëmbëlltyra e Ferid Muradit, lehtësisht do të shohin edhe modelin e një njeriu që me punë dhe përkushtim të pashoq, me prindër të lindur në Llakavicë të Gostivarit ka arritur në majat e shkencës botërore. Historia e dr.Muradit motivon dhe kujton gjithmonë se në këtë botë të globalizuar, me punë dhe përkushtim çdo gjë është e realizueshme", u shpreh Pollozhani.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, tha se nuk ka asnjë dyshim që çmimi që i ndahet prof.dr. Muradit është mesë i merituara, ashtu sikurse janë të merituara të gjitha titujt dhe vlerësimet që i janë bërë në botë.

"Por, dua ta dini, se vendi i të parëve tuaj mburret me ju. Jeni qytetar nderi i Komunës së Çairit, një institucion shëndetësor në Gostivar mban emrin tuja, Doktori Nderi i Shkencave në UEJL, në Universitetin e Tiranës, tani edhe në UNT. Gjithë kjo është shprehje e respektit për kontributin tuaj të çmuar. Dhe, të jeni të bindur se sukseset tuaja u gëzohemi sikurse të jenë edhe tonat", u shpreh ministri Ademi duke kërkuar nga dr. Muradi që ta vizitojë më shpesh Maqedoninë, për të na motivuar dhe për të na sugjeruar rrugët kah duhet të shpijmë dijen, shkencën dhe inovacionin dhe për të kontribuar me komentet tuaja në përcaktimin tonë për reformimin cilësor të arsimit në vend. Me këtë rast, Ademi tha se gjëja më e mirë që kishte vendosur të bëjë për profesor Muradin ishte ti jep fjalën me gjithë përgjegjësinë e postit që mban, se zotohet "që do të angazhohem maksimalisht për të ndjekur shembullin tuaj, të punës me përkushtim e zell, për ta avancuar sistemin arsimor, veçanërisht shkencën, të cilës ju ia përkushtuat një jetë të tërë e, pa zhvillimin e së cilës nuk mund të ketë përparim asnjë shoqëri", u shpreh Ademi.

Prof.dr. Ismail Murtezani, recensenti dhe kryetari i Komisionit për ndarjen e çmimit Honoris Causa, nga ana e UNT-së tha se Akademik Ferid Muradi ka qenë dhe është anëtarë i më shumë se 100 komiteteve ose institucioneve hulumtuese nga mbarë bota, anëtarë i disa dhjetëra komiteteve universitare medicinave, udhëheqës dhe bashkudhëheqës i një numri të madh të projekteve hulumtuese dhe autor i shtatë patentave me rëndësi të madhe. Në pritej për tu shtypur janë edhe 40 publikime shkencore, krahas 400 të botuarave deri tani në revistat më prestigjioze botërore.

"Veprimtaria hulumtuese dhe shkencore e profesorit është aq e madhe sa edhe për dimensionet botërore shënon produktivitet shumë të lartë, ndërsa për kushtet tona fascinuese", u shpreh prof. dr. Ismaili. Nëse me lejohet të bëjë lojë numrash, plotësoi më tej ai, laureati ynë, përmendet si autor (referencë shkencore) në mbi 1500 publikime me kontribute të mëdha shkencore.

## Blegtoria, cak i biznesmenëve turq e kroat

*Gostivar, 19 qershor* - Një delegacion i biznesmenësh kroat dhe turq, vizitoi sot Komunën e Gostivarit me ç'rast u pritën nga kryetari i komunës së Gostivarit, Arben Taravari dhe bashkëpunëtorët e tij, njofton Shërbimi për informim i kësaj Komune. Biznesmenët kroat dhe turq ia shpalosën kryetarit Taravari interesimin e tyre për investime konkrete në sferën e blegtorisë në territorin e komunës së Gostivarit. Kryetari Taravari i njoftoi biznesmenët se ai dhe administrata komunale janë të gatshëm, që të ofrojnë asistencë të plotë dhe gjithçka është në ingerencë të Komunës, kur bëhet fjalë për investime serioze që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe në zbutjen e papunësisë. Biznesmenët kroat dhe turq, gjatë qëndrimit të tyre në Gostivar bëjnë hulumtim të terrenit, me ç'rast i ata do të shoqërohen edhe nga të punësuarit në administratën komunale të cilët merren me çështje të investimeve të huaja.

# KRONIKË

## Arrestohet i kërkuari për vuajtje të dënimit

Të hënën mbrëma rreth orës 21 e 40 minuta, në rrugën e "Lubotenit" në afërsi të tregut të kafshëve, gjatë kontrollit të veturës "Audi A6" me targa të Tetovës, është legjitimuar personi B.A. (23) nga fshati Poroj-Tetovës, ku gjatë kontrollit në evidencat qendrore, është konstatuar se i njëjti është në kërkim për vuajtje të dënimit me burg, dhe pa asnjë problem është arestuar në Stacionin policor Tetovë.në mesnatë pas dokumentimit të rastit, i njëjti është dorëzuar në burgun e Tetovës, për vuajtjen e dënimit.

## Rrahje për mosmarrëveshje në trafik

Të hënën rreth orës 11 e 50, në bulevardin "Blagoja Toska" në afërsi të rrethrotullimit, 32 vjeçari I.R. nga fshati Kamnjan-Tetovë, ka paraqitur sulm fizik ndaj tij, nga ana e 62 vjeçarit H.Q. nga Tetova, i cili pas një zënke verbale, lidhur me mosmarrëveshje për përparësi kalimi në trafik, e ka sulmuar edhe fizikisht duke e grushtuar disa herë në pjesën e kokës dhe fytyrës,.Sipas policisë i sulmuari në vetëmbrojtje i është kthyer në të njëjtën mënyrë, sulmuesi gjithashtu ka dëmtuar edhe xhamin e makinës, ku disa kalimtarë të rastit i kanë ndarë dhe të sulmuarin njëri prej tyre e ka dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, për ndihmë mjekësore. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit dhe do të inicohen padi adekuate.

## Aksidentohet 11-vjeçari nga Tetova

Të hënën mbrëma rreth orës 19.00, në rrugën "Blagoja Toska" në afërsi të stadiumit në Tetovë, ka ndodhur një aksident trafiku, ku vetura e tipit "Fiat punto" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 65 vjeçari Ll.Z. nga Tetova, është aksidentuar me biçikletë e tipit Lial e drejtuar nga 11-vjeçari nga Tetova. Lëndime trupore gjatë aksidentit ka marrë 11 vjeçari, i cili me veturë tjetër është dërguar në spitalin klinik të Tetovës dhe marrjes së ndihmës mjekësore është lëshuar për shërim në shtëpi. Pas kryerjes së hetimeve, punohet në zbardhjen dokumentimin si dhe konstatimin e shkakut për ndodhjen e këtij aksidenti.

## 207 shoferë në Shkup kanë parkuar gabimisht

Dyqind e shtatë shoferë në mënyrë të parregullt i kanë parkuar automjetet e tyre për shkak të së cilës janë gjobitur gjatë 24 orëve të fundit në rajonin e Qytetit të Shkupit. Nga SPB Shkup sot informojnë se automjetit special "karrotrec" ka larguar 58 automjete. Sipas buletinit të policisë, kanë ndodhur 11 aksidente nga të cilat në pesë janë lënduar më lehtë 11 persona. Në gjashtë aksidente është shkaktuar dëm material. Me shpejtësi më të madhe nga e lejuara kanë lëvizur 58 shoferë, ndërsa gjashtë kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit. Trembëdhjetë shoferë kanë drejtuar automjetin me makinë para se ta marrin të drejtën për drejtim të automjetit, ndërsa janë përjashtuar nga trafiku edhe dy shoferë fillestarë. Me patentë shoferë të skaduar kanë drejtuar automjetin 15 shoferë, ndërsa dy janë përjashtuar nga trafiku për shkak të automjeteve teknikisht të parregullta. *(U.H)*



NË PRAG TË FUSHATËS SË KORRJE-SHIRJEVE

# ENDE I PAQARTË ÇMIMI GRUMBULLUES

**Federata e Fermerëve të Maqedonisë kërkon që çmimi minimal blerës i grurit të jetë 12 denarë për kilogram, ndërsa marrëveshjet me shkrim lidhur me çmimin dhe afatet, të kontraktohen para vetë korrjes. Kërkohet gjithashtu që shteti të realizojë grumbullim intervenues të grurit para 1 korrikut. Sivjet, pas një pranvere plotë me shi, pritet të ketë rendimente të grurit prej së paku 200 mijë tonë që do të krijojë edhe tepricë në treg**

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 19 qershor* - Disa javë para korrjes së grurit, ende mbetet i paqartë çmimi grumbullues i kësaj kulture të rëndësishme bujqësore. Bujqit vlerësojnë se çmimi i grurit duhet të jetë së paku 12 denarë për kilogram, ndërsa presin që edhe shteti të inkuadrohet përmes rezervave shtetërore në grumbullimin e grurit.

Nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë kërkojnë që çmimi minimal blerës i grurit të jetë 12 denarë për kilogram, ndërsa marrëveshjet me shkrim lidhur me çmimin dhe afatet të kontraktohen para vetë korrjes, sipas Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural. Gjithashtu kërkohet që shteti të realizojë grumbullimin intervenues të grurit para një korrikut , kur edhe fillon korrja.

**MIELLI NGA SERBIA KRIJON PROBLEME**

Nga ana tjetër, mullisët thonë se nëse mbetet rregullorja e tanishme që ju konvenon eksportuesve serb të miellit, ato sivjet nuk do të blejnë grurin nga korrjet e begatshme të këtij viti, ose do të blejnë vetëm sipas nevojave dhe çmimit të tregut. Mullisët thonë se grumbullimi i grurit vendor vështirësohet për shkak se në Maqedoni po hyn mjaft miell nga Serbia dhe po krijohen rezerva të mëdha. Gjithashtu ata nuk mund të sigurojnë mjete për grumbullim dhe të jenë konkurrues me çmimin e tyre grumbullues të lëndës së parë, nuk mund të krijojnë vlerë të shtuar që do të mbulojë harxhimet dhe të ofrojnë çmim konkurrues në raport me miellin serb.

Nga Ministria e Bujqësisë thonë se me ligj do të publikojnë atë që e kanë obligim ta ndjekin përmes sistemit unik informativ të tregut.

"Ne jemi kompetent të ndjekim çmimin prodhues të të gjithë prodhimeve bujqësore, që ua kumtuam edhe grumbulluesve, edhe prodhuesve, që ka hasur në pëlqimin e tyre. Kur do të kemi nga sistemi të gjitha përllogaritjet, do të shpallim edhe çmimin prodhues", theksoi ditë më parë ministri i Bujqësisë, Ljupço Nikollovski. Sipas tij, në periudhën e ardhshme, nëse ka nevojë në bashkëpunim me prodhuesit dhe mullistët, do të miratohen edhe masa të tjera shtesë.

**RRITJA E RENDIMENTEVE, UL ÇMIMET E MIELLIT NGA IMPORTI**

Në ndërkohë , bujqit thonë se masat me të cilat në vitet e kaluara subvencionohej magazinimi i grurit nëpër silose, nuk janë adekuat dhe nuk ka sjellë më shumë efekte, për shkak se në një vit kur kemi rendimente të bollshme të grurit në shtet dhe rajon, priten edhe çmime më të ulëta nga shtetet prej ku importojmë miell të lirë. Tani mbetet që në takimet e radhës që të kërkohet kompromisi i mundshëm pasi mullisët u deklaruan se nëse mbetet rregullorja e tanishme që ju konvenon eksportuesve serb të miellit, ato sivjet nuk do të blejnë grurin nga korrjet e begatshme të këtij vit, ose do të blejnë sipas nevojave dhe çmimit të tregut. Mullisët kërkojnë të mbetet në fuqi rregullorja për banderolat gjatë importit të miellit, ndërsa të njëjtat të ngjiten në Maqedoni, të regjistrohen tregtarët, të magazinohet malli, të analizohet cilësia dhe tek më vonë që malli të lëshohet në qarkullim.

Sivjet pas një pranvere plote me shi pritet që të ketë rendimente të grurit prej së paku 200 mijë tonë që do të krijojë edhe tepricë në treg. Sipas Federatës së Fermerëve të Maqedonisë brengos lajmi se mullisët nuk do të realizojnë grumbullimin e grurit, nëse nuk kthehet rregullorja e vjetër e banderollave për miellin importues. Fermerët vlerësojnë se kjo mund të jetë një manipulim i mundshëm, që sërish të grumbullohet gruri me çmime më të ulëta, ngjashëm si në vitet e kaluara kur çmimi grumbullues lëvizte prej 7 deri 10 denarë për kilogram, ndërsa çmimi prodhues rritet dhe lëviz prej 9-12 denarë për kilogram.

Ndryshe, para dy vitesh shteti intervenoi me 6000 denarë për hektar, apo dy denarë shtesë subvencion për kilogram për bujqit që kanë paraqitur prodhimin, si mbështetje për prodhimtari të qëndrueshme dhe për mbjellje edhe në vitin e ardhshëm . Kjo ishte një nga masat me të cilat shteti ndihmoi që fermerët të fitojnë së paku 11 denarë për kilogram të grurit të bukës,pas paralajmërimit të mullisëve në vitin 2016 se do të grumbullojnë çmimin me më së shumti tetë denarë për një kilogram.

## Deri në fund të muajit tender për aviokompani me buxhet të ulët

*Shkup, 19 qershor* - Deri në fund të muajit pritet të shpallet tenderi për subvencionim të aviokompanive me buxhet të ulët. Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, deklaroi se subvencionimi vazhdon dhe se përpjekja është që shumë fluturime do të drejtohen në aeroportin e Ohrit. "Do të mund të paraqiten të gjitha aviokompanitë të cilat janë të interesuara që do të thotë se vazhdojmë me subvencionimin e kompanive me buxhet të ulët me fokusim drejt aeroportit të Ohrit", theksoi Sugareski. Ai nuk donte të zbulojë shumë detaje rreth kritereve në tender, por pritet të bëhen përmirësime të modelit të subvencionimit. Këtë muaj skadon marrëveshja për subvencionim të nënshkruar me aviokompaninë me buxhet të ulët "Wizz Air".

## Pesë milionë euro dëm nga moti i keq

*Shkup, 19 qershor* - Pesë milionë euro, aq sipas vlerësimit të parë të bujqve, janë dëmet nga moti i keq, që e përfshiu javën e kaluar rajonin e Ovçe Poles. Bujqit presin dëmshpërblim dhe apelojnë që shteti urgjentisht ta kthejë sistemin e mbrojtjes nga breshëri. Për sot në Novosellë, drejtpërdrejtë në terren, u caktua takim me përfaqësues të vetëqeverisjeve lokale nga Velesi, Sveti Nikolla dhe Llozova. Në takimin do të marrë pjesë edhe zëvendësministri i këtij resori, Bllage Cvetkoviq. "Ne presim dëmshërbime, por varet se si do ta 'shpallin' motin e keq. Dëmi faktikisht është bërë, moti i keq është punë natyre, ndërsa raketa për shkatërrimin e breshërit nuk ka, gjë që është dobësia më e madhe dhe nuk duhet asnjë sekondë të mendohet për kthimin e tyre, duke e marrë parasysh teknologjinë e re. Sot në Novosellë, në vendin e ngjarjes do të shihen dëmet dhe do të merremi vesh se si dhe kur do të bëhet vlerësimi, pasi një pronar mund të ketë në më shumë komuna. Po ashtu ka edhe njerëz me nga 700-800 hektarë", deklaroi për MIA-n kryetari i Asociacionit të bujqve, Eftim Shaklev. Nga moti i keq të mërkurën më së shumti kanë pësuar kulturat e drithërave, vreshtat, pemët dhe kopshtaria, por janë shkaktuar edhe dëme materiale. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, e cila e konfirmoi takimin e sotëm, komisionet për vlerësim të vetëqeverisjeve lokale veçmë janë formuar dhe sot duhet të dalin në terren. Të reshurat e fuqishme të ndjekura me breshër dhe bubullima kanë përfshirë rreth 5.000 hektarë sipërfaqe, nga kodra e Velesit deri në Cërnilishtë, Sveti Nikollë.

## Akoma s'dihet sa do të kushtojë autostrada Kërçovë-Ohër

*Shkup, 19 qershor* - Ende nuk dihet sa plotësisht do të kushtojë ndërtimi i autostradës Kërçovë-Ohër. Për momentin negociohet për aktivitete shtesë të cilat nuk kanë janë parapa rë me projektin siç janë qarkoret, rrugët anësore dhe përfundimi i tunelit. Drejtori i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore Zoran Kitanov pret se rreth një muaji do të dihet sa saktësisht mjete do të nevojiten për ndërtimin e kësaj autostrade. "Nëse punojmë sipas projektit ashtu siç është, nuk më duhen aq shumë para, por rruga do të jetë e papërdorshme. Duhet të ndërtojmë minimum te qarkore të cilat do t'u shërbejnë njerëzve nga Kërçova deri në Ohër. Siç tani është projektuar rruga, nga Kërçova deri në Ohër nuk do të mund as të ngjiteni, as të zbrisni. Patjetër të ketë rrugë servisore", deklaroi Kitanov. Do të kërkohet edhe nga Parlamenti të ricaktohen nga njëra në tjetër zë 220 milionë euro nga huaja nga Banka Eksim të cilat tani qëndrojnë në dispozicion, por nuk mund të shfrytëzohen. Sipas vlerësimeve, ndërtimi i qarkoreve do të kushtonte rreth 30 milionë euro, ndërsa në periudhën e ardhshme, siç lajmëroi Kitanov, theks do të vendoset në pjerrësinë pas tunelit të cilat janë në një gjatësi prej tetë milionë metër kubë. Në fazën përfundimtare është e shpronësimi nga trasa fillestare, por me aktivitetet shtesë pritet të paraqiten dhe shpronësim të ri. Nga ana tjetër e autostradës Milladinoc-Shtip pritet aktivitetet ndërtimore të përfundojnë deri në fund të shtatorit. Atje intensivisht punohet dhe janë evituar të gjitha problemet. Te kjo autostradë nuk ka shpenzime shtesë, ndërsa kompetentët paralajmërojnë kursime të mundshme.

Kuadri mjekësor nuk do të ikte jashtë vendit, sikur shteti të siguronte kushte që do të ishin përafërsisht të njëjta me vendet ku ata synojnë të shkojnë. Gjermania i ka ligjet e veta dhe nuk ka gjasa të pranojë kushtëzime nga Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë

PARALAJMËROHEN KUSHTËZIME PËR INFERMIERET

# PROBLEMI DUHET TË ZGJIDHET NË MAQEDONI E JO NË GJERMANI





ASIM MUSA

**Gjermania nuk i merr infermierët pse ka dëshirë, por sepse ka nevojë për këtë staf mjekësor. Sipas tij, Gjermania ka ligje që rregullon punën e një shtetasi të huaj në vendin e tyre dhe në këtë kontekst, nuk mund të kushtëzohen njerëzit, sepse nuk jemi në kohën e monizmit, ku edhe kufizohej lëvizja e njerëzve**

Koha Delvina KËRLUKU

*Shkup, 19 qershor* - Ikja e punonjësve shëndetësorë në vendet perëndimore është bërë problem i cili ka filluar t'i shqetësojë strukturat shtetërore, mirëpo ende nuk është gjendur një mekanizëm adekuat si të parandalohet kjo dukuri. Tash së fundmi Ministria e Shëndetësisë po mendon të hartojë një strategji që do të shkonte në favor të shtetit, por jo edhe të individëve. Konkretisht Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë parashikon të lidhë një marrëveshje me ministrinë e homologe të Gjermanisë e cila do të obligonte infermieret të punojnë përkohësisht në këtë shtet e jo me afat të pacaktuar siç është tani. Në këtë mënyrë autoritet e Maqedonisë duan të frenojnë ikjen masive të punonjësve shëndetësorë në mënyrë që të mos krijohen boshllëqe të mëdha nëpër spitalet dhe ordinancat e Maqedonisë.

Shoqata e motrave medicinale,teknikëve dhe mamive "Për ne" është kundër masave të tilla dhe kërkon që Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë para se të del me kushtëzime të tilla, të krijojë kushte të volitshme që punonjësit shëndetësor të mos e braktisin vendin.

Zëvendësministri i Shëndetësisë, dr. Asim Musa për gazetën KOHA, thotë se nuk ka biseduar me ministrin e Shëndetësisë, por është informuar përmes mediave se ministri Filipçe parashikon marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë të Gjermanisë, për parandalimin e infermierëve që ikin nga Maqedonia. Ai shton se nuk bëhet fjalë për kushtëzim dhe as nuk mund të kushtëzojë qytetarët e vendit aq më pak të urdhërojë një shtet tjetër që të marrë masa për të ndaluar fluksin e infermierëve që ikin. Sipas zëvendësministrit Musa, është pak e arritshme ky synim. "Gjermania nuk i merr infermierët pse ka dëshirë, por sepse ka nevojë për këtë staf mjekësor. Sipas tij, Gjermania ka ligje që rregullon punën e një shtetasi të huaj në vendin e tyre dhe në këtë kontekst, nuk mund të kushtëzohen njerëzit, sepse nuk jemi në kohën e monizmit, ku edhe kufizohej lëvizja e njerëzve". Edhe dr. Musa pajtohet se dukuria e ikjes së kuadrove shëndetësorë do të parandalohej nëse ofrohen kushte më të mira, që, të paktën, atë jetë që kërkojnë infermierët në Evropë, ta gjejnë edhe në shtetin e tyre. Prandaj në këtë drejtim po merren masa, gjegjësisht ka përmirësime jo në paga, por në ngritjen e shumës së shtesës së punës së siç janë kujdestaria, puna gjatë natës, informon ai dhe shton se me rritjen e pagave të mjekëve duhet të rriten edhe pagat e infermierëve, meqë janë edhe bartësit kryesor të aktiviteteve.

Nga Shoqata e motrave medicinale, teknikëve dhe mamive "Për ne" thonë se infermierët tanë nuk ikin vetëm në Gjermani, por në të gjitha vendet e botës,dhe nëse deklarata e ministrit vërtet bëhet realitet, kjo nuk mund të jetë zgjidhje.

Gordanka Beshliovska përfaqësuese e Shoqatës "Për ne" mendon se një kusht i njëjtë duhet të vlejë edhe për mjekët që 2-3 muaj të punojnë dhe të kthehen në vendin e tyre.

Prandaj, nga kjo shoqatë kërkojnë të themelohet një odë, sepse nuk janë reprezentativë, nuk ka ligj për profilin e tyre, ku edhe e kërkojmë nga ministria. Ditët në vazhdim pritet që të kenë takim me sindikatën dhe ministrin që do të paraqesim qëndrimet e tyre për përmirësimin e kushteve të infermierëve. Problemin e kuadrit mjekësor nga shoqata thonë se duhet këtu ta zgjedhin. Nuk e shohin të rëndësishme që ajo metodë do të ndërhyj në ndalimin e infermierëve.

Edhe pse infermierët për momentin e kanë pagën 16.000 denarë, ato megjithatë presin të rritet koeficienti dhe marrëveshja kolektive të ndryshohet. Pastaj duhet të ketë konkurse të rregullta, në mënyrë që të ndërpritet praktika e punës me kontratë, edhe përkundër fakti se ka mungesë të kuadrit mjekësor.

Për tejkalimin e problemeve të grumbulluara në sektorin e shëndetësisë publike, kjo Shoqatë pati takim në Ministrinë e Shëndetësisë, me ç'rast ka parashtruar këto kërkesa: ndryshimi i koeficientit të pagës, njohja e profilit në marrëveshjen kolektive, të njihet përvoja e punës, kufi në shkallën e pensionit, vlerësim i punës së kujdestarisë dhe Shoqata të shndërrohet në odë të mjekëve.

MAQEDONIA NËN OMBRELLËN E NATO-s

# SIGURI DHE INVESTIME MË SHUMË



Njohësit e rrethanave ekonomike thonë se anëtarësimi i shtetit në NATO garanton siguri, inkurajon investimet e huaja dhe vendore, si dhe mundëson rritje më të madhe ekonomike

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 19 qershor* - Procesi i integrimeve euroatlantike për ekonominë e Maqedonisë pritet të sjellë përfitime të shumta. Njohësit e rrethanave ekonomike thonë se anëtarësimi i shtetit në NATO garanton siguri, inkurajon investimet e huaja dhe vendore, si dhe mundëson rritje më të madhe ekonomike. Stabilitet, garanci për prosperitet ekonomik, si dhe përmirësim i pozitës ndërkombëtare të shtetit. Analizat tregojnë se të gjithë 12 shtete që u anëtarësuan në NATO, pas rënies së murit të Berlinit, shënuan rritje të investimeve të huaja.

"Maqedonia në rast se nuk integrohet në strukturat euroatlantike mund të prodhojë në aspektin ekonomik, aq sa prodhon sot. Me marrëveshjen e nënshkruar të dielën si dhe përfitimet e tjera politike, edhe afaristët do të ndryshojnë mënyrën e të menduarit dhe do të dëshirojnë të jenë të parët që do të investojnë nën kushte të reja. Kompanitë e vogla dhe të mesme do të rrisin mundësitë e eksportit në rajon, ndërsa do të duhet të zvogëlohet edhe deficiti apo minusi në këmbimin tregtar me shtetet e tjera", thotë profesori universitar Vanço Uzunov.

Vlerësohet se hyrja e Maqedonisë në NATO do të lëvizë ekonominë dhe rrit gjasat që shteti të jetë më tërheqës për investitorët e huaj.

Anëtarësimi në NATO dhe BE paraqet edhe një garanci shtesë si dhe inkurajim plus për investime nga jashtë për shkak se përmirëson perceptimin e investitorëve të huaj për ekonominë vendore. Gjithashtu, anëtarësimi në këtë organizatë nënkupton edhe sundimin e së drejtës dhe kredibilitetin e institucioneve që ka një rëndësi të veçantë për investitorët potencial" thotë profesori universitar Marjan Petreski.

Nga ana tjetër, ministri i Financave, Dragan Tevdovski, thotë se anëtarësimi sjell përfitime jo të pakta për Maqedoninë, për shkak se NATO paraqet siguri kolektive për shtetet, anëtare, përderisa siguria ka një rëndësi shumë më të madhe, si kusht për investitorët në raport me kushtet e tjera. "NATO është një spirancë e sigurisë, ndërsa shembujt e fqinjëve tanë si Shqipëria dhe Bullgaria tregojnë një rritje serioze, apo edhe dyfishim të investimeve të huaja pas anëtarësimit të tyre në NATO", nënvizon ministri Tevdovski.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 15 dhe nenit 18 të Ligjit për tekstet shkollore për arsim fillor dhe të mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015, 30/2016 dhe 21/2018) dhe në pajtim me Rregulloren për kriteret për përcaktim të shumës së kompensimit për transferim të së drejtës materiale autoriale për tekstet shkollore në arsim fillor dhe të mesëm nr. 22-10483/1 të datës 18.07.2013, nr. 22-10483/2 të datës 16.09.2013 dhe nr. 03-6645/1 të datës 18.03.2015, Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, publikon

**KONKURS**
**për botim të një teksti shkollor për lëndën mësimore**
**Gjuha boshnjake për klasën e I të arsimit fillor nëntëvjeçar**

**1. KUSHTET E PËRGJITHSHME**

**- Porositës**: Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, bul. “Sv. Kiril i Metodi” nr. 54, Shkup.

**Lënda e konkursit:** Ofertat për botim të një teksti shkollor për lëndët mësimore:

- **Gjuha boshnjake për klasën e I të arsimit fillor nëntëvjeçar,** kompensim për transferim të së drejtës materiale autoriale në shumë neto prej 225.093,00 (dyqindenjëzetepesë mijë e nëntëdhjetetre) denarë.

1.1. Të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs kanë autorët të cilët përmbushin kushtet e caktuara me nenin 10 të Ligjit për tekste shkollore për arsim fillor dhe të mesëm.

1.2. Konkursi është publik, i hapur dhe anonim. Autorësia dhe pronësia e tekstit të miratuar shkollor dëshmohet me botimin e gjashtë të tekstit shkollor.

1.3. Në konkurs mund të merr pjesë autori i tekstit shkollor vetëm me një dorëshkrim për tekst shkollor për një lëndë mësimore.

1.4. Autor i tekstit shkollor nuk mund të jetë personi i punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në organet në përbërje të Ministrisë, në Qendrën për arsim profesional dhe trajnim, në Qendrën për arsim të të rriturve, kryetrarin dhe anëtarin e Komisionit nacional dhe anëtarit të komisionit recensues.

1.5. Dorëshkrimi i tekstit shkollor përpilohet sipas planit dhe programeve mësimore për klasën përkatëse, lëndën dhe Konceptin për tekstin shkollor për arsim fillor dhe të mesëm.

1.6. Dorëshkrimi i tekstit shkollor duhet të përmbushë kushtet dhe standardet në pajtim me Konceptin për tekst shkollor për arsim fillor dhe të mesëm.

1.7. Dorëshkrimi për tekst shkollor parashtrohet në formë të shtypur në 5 (pesë) kopje të rregulluara figurative, grafike dhe gjuhësore (3 kopje me ngjyra dhe 2 kopje bardh e zi), të përpiluara sipas planit dhe programeve mësimore për klasën përkatëse, lëndë dhe Konceptin për tekst shkollor për arsim fillor dhe të mesëm.

1.7.1. Dorëshkrimi për tekstin shkollor nuk duhet të përmbajë fotografi, ilustrime dhe përmbajtje të marra nga persona të tretë për të cilat autorët nuk kanë leje që t’i përdorin.

1.8. Dorëshkrimi i tekstit shkollor parashtrohet edhe në formë elektronike.

1.9. Autorët dorëshkrimin e tekstit shkollor e parashtrojnë në gjuhën boshnjake dhe alfabetin e saj.

1.10. Ministri dhe autori i tekstit shkollor lidhin marrëveshje për transferim të së drejtës materiale dhe autoriale ku përcaktohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

1.11. Nëse autori i tekstit shkollor ka ofruar literaturë shtesë në pajtim me nenin 15 paragrafi 2 të Ligjit për tekstet shkollore për arsim fillor dhe të mesëm, të njëjtën është i obliguar që ta heqë pa transferim të së drejtës materiale autoriale në pajtim me nenin 18 paragrafi 2 të Ligjit.

**2. AFATET**

2.1 Afati për parashtrimin e dorëshkrimeve për tekstet shkollore është deri më **31.08.2018**.

**3. DOKUMENTACIONI KONKURRUES**

3.1. Dokumentacioni konkurrues përmban: Planin dhe programin mësimor për klasën përkatëse, lëndën, Koncepcionin për tekstin shkollor për arsim fillor dhe të mesëm dhe Ligjin për tekstet shkollore për arsim fillor dhe të mesëm.

3.2. Dokumentacioni konkurrues mund të merret në lokalet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik bul. “Sv. Kiril i Metodi” nr. 54, Shkup ose në www.bro.gov.mk, www.mon.gov.mk

**4. PARASHTRIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE**

4.1. Ofertat për tekstet shkollore parashtrohen me rekomandim përmes postës ose parashtrohen në Arkivin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik – ndërtesa e Nova Makedonisë – bul. “Sv. Kiril i Metodi” nr. 54, Shkup.

4.2. Në pjesën e përparme të dërgesës, në këndin e epërm të majtë, duhet të shënojë “**MOS HAP**” dhe “**KONKURS PËR BOTIM TË TEKSTEVE SHKOLLORE”,** titulli i tekstit shkollor, klasa, ndërsa në mes adresa: **MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS – SHËRBIMI PEDAGOGJIK, bul. “Sv. Kiril i Metodi” nr. 54 Shkup.**

4.3. Autorët e dorëshkrimeve në pakon e parashtruar në të cilin shënon “MOS HAP” duhet të parashtrojnë edhe zarf të mbyllur në të cilin gjithashtu duhet të shënojë “MOS HAP” me të dhënat dhe dokumentet në vijim: emri dhe mbiemri i saktë i autorit/ëve, adresa e banimit, numri i telefonit, institucioni ku janë të punësuar, certifikata ose diploma për arsimin e mbaruar përkatës, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter (autorët të cilët kanë mbaruar arsimin jashtë vendit obligohen që të parashtrojnë diplomë të nostrifikuar nga Republika e Maqedonisë), pasqyrë të të dhënave të regjistruara në evidencën amë nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë, deklaratë se përmbushë kushtet e dhëna në pajtim me nenin 11 të Ligjit për tekstet shkollore për arsim fillor dhe të mesëm, deklaratë nga lektori për rregullim gjuhësor të tekstit dhe vërtetim për provim të dhënë për lektor (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter), deklaratë se dorëshkrimi nuk përmban fotografi, ilustrime dhe përmbajtje të marra nga persona të tretë për çka autorët nuk kanë të drejtë përdorimi.

4.4. Nëse emri dhe mbiemri i autorit në fletëparaqitje dallon me emrin dhe mbiemrin e dhënë në certifikatë ose diplomë për arsim të mbaruar përkatës, parashtrohet dëshmi përkatëse për njejtshmërinë e të dhënave.

4.5. Zarfi “MOS HAP”, hapet me miratimin e shifrave të teksteve shkollore.

4.6. Materialet nën pikën 4.1., 4.2., 4.3. dhe 4.4. parashtrohen në pako të mbyllur në të cilin është shënuar vetëm “KONKURS PËR BOTIM TË TEKSTIT SHKOLLOR” dhe emri i tekstit shkollor, adresa – Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, bul. “Sv. Kiril i Metodi” nr. 54, Shkup.

**5. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

5.1. Ofertat për tekstet shkollore të cilat nuk do të parashtrohen brenda afatit të caktuar dhe ato të cilat nuk janë përpiluar në pajtim me kushtet e këtij Konkursi, do të diskualifikohen.

---

Ministria e Drejtësisë – Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publikon Shpallje për punësimin e 2 (dy) personave

Ministria e Drejtësisë – Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbi bazë të nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhëniet e punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 и 27/2016), ndërsa në lidhje me nenin 22 paragrafi (1) alineja 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16,35/2018) dhe Rregullores për organizim të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë – Byrosë për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nr. 20-154/2015-1 datë 11.06.2015, 20-168/38datë 27.12.2016 dhe 20-53/2datë 30.01.2017,Rregullorja per sistematizimin e vendeve të punës ne Ministrinë e Drejtësisë Byroja për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nr. 20-154 / 2015-2 datë 11/06/2015, 20-168/39 datë 27.12.2016 dhe 20-53/1 datë 30.01.2017,publikon

SHPALLJE NUMËR 2/2018

PËR PUNËSIMIN E 2 (DY) REALIZUESVENË KOHË TËCAKTUAR DERI MË 31 DHJETOR 2018 NË MINISTRINË E DREJTËSISË – BYRONË PËR PËRFAQËSIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PARA GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Ministria e Drejtësisë – Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,publikon Shpallje për punësimin e 2 (dy) personave, duke themeluar marrëdhënie pune në kohë caktuar deri më 31 dhjetor 2018 për këto vende pune:

1. Një realizues,
- në Byronë për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Njësinë për punë financiare dhe punë të tjera administrative, në vendin e punës Bashkëpunëtor i ri për resurse njerëzore, me thirrje *bashkëpunëtor i ri.*

Kualifikimet e nevojshme:

Arsimimi: Shkenca juridike ose administratë publike, niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1.
Përvojë pune: me ose pa përvojë pune
Njohja e gjuhëve të huaja: Gjuhën angleze
Orari ditor i punës: 8 orë (fillimi i orarit të punës mes orës 07:30 dhe 08:30, ndërsa përfundimi i orarit të punës mes orës 15:30 dhe 16:30), orari javor i punës 40 orë;
Rroga në neto: 21 000 denar.

*2. Një realizues,*
- në Byronë për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendin e punës Udhëheqës Njësie për ekzekutimin e masave individuale ose të përgjithshme sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me thirrje *udhëheqës njësie*.

Kualifikimet e nevojshme:
Arsimimi: Shkenca juridike, niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1.
Përvojë pune: Së paku katër vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vendin e punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion prej ti cilave dy vite në vendin e punës udhëheqës në sektorin privat;
Njohja e gjuhëve të huaja: Gjuhën angleze
Kushtet e posaçme: Provimin e jurisprudencës
Orari ditor i punës: 8 orë (fillimi i orarit të punës mes orës 07:30 dhe 08:30, ndërsa përfundimi i orarit të punës mes orës 15:30 - 16:30), orari javor i punës 40 orë;
Rroga në neto: 28 000 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë:
- Fletëparaqitjen të nënshkruar me dorë të lirë për vendin për të cilin paraqitet;
- Biografi të shkurtë – CV dhe patjetër të ceket telefoni për kontakt dhe adresa;
- Fotokopje të Certifikatës/Diplomës për shkallë të përfunduar të arsimit që kërkohet për vendin e punës
- Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze
- Dëshmi për provimin e jurisprudencës (vetëm për kandidatët që aplikojnë për vendin e dytë - *Udhëheqës njësie*) dhe
- Kopje të certifikatës së shtetësisë.

Dokumentet e nevojshme të dërgohen në zarf të mbyllur në këtë adresë:

Ministria e Drejtësisë - Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 9, 1000 Shkup
(me shënim "për shpallje për punësim")

Për shkak të urgjencës së procedurës, **fletëparaqitjet dërgohen** vetëm përmes arkivës së Ministrisë së Drejtësisë – Byrosë për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**zyra nr. 9 kati i II**).

Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme është pesë (5) ditë, nga dita e publikimit të Shpalljes në shtypin ditor (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit), gjegjësisht më së voni deri më 27.06.2018 (e Mërkurë). Fletëparaqitjet që do të arrijnë pas skadimit të këtij afati, si dhe fletëparaqitjet që nuk do t`i përmbajnë dokumentet e nevojshme, do të konsiderohen si të dorëzuara pas afatit dhe të pa kompletuara dhe të njëjtat nuk do të merren parasysh.

Pas selektimit të fletëparaqitjeve, vetëm kandidatët e zgjedhur do të ftohen në intervistë në hapësirat e Ministrisë së Drejtësisë - Byrosë për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ministria e Drejtësisë - Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, do të bën zgjedhjen brenda afatit të caktuar në përputhje me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Personi për kontakt:
Irena Cuculoska
Telefon: 02/3116-493 lok. 216
e-mail: irenacuculoska@mjustice.gov.mk

U.D. Drejtoreshë e Byrosë për përfaqësimin e
RM para GJEDNJ – Agjenti Qeveritar
DanicaDjonova

---

Në bazë të nenit 159 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), IPSH Klinika universitare për kirurgji plastike dhe rikonstruktive – Shkup, publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE**
**për punësimin**

1. Publikohet shpallje publike për punësim të punëtorit edhe atë:
- **3 (tre) persona – doktor të medicinës specializant të kirurgjisë plastike dhe rikonstruktive për kohë të pacaktuar**

1.1. Kandidatët duhet ti plotësojnë **KUSHTET E PËRGJITHSHME** në vijim:
- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj), dhe
- të mos je të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj),

1.2. Kandidatët për **doktor të medicinës specializant të kirurgjisë plastike dhe rikonstruktive** duhet ti plotësojnë edhe **KUSHTET E POSAÇME** në vijim:
- të ketë të mbaruar arsim të lartë me së paku 240 kredi sipas SETK apo shkalla VII/1 të mbaruar - Fakulteti i medicinës
- provim të dhënë profesional
- licencë për punë
- suksesin e arritur për të gjitha lëndët të të gjitha cikleve të studimeve universitare të cilat i ka mbaruar kandidati të më së paku tetë (në tekstin e mëtutjeshëm: sukses mesatar)
- në mënyrë aktive të njohë një nga tre gjuhët që shfrytëzohen të Unionit Evropian (angleze, gjermane apo frënge) në nivel B2 sipas kornizës së përbashkët Evropiane e referencës e gjuhës, mësimit dhe vlerisimit (Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment) (në tekstin e mëtejmë: CEFR dhe të posedojë certifikatë të pranuar ndërkombtarisht të pranuar të dhënë nga testator oficial evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve të nivelit B2 CEFR, gjegjësisht ELTS me 5-6 pikë, FCE, BEC, ILEC, IKFE, BULATS, apo TOEFL PBT më së paku 500 pikë, TOEFL CBT më së paku 175 pikë apo TOEFL IBT më së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Goethe-Zertifikat, TestDaF,
- kandidatët të kenë të filluar specializimin për kirurgji plastike dhe rikostruktive dhe të parashtrojnë dokument me çka do të dëshmohet se për momentin kanë filluar specializimin për kirurgji plastike dhe rikostruktive
- me dhe pa përvojë pune

2. Dokumentet e nevojshme për vendin e punës **doktor të medicinës specializant të kirurgjisë plastike dhe rikonstruktive** janë:
- Lutje (me adresë të saktë të banimit dhe numër të telefonit)
- Biografi të shkurtë (CV)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore jo më të vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, që duhet të jetë jo më e vjetër se 6 muaj (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

2.1. Krahas dokumenteve nga pika 2 të kësaj shpallje, kandidatët për **doktor të medicinës specializant të kirurgjisë plastike dhe rikonstruktive,** duhet të parashtrojnë edhe:
- Dëshmi ku do të shihet mesatarja e kandidatit (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë për provim të dhënë profesional (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Licencë për punë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Njohja e gjuhës së huaj dëshmohet me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave të përdorura ndërkombëtare: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEC, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të B2 nivelit të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim, ligjërim dhe vlerësim të gjuhëve (CEFR) (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- kandidati të ketë të filluar specializimin për kirurgji plastike dhe rikostruktive dhe për çka duhet të parashtrojë dokument me çka do të dëshmohet se për momentin kanë filluar specializimin për kirurgji plastike dhe rikostruktive – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- dëshmi për përvojën e punës nëse e ka (të vërtetuar nga institucioni ku ka realizuar përvojën e punës)

3. Komisioni për përzgjedhje të punëtorit shëndetësor bën përzgjedhjen e kandidatit në bazë të kritereve në vijim:
- Mesatarja e suksesit që kandidati ka arritur në institucionin për arsim sipëror – që bartë 40 pikë. Pjesa/provimi kualifikues jepet para Komisionit për përpilimin e testeve, i formuar nga Ministria e shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë. Provimi kualifikues, i cili bartë gjithsej 60 pikë, përbëhet prej 2 (dy) pjesëve edhe atë:
- Pjesa profesionale (test) – që bartë 40 pikë dhe
- Njohja e një prej gjuhëve të huaja (angleze, frënge ose gjermane) – që bartë 20 pikë

Komisioni për përpilimin e testeve sipas të cilave jepet pjesa profesionale është formuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë. Kandidatët do të informohen për ditën e dhënies së pjesës profesionale të provimit.

4. Afati për paraqitje është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e publikimit.
5. Dokumentet parashtrohen në arkivin e Klinikës ose në adresën, IPSH Klinika universitare për kirurgji plastike dhe rikonstruktive – Shkup, rr. Vodnjanska nr. 17, Shkup, me shenjë “për shpallje publike”.

Orari i punës është 40 orë në javë dhe neto pagesa fillestare:
- Për kandidatin doktor të medicinës është 27.000 denarë.

***IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR KIRURGJI PLASTIKE DHE RIKONSTRUKTIVE – SHKUP***

NË MEDRESENË PËR VAJZA DO TË PRANOHEN 44 NXËNËSE

# FILLOI REGJISTRIMI NË "ISA BEU"

Medreseja "Isa Beu" - paralelja e shtrirë e vajzave në Tetovë është hapur në vitin 2004 dhe deri më tani ka përcjellë 11 gjenerata. Megjithatë, edhe përkundër shumë insistimeve që kjo medrese të akreditohet si shkollë e mesme në kuadër të shtetit, e njëjta ende është në kuadër të BFI-së



Koha Urim HASIPI

*Tetovë, 19 qershor* - Medreseja "Isa Beu" paralelja e shtrirë e vajzave në Tetovë ka shpallur konkursin për pranimin e nxënëseve të rregullta në vitin e parë shkollor 2018/2019. Për këtë vit shkollor është paraparë të regjistrohen 44 nxënëse në dy paralele me nga 22 nxënëse, edhe pse interesimi për të vijuar arsimin e mesëm është shumë i madh dhe nga viti në vit shënon rritje. Medreseja këtë vit ka paraparë që të interesuarit t'i nënshtrohen edhe provimit që do të mbahet më datë 23 qershor, thotë Beqir Memeti, drejtor i Medresesë "Isa Beu" paralelja e shtrirë e vajzave në Tetovë.

"Edhe këtë vit planifikojmë të pranojmë dy paralele me nga 22 nxënëse në klasë, gjithsej 44 nxënëse, edhe pse kemi mjaftueshëm kandidatë të cilët kanë interesim për të ndjekur arsimin e mesëm në medrese, prandaj më datë 23 të këtij muaji kemi edhe provimin pranues ku nxënëset të cilat i plotësojnë kushtet për të ndjekur mësimin në këtë shkollë, ata do të vijojmë mësimin, ndërsa të tjerat të cilat nuk plotësojnë kushtin - kuptohet nëse nuk kalojnë provimin pranues, nuk do të kenë mundësi të ndjekin mësimin në këtë shkollë. Edhe pse që të gjithë ne e dimë se medreseja është një shkollë e mesme dhe funksionon në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame ku financimi bëhet nga popullata e këtyre trevave, qofshin ata në mërgatë apo qofshin në vendlindje, pra është një kontribut i paharruar i kësaj popullate, është një kontribut apo një angazhim i parezervë i teologëve, imamëve, muezinëve që funksionojnë dhe veprojnë në kuadër të Bashkësisë Islame. Është një kontribut i parezervë edhe i muftive, të cilët kontribuojnë dhe veprojnë në kuadër të Bashkësisë Islame të Maqedonisë", deklaroi Memeti. Sipas tij, nxënëset që përfundojnë arsimin fillor me sukses të shkëlqyeshëm dhe shumë mirë përzgjedhin medresenë për të vijuar arsimin e tyre të mesëm për shkak të kushteve shumë të mira objektive që ofron dhe stafit akademik të shkëlqyeshëm.

"Në medrese nuk flet vetëm arsimi, nuk flet vetëm mësimi, por flet edhe ambient, flasin edhe nxënëset, flasin edhe profesoreshat, pra ambienti në medrese dallon nga të gjitha ambientet tjera pasi është regjistruar në psikologjinë e njerëzve apo të shoqërisë se po u fute në medrese, duhet ti kesh këto kritere. Në ambientet tona të mësimit muret nuk janë të përlyer, bankat nuk janë të gërryera aspak, pastërtia është në nivelin e duhur , janë mbi 200 nxënës që ndjekin mësimet pranë kësaj shkolle, por nuk dëgjohet zhurmë aspak... pra me pak fjalë, në medrese lirisht mund të them se flet i gjithë institucioni që dallon pra nga disa ambiente të tjera. Kjo ka qenë tradicionalisht falë paraardhësve tanë, sepse ne kështu e kemi gjetur këtë institucion, i kemi gjetur institucionet fetare qofshin ato xhamitë, Bashkësinë Islame... që domethënë se atë ambient, atë kulturë atë traditë e kanë mbjellë gjeneratat para nesh të cilëve ne ju jemi shumë mirënjohës", theksoi ai. Përndryshe, medreseja "Isa Beu" - paralelja e shtrirë e vajzave në Tetovë, është hapur në vitin 2004 dhe deri më tani ka përcjellë 11 gjenerata. "Megjithatë, edhe përkundër shumë insistimeve që kjo Medrese të akreditohet si shkollë e mesme në kuadër të shtetit, e njëjta ende është në kuadër të BFI-së dhe pas përfundimit të shkollimit, nxënësit e kanë të vështirë të pranohen në të gjitha universitet, ndërsa më të sigurt e kanë pranimin vetëm në fakultetin teologjik. Por, viteve të fundit nxënësit janë pranuar edhe në universitetet tjera falë vullnetit të drejtuesve të këtyre institucioneve, posaçërisht në Universitetin e Tetovës", theksoi më tej Memeti.

## Në shtator fillon manifestimi "Vala e re kulturore 2018"

*Shkup, 19 qershor* - Me qëllim që të bëhet demotropolizimi, dekoncentrimi i kulturës nga Kryeqyteti, që ajo të disperzohet në mjediset lokale, por edhe të pasurohet, të masivizohet, të intensifikohet, të dinamizohet dhe të lëvizë oferta kulturore, Ministria e Kulturës, përmes Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, do ta realizojë manifestimin "Vala e re kulturore" në vitin 2018, me ç'rast edhe ka shpallur konkurs për finansimin e proekteve, thuhet në komunikatën e kësaj Ministrie. Për shkak të përcaktimit për të qenë të hapur ndaj sektorit civil, edhe këtë vit intenca e manifestimit është që të nxitet dhe aktivizohet skena e pavarur kulturore për krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë. Andaj të drejtë për pjesëmarrje kanë shoqatat e qytetarëve, asociacionet, gupet joformale dhe autorët nga fusha e kulturës. Në këtë mënyrë Ministria e Kulturës do të sigurojë "kulturë nga të gjithë për të gjithë" dhe, madje, me përfaqësim më të barabartë të kulturës në të gjitha rajonet malore. Propozim-projektet mund të jenë në ndonjërën nga fushat e krijimtarisë artistike, ekspozita të pavarura ose grupore; koncerte solistike, kamertale dhe simfonike, etnofolklorike, rok dhe xhez; shfaqje teatrale dhe projeksione filmike ose, edhe përmbajtje që kanë karakter multimedial dhe interdisiplinor (aksione, intervenime artistike në hapësirën urbane, hepeninge, prezantime etj.). Lokacionet e mbajtjes së tyre mund të jenë në institucionet e sferës së kulturës, por edhe në hapësira të tjera publike dhe alternative, madje edhe jofunksionale, objekte të rrënuara ose hapësira që mund të "gjallërohen" dhe të "ristartohen si skenë artistike.

# BAFTIARI BOTON TRI VEPRA



*Tetovë, 19 qershor* - Profesori Hashim Baftiari në qendrën "Loja" në Tetovë ka promovuar tri veprat e tij të titulluara "Ramiz Kelmendi - humorist dhe satirik", "Njëqind Poezi Dashurie" që janë përzgjedhje nga letërsia botërore dhe "Kjo Dashuri", poezi dashurie të gjuhës frënge. Autori shprehet se dy librat me poezi janë financuar nga ana e Ministria e Kulturës, ndërsa në librin "Ramiz Kelmendi - humorist dhe satirik", autori i ka bërë një studim, pasi ky punim ka qenë tezë e magjistraturës në vitin 2013 në Universitetin e Tetovës. Ky libër është botuar më herët, ndërsa kësaj radhe vjen si ribotim.

"Vepra e Ramiz Kelmendit paraqet pa dyshim një rast interesant dhe intrigues për studimet albanologjike. Studimi i saj është sfidë e një lloji të veçantë, edhe për shkak të mungesës së ndjeshme të literaturës teorike mbi humorin dhe satirën në letërsi dhe në përgjithësi - si kategori estetike", thotë autori. Sipas tij, Ramiz Kelmendi me krijimtarinë humoristike dhe satirike, pa dyshim që sjell risi në aspektin stilistik, por edhe e pasuron letërsinë humoristike dhe satirike shqipe edhe ashtu mjaft të varfër. "Edhe pse proza humoristike dhe satirike nuk përbën krejt krijimtarinë letrare të Ramiz Kelmendit, ajo është pjesa më intriguese, mbase edhe më e rëndësishme e tij. Zhanri që e kultivon më së shumti dhe që i ngjit Kelmendit është tregimi. Ai është cilësuar nga kritika 'tregimtar i lindur'. Tregimi është zhanri epik ku Ramiz Kelmendi sendërton veten si shkrimtar i shquar i letrave shqipe. Nëse vepra e parë satirike e autorit lidhet ekskluzivisht me një periudhe historike jo fort të largët, pjesa tjetër e veprës humoristike dhe satirike e autorit - edhe pse është dëshmi e një kohe dhe e një vendi të caktuar, megjithatë me tematikën dhe vlerat artistike do të mbetet e përjetshme: derisa të mos zhduken veset në shoqërinë tonë", shprehet Baftiari. Recensenti Stefan Çapaliku u shpreh se autori gjatë studimit, Ramiz Kelmendin e studion me mjete globale. "Duke e konsideruar me të drejtë shkrimtarin Ramiz Kelmendi si një fenomen lokal, Hashim Baftiari e studion atë me mjete globale. Metodikisht, ai aftësohet kështu për të përballuar studime më të gjera dhe më të thella në fushë të satirës dhe humorit. Të bën përshtypje veçanërisht njohja që autori ka mbi doktrinat estetike mbi komiken, si një kategori shprehëse e një inteligjence të rrallë letrare, me të cilën autorët e pakët shqiptarë kanë shndritur në panteonin e letrave shqipe. Gjithashtu, Hashim Baftiari njeh mjaft mirë edhe zhvillimin dhe modat nëpër të cilat ka kaluar komikja ndër shekuj letrarë. Por Baftiari nuk harron t' i kushtojë një vend të veçantë edhe kushteve historiko-politike nëpër të cilat është lindur, vaditur dhe selitur vepra e Ramiz Kelmendit", shkruan Çapaliku. Në promovimin e tre veprave kanë marrë pjesë shumë profesorë, personalitete nga jeta politike dhe shoqërore nga Maqedonia, Kosova, Presheva dhe Shqipëria. Deri më tash autori Hashim Baftiari ka botuar pesë vepra. *(U.H)*

# Peshku më i shtrenjtë në botë



*Nga*
**Veton SURROI**

1. Më ra në mend ajo thënia japoneze se njeriun nuk e ndihmon duke i dhuruar peshk, por duke e mësuar të peshkojë, ndërsa isha në një restorant në Prishtinë, i ftuar për drekë nga një diplomat. Restoranti ka një klientelë nga më të çuditshmet. Aty rregullisht gjendet ndonjë diplomat, ndonjë yll i estradës, ndonjë afarist, ndonjë politikan që bën pjesë në pushtet, ndonjë grup të rinjsh me fjalor të varfër dhe mungesë mirësjelljeje e që duken si kontrabandistë, por nuk janë figura politike-shkurt një përzierje që ka të përbashkët afinitetin ndaj peshkut të freskët dhe mundësinë për ta paguar atë.

Peshku është i freskët, mbërrin çdo ditë nga Shqipëria dhe është pjesë e një fenomeni, i cili qe i parashikueshëm shumë vjet më parë, kur filloi së ndërtuari autostrada që do të lidhte Durrësin me kufirin e Kosovës. Fenomeni ishte ndryshimi gjeografik që do ta bënte rruga, duke e shndërruar kulturalisht Kosovën në një vend mesdhetar, një lloj hinterlandi i Adriatikut shqiptar. Arritja e peshkut të freskët, çdo ditë, e bënte Prishtinën kulinare aq mesdhetare sa edhe Tiranën në ato fillimet e demokracisë, një lloj zbulimi i misereve të detit.

Por, ndryshimi mund të ndodhte vetëm nëse kishte klientë për peshkun, dhe për këtë u kujdes një autostradë tjetër. Autostrada e ndërtuar prej kufirit me Shqipërinë deri në Prishtinë nuk kishte për qëllim më peshkun, por klientin e peshkut. Peshku i ardhur me frigorifer deri në kufi të Kosovës e kishte të njëjtë a mbërrin për një orë e gjysmë në Prishtinë apo për dy - nuk do të kishte gjë që do të mundë të ndikonte në cilësinë e tij për gjysmë ore më shumë rrugë. Por, ky peshk nuk do të ishte cilësor po të mos hahej, e për t'u ngrënë u përkujdes pushteti i cili ndërtoi autostradën më të shtrenjtë në Evropë, prej kufirit të Shqipërisë deri në, supozohet, Prishtinë.

Ashtu siç qe supozuar se kemi një autostradë prej kufirit deri në Prishtinë, të bëjmë një supozim të edukuar (në bazë të një analize të gjatë në revistën prestigjioze "Foreign Policy") se në këtë projekt janë vjedhur diku 300 milionë euro. Dhe të supozojmë se një pjesë e këtyre pareve nuk është fshehur jashtë Kosovës (për shkak të frikës se disi zbulohen) dhe se gjendet në vend; kjo i bie shumë para për peshk apo jo?

2. Në fakt, i bie se elitat politike në pushtet e kanë adaptuar mësimin japonez. Kanë parë se nuk ka gjë të hairit prej peshkut të dhuruar dhe janë mësuar ta peshkojnë vetë. E bëjnë këtë duke e përdorur buxhetin e shtetit si një lloj thesi parash që duhet shpenzuar për inat të Serbisë (si të ishin paratë e Serbisë); lista e zyrtarëve që hanë peshk me paratë e qytetarëve të Kosovës të mbledhura në buxhet rritet ditë më ditë në progresion gjeometrik.

Por, kjo është vetëm Maja e Ajsbergut. Paraja e vjedhur apo, të themi, e supozuar se është vjedhur nga autostrada që e sjell peshkun prej kufirit deri në Prishtinë ka hyrë në riinvestim. Dhe kjo para supozohet se ka gjetur mundësi të madhe shpëlarjeje në ndërtim. Dhe të hyrat nga ajo shpëlarje dhe nga vjelja e buxhetit janë të futura në konsumin e elitës politike në pushtet. Kështu e kanë mbyllur ciklin e peshkut më të shtrenjtë në botë. Në mënyrë që ata të hanë peshk të freskët çdo ditë, qytetarët e Kosovës është dashur ta paguanin një miliard euro autostradën prej Morinës deri në, të supozojmë, Prishtinë. Të supozojmë se shuma është një miliard euro, sepse ende është sekret se sa kanë paguar qytetarët e Kosovës.

3. Kosova u bë mesdhetare me autostradën që e bëri Shqipëria deri në kufi. Pastaj u kriminalizua edhe më me elitat e veta politike duke ndërtuar një autostradë thellësisht të korruptuar prej kufirit deri në, supozohet, Prishtinë. Pastaj u konsolidua elita kriminale-politike në të duke futur paratë e vjedhura, të supozuara si të vjedhura, në ndërtim dhe forma të tjera afarizmi.

Ky është një minileksion gjeopolitik. Në të pastaj mund të zhvillohen supozime të tjera.

Njëri për shembull është se ashtu si erdhi peshku, erdhi edhe nevoja që të mos ketë sundim të ligjit. Nëse kapet peshku, duhet kapur edhe rendin e ligjin, shtetin. Nëse rendi dhe ligji nuk janë të kapur, nuk do të mundë të hahet peshku. Dhe nëse kapet shteti, atëherë çdo gjë i subordinohet ciklit të peshkut. Për 20 vjet rresht ka ekzistuar mundësia që vëmendja të shkonte nga konsolidimi i një shteti demokratik dhe për 20 vjet rresht forcat e kapjes së shtetit kanë qenë të suksesshme për ta mësuar veten se si të kapet peshku.

4. Gjeografia politike e Kosovës së shpejti do të ketë edhe dy ndryshime. Gjatë këtij viti me paratë e qytetarëve të Kosovës do të përfundojë autostrada për në kufirin e Maqedonisë. Do të ketë dy efekte. Një, do të rrisë fondet e elitave politike-kriminale të cilat e paguajnë këtë autostradë shumëfish më shtrenjtë sesa kostoja.

> **Kosova atëherë, me dy miliardë euro të qytetarëve të saj të shpenzuara në asfalt dhe vjedhje, do të bëhet gjeo-politikisht e barabartë me një pompë të madhe të benzinës, në të cilën ndalen veturat dhe kamionët për të shfrytëzuar tualetin, për të pirë kafe dhe për të blerë ujë. Peshku, i cili kushtoi fillimisht një miliard euro, do të vazhdojë të serviret i freskët, i përgatitur gjithnjë e më mirë**

Dy, do të rrisë aftësinë e produkteve dhe shërbimeve, superiore, të Maqedonisë që të kenë qasje në tregun e Kosovës. Dhe, gjatë dy-tre vjetëve të ardhshëm Serbia me paratë e Bashkimit Evropian do të ndërtojë autostradën prej Nishit deri në kufirin me Kosovën. Serbia me këtë do t'u afrohet me produktet e veta superiore tregjeve shqiptare (të Shqipërisë dhe Kosovës) dhe Shqipëria do t'i afrohet Serbisë me produktet dhe shërbimet e veta superiore (Porti i Durrësit, turizmi, pemët dhe perimet e hershme).

Kosova atëherë, me dy miliardë euro të qytetarëve të saj të shpenzuara në asfalt dhe vjedhje, do të bëhet gjeo-politikisht e barabartë me një pompë të madhe të benzinës, në të cilën ndalen veturat dhe kamionët për të shfrytëzuar tualetin, për të pirë kafe dhe për të blerë ujë. Peshku, i cili kushtoi fillimisht një miliard euro, do të vazhdojë të serviret i freskët, i përgatitur gjithnjë e më mirë.

*(koha.net)*

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS




Koha
E përditshme informative
www.koha.mk
Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi
Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 19 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
**E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup
**NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772**

# Dhuna seksuale, krim lufte dhe krim kundër njerëzimit

*Nga*
Ulrika RICHARDSON





Për një kohë të gjatë dhuna seksuale në konflikt është përdorur si një armë e heshtur dhe e efektshme në konfliktet anembanë botës. Historikisht përdhunimi është përdorur si një strategji për spastrim etnik dhe gjenocid, si një mjet për të shkatërruar familjet dhe komunitetet, si një metodë e nxitjes së terrorit dhe nxjerrjes së informacionit. Për një kohë të gjatë dhuna seksuale ishte pothuajse e padukshme. Të mbijetuarit vuanin në heshtje, të turpëruar për diçka që nuk ishte faji i tyre, të turpëruar nga familjet e tyre, të stigmatizuar, të lënë për t'u përballur me veten dhe gjithmonë pa mirëkuptim dhe ndihmë.

Vetëm në vitin 1992, kur bota u përball me përdhunime të gjera të grave në ish-Jugosllavi dhe Ruandë, çështja u vu në vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Si rezultat i presionit të rëndësishëm publik, dhuna seksuale u pranua përfundimisht si një armë lufte. 19 qershori 2008 shënon miratimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1820, e cili e njohu dhunën seksuale si një taktikë lufte dhe një kërcënim për paqen dhe sigurinë globale, duke kërkuar kështu një përgjigje operacionale të sigurisë dhe drejtësisë. Ajo gjithashtu njohu përdhunimet dhe format e tjera të dhunës seksuale si krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Që nga fillimi i konfliktit në Kosovë, organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët për të drejtat e njeriut kanë ngritur zërin për të nxjerrë në pah çështjen e përdhunimit që u përdor kundër popullatës civile, përkatësisht grave dhe vajzave. U deshën gati njëzet vjet beteja, përpjekje dhe punë e palodhur e institucioneve të Kosovës, shoqërisë civile dhe agjencive të OKB-së (sidomos "UN Women") për t'u dhënë zë viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit. Ligji i cili u jep njohje ligjore këtyre viktimave u miratua në mars të vitit 2017 nga Kuvendi i Kosovës.

U pasua me themelimin e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë. Në shtator të vitit të kaluar Qeveria e Kosovës ndau një buxhet për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të të mbijetuarve të sulmeve seksuale. Pas identifikimit të mbijetuarit marrin statusin zyrtar të viktimave civile, të cilët kanë të drejtë për dëmshpërblime dhe pensione mujore.

Është një hap i madh përpara, megjithatë duhet të bëhet më shumë nga aspekti ligjor dhe njerëzor. Edhe sot vuajtjet vazhdojnë, viktimat apo të mbijetuarit keqkuptohen, viktimizohen dhe largohen. Është detyra jonë të lobojmë me institucionet e tjera që të bëjmë gjithçka në fuqinë tonë për të njohur këto gra në të njëjtën mënyrë si çdo viktimë tjetër që pësoi gjatë konfliktit, për të hequr vellon e padukshmërisë dhe të turpit. Ato janë nënat, motrat dhe vajzat tona, dhe ato duhet të trajtohen me dhembshuri, respekt dhe vendosmëri për atë që kanë duruar. Për shumicën e kosovarëve paqja erdhi 19 vjet më parë. Është koha që të punojmë së bashku për të sjellë paqe për këto gra dhe fëmijë të mbijetuar të sulmeve seksuale dhe për pasojat e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin që jehon ndër gjenerata, përmes traumës, stigmës, varfërisë, shëndetit të dobët dhe shtatzënisë së padëshiruar.

Në të vërtetë, këtë vit 19 Qershori u dedikohet "Plagës dhe të drejtave të fëmijëve të lindur nga lufta". Këtë vit ne do të përqendrohemi tek fëmijët ekzistenca e të cilëve rrjedh nga dhuna seksuale, të cilët shpesh emërohen si "gjak i keq" ose "fëmijë të armikut". Për më tepër, nënat e tyre janë më tepër sesa të margjinalizuara dhe të anashkaluara nga familjet dhe komunitetet e tyre. Fëmijët si rezultat i përdhunimit në kohë lufte shpesh luftojnë me çështje të identitetit dhe përkatësisë, për dekada pas përfundimit të luftës. Ata pranohen rrallë nga shoqëria. Përveç kësaj, aborti i pasigurt mbetet një shkak kryesor i vdekshmërisë së nënave në mjediset e prekura nga konflikti, gjë që thekson më tej nevojën për të mbrojtur gratë në luftë. Sot, në kujtim të të mbijetuarve të kësaj arme të papranueshme të kohës së luftës, këtë krim kundër njerëzimit, le të bashkohemi me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së për të "... përforcuar zërat e këtyre viktimave të harruara të luftës, të cilët vuajnë stigmatizim, turp dhe përjashtim, në shoqëri të polarizuara nga konflikti i armatosur". *(koha.net)*

*(Ulrika Richardson është Koordinatore e zhvillimit e OKB-së dhe Përfaqësuese e përhershme e UNDP-së)*

Sot, në kujtim të të mbijetuarve të kësaj arme të papranueshme të kohës së luftës, këtë krim kundër njerëzimit, le të bashkohemi me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së për të "... përforcuar zërat e këtyre viktimave të harruara të luftës, të cilët vuajnë stigmatizim, turp dhe përjashtim, në shoqëri të polarizuara nga konflikti i armatosur"

# Shumë zhurmë për një emër

*Nga*
Moskovou SPIROS



Gati 27 vite kanë zgjatur mosmarrëveshjet mes Athinës dhe Shkupit për emrin e Maqedonisë. Tani është arritur një marrëveshje, por në asnjërin prej këtyre vendeve nuk ka ndonjë eufori. Grekët thonë se Maqedonia është pjesë e historisë antike greke dhe vendlindja e heroit kombëtar, Aleksandar Makedonski. Ndërsa pala maqedonase pohon se kjo republikë e vogël multietnike ka të drejtë të mbajë këtë emër. Ajo është pasardhëse e Aleksandrit të Madh dhe me këtë shpjegim në vend janë vendosur shumë përmendore të tij. Prej kësaj jave palët janë futur në faqet e historisë. Pas negociatave që kanë zgjatur me vite, kryeministrat e tanishëm Alexis Tsipras dhe Zoran Zaev kanë rënë dakord që vendi të quhet "Republika Maqedonia Veriore". Me këtë formulë magjike është zgjedhur problemi disavjeçar. Pala maqedonase duhet të ndryshojë pjesët e Kushtetutës ku shkruhet për Maqedoninë. Ndërsa ajo greke duhet të hapë përfundimisht rrugën për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE.

> Athina dhe Shkupi kanë rënë dakord që të përfundojnë grindjet rreth emrit të ri të Maqedonisë. Një hap drejt normalitetit në Evropën Juglindore?

Kjo është merita e majtistit Tsipras dhe socialdemokratit Zaev, të cilët megjithë kundërshtimet e nacionalistëve kanë ndërmarrë këtë përpjekje serioze për zgjidhjen e problemit dhe përfundimin e konflikteve rreth emrit, që ka qenë një problem politik dhe ekonomik mes vendeve. Maqedonia ka nevojë urgjente për integrime evropiane dhe në NATO, sepse ajo ka edhe probleme të shumta ndëretnike dhe ekonomike. Marrëveshja paraprake e nënshkruar mes palëve duhet të miratohet edhe në parlamentet e këtyre vendeve dhe në një referendum në Maqedoni. Presidenti maqedonas Ivanov ka deklaruar se nuk do ta nënshkruajë dokumentin e kësaj marrëveshjeje për këtë kompromis. Sipas Kushtetutës, ai mund ta rikthejë këtë dokument në parlament. Ndërkohë që maqedonasit duhet të votojnë edhe në referendum.

Por edhe Tsiprasi në Greqi ka shumë kundërshtarë të opozitës konservatore që kundërshtojnë këtë marrëveshje. Opozita dhe patriotët e pavarur planifikojnë të mbajnë protesta dhe demonstratat kundër marrëveshjes. Dëgjohen edhe kërkesa për shkarkimin e qeverisë.

Kjo do të thotë se Tsiprasit i duhen në parlament votat e socialdemokratëve për të fituar shumicën, sepse për këtë çështje ai nuk e ka shumicën e vet. Nga PASOK-u i dikurshëm ka zëra që do ta mbështesnin këtë marrëveshje. Ndërsa kryetari i Nea Demokratia është kundër. Partitë në Greqi për të satën herë janë përçarë rreth një "çështje nacionale". Në rrugën e një marrëveshjeje përfundimtare greko-maqedonase ka ende shumë pengesa. *(DW)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

# Adhuruesit e filmave horror janë më të zgjuar se të tjerët!



Adhuruesit e filmave horror nuk janë si të gjithë ata që pëlqejnë filma të zakonshëm. Ata nuk preferojnë të shikojnë një film në gjendje pasive, por analizojnë dhe presin çdo hollësi. Në përgjithësi, ata janë studentë të shkëlqyer dhe teoritë pse dikush ngjit shkallët me vrap pa mbyllur derën kryesore janë domethënëse për ta. Ka disa arsye pse fansat e filmave horror janë më inteligjentë se të tjerët.

**KANË NJOHURI TË GJERA.** Derisa dikush kërkon të shohë një film horror, me shumë mundësi gëzon njohuri nga të gjitha fushat, nuk kënaqet nga klishetë dhe i shijon më shumë ajo që është e re dhe aspak e zakonshme.

**NË PËRGJITHËSI, KANË INTERESA TË LARTA.** Tmerret e ndryshme që jepen në një film horror, u zgjon këtyre njerëzve hobe intelektuale të reja, përtej televizionit. Disa njerëz fiksohen edhe më shumë te profesionet e tyre, por të tjerë provojnë edhe hobe të reja. Po ashtu, një pjesë e tyre janë edhe lexues mjaft të mirë.

**JANË MENDIMTARË TË PAVARUR.** Njerëzit që tërhiqen nga filmat horror tërhiqen nga gjëra që nuk preferojnë t'i ndajnë me të tjerët dhe të mos flasin shumë për to. Është pikërisht ky shkaku pse një kategori e caktuar njerëzish tërhiqen për dikë që është i mënjanuar nga të tjerët dhe për ta bëhet intrigues dikush që jeton i strukur.

**JANË TË PRIRUR PËR TË ZBULUAR MISTERE.** Filmat horror kanë mistere brenda tyre, diçka që ka qëllim të zgjidhet. Çdo film horror merret me një element të panjohur - çfarë po ndodh? Pse po ndodh? Kush po e bën këtë? Në këtë mënyrë, edhe ai që e sheh bëhet një lloj agjenti, të cilit i duket vetja protagonist që jep të dhëna. Ai mund ta nuhasë vrasësin me milje larg.

**PREKIN ANËN E ERRËT TË JETËS.** Ndërkohë që të gjithë njerëzit e tjerë nuk preferojnë të mendojnë për vdekjen, fansat e filmave horror kanë forcën mendore për ta përqafuar atë dhe për të menduar shpesh për të - madje e shohin vdekjen edhe si formë argëtimi. Ata nuk interesohen fare çfarë mendojnë të tjerët për ta, thjesht janë të interesuar për të panjohurën.

**NUK JANË TË FRIKËSUAR NGA ASGJË.** Dhe kjo është e dukshme. Njerëzit që nuk tmerrohen, as nuk shqetësohen, do të thotë që janë të guximshëm dhe nuk ua pengon asgjë. Kanë aftësi për të kuptuar ç'ndodh përtej dhe kjo lloj aftësie i lejon ata të shijojnë më shumë se pjesa tjetër e atyre që mendojnë gjithmonë tmerrin dhe fundin e frikshëm.

# KOKËDHIMBJET NUK JANË GJITHMONË TË PARREZIKSHME



Secili prej nesh ndonjëherë vuan nga kokëdhimbjet, por ndonjëherë këto dhimbje janë aq të forta sa nuk mund t'i shpërfillni. Edhe pse jo të gjithë vuajnë nga kokëdhimbjet e rënda, ka edhe nga ata që përballen dhe luftojnë me to.

Ekspertët thonë se ekzistojnë lloje të caktuara të kokëdhimbjeve që mund të tregojnë se diçka nuk është në rregull me shëndetin tuaj. Kokëdhimbja që paraqitet kur jeni të ngarkuar nuk është shkak për shqetësim, përveç nëse shkakton dhimbje shumë të forta, transmeton Koha.net. Mund të merrni ilaçe kundër dhimbjeve dhe të vazhdoni me ditën tuaj.

Migrenat shkaktojnë dhimbje nga e moderuar deri në të ashpër, por mund të zgjasin gjatë - nga katër orë deri në tri ditë. Për fat të keq, shkaku nuk dihet. Kokëdhimbjet "cluster" janë kokëdhimbje shumë të dhimbshme dhe të rraskapitshme. Ato shfaqen në seri (klasterë, apo cluster nga ang.) që zgjasin disa javë në njërin sy ose rreth tij. Dhimbja është aq e fortë, saqë personi nuk mund të qëndrojë ulur.

Kokëdhimbja sinusore është pasojë e inflamacionit të sinusit. Dhimbja shkon nga hunda deri në ballë dhe mollëza. Kokëdhimbja hormonale është specifike për femrat gjatë periudhës së ndryshimeve hormonale (menstruacionet, menopauza, ose shtatzënia), përcjell Koha.net. Pilulat kontraceptive gjithashtu mund të shkaktojnë kokëdhimbje.

Ndihmën mjekësore duhet ta kërkoni nëse dhimbja e kokës ju zgjon nga gjumi, nëse dhimbja është e fortë dhe e mprehtë ose nëse si pasojë e humbni shikimin, keni nauze ose marramendje. Nëse mendoni se kokëdhimbja juaj është e pazakontë, është mirë ta vizitoni mjekun sepse nuk ekziston kujdes i tepërt kur bëhet fjalë për shëndetin tuaj.



# Dy sëmundje tinëzare që mund t'i keni dhe nuk e dini

Në botë ka shumë sëmundje, disa të lehta e pa komplikime, kurse disa të tjera kërcënuese për jetën e njeriut. Përderisa shumicën e sëmundjeve mund t'i njihni nga simptomat e tyre, janë disa sëmundje që nuk shfaqin fare simptoma. Këto shihen si më të tmerrshmet, pasi nuk mund ta kuptoni që vuani nga to deri të bëhet vonë. Në vazhdim ju njoftojmë me dy sëmundje për të cilat mund të mos i vëreni në pamje të parë si sëmundjet e tjera.

- Ndalja e frymëmarrjes gjatë gjumit. Kjo gjendje e rrezikshme ndodh kur frymëmarrja e një personi ndalet apo ndërpritet përgjatë gjumit. Për shkak të këtij çrregullimi, trupi dhe truri nuk mund të marrin oksigjen të mjaftueshëm. Kurse në mëngjes, ata që vuajnë nga kjo, mund të përjetojnë kokëdhimbje, dobësime kronike apo luhatje të disponimit.

- Kanceri i zorrës së trashë. Një nga format më tinëzare të kancerit, kanceri i zorrës së trashë, fillon si një vrimë jo kancerogjene në zorrë, dhe kështu nuk ka simptoma. Vrimat mund të rriten dhe të bëhen më të mëdha. Sapo kanceri të fillojë fazat e para, personi që vuan nga kjo mund të gjejë gjak në vaskën e WV-së, të përjetojë humbje peshe apo plogështi.

# Aplikacioni që tregon sa kafe duhet të pini

Shkencëtarët që punojnë për ushtrinë amerikane kanë vendosur të llogarisin sa kafe duhet të pimë. Më konkretisht, në një studim të publikuar, shkencëtari Jaques Reifman ka paraqitur një algoritëm që mund të përcaktojë se çfarë doze të kafeinës duhet të jetë për një funksionim optimal.

Ai po studion zhvillimin e softuerit dhe aplikacioneve në fushën e bioteknologjisë në ushtrinë amerikane. Algoritmi i tij thuhet se llogarit dozat e sigurta dhe efektive të kafeinës që do të shkaktojë një gjendje të zgjuar që na bën më produktive. Duke ditur se kafeina ndikon në të gjithë ndryshe, Reifman ka testuar performancën psikomotorike dhe këto të dhëna i vendosi në algoritëm.



Ekziston mundësia për të filluar zhvillimin e një aplikacioni publik, por për momentin nuk ka plane konkrete për një komercializim të tillë.

# FOTOGRAFIA E FYTYRËS MUND TË ZBULOJË NËSE JENI TË SËMURË



Kur u përballën me fotografitë e personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, të anketuarit me saktësi të lartë (në 81 për qind të rasteve) i veçuan ata persona që ishin me të vërtetë të sëmurë, njoftoi kështu ekipi shkencor i Institutit suedez Karolinska në Stokholm

Shkencëtarët në Suedi kanë zbuluar se në bazë të fotografisë së fytyrës në më shumë se 80 për qind të rasteve mund të konstatohet nëse një person është i sëmurë apo jo. Ata e konkluduan këtë në bazë të një studimi në të cilin të anketuarve u dhanë fotografi të personave të ndryshëm me pyetjen nëse besonin se bëhej fjalë për njerëzit e sëmurë apo jo. Rezultatet kanë treguar se për njerëzit, sipas të gjitha gjasave, është shumë e thjeshtë të konstatojnë nëse një person në foto është i sëmurë dhe nëse duhet të shmanget, transmeton koha.net.

Kur u përballën me fotografitë e personave të shëndetshëm dhe të sëmurë, të anketuarit me saktësi të lartë (në 81 për qind të rasteve) i veçuan ata persona që ishin me të vërtetë të sëmurë, njoftoi kështu ekipi shkencor i Institutit suedez Karolinska në Stokholm. Ekipi u drejtua nga neuroshkencëtari John Axelsson dhe i infektoi vullnetarët me bakterin e.Coli, i cili shkakton reagim inflamator, ndërsa grupi i kontrollit të njerëzve e mori vetëm një injeksion placebo.

Dy orë pas marrjes së injeksionit, vullnetarët u fotografuan normalisht dhe pas kësaj fotografitë iu treguan pjesëmarrësve të hulumtimit. Shkencëtarëve, përveç njohjes gjithashtu u interesonte të dinin se cilat janë karakteristikat specifike që i ndihmuan të anketuarit që të vendosin dhe të përcaktojnë nëse personat në fotografitë e treguara janë vërtet të sëmurë apo të shëndoshë. Në raundin e dytë të hulumtimit ata kaluan kohë duke u fokusuar në simptomat vizuale të sëmundjes në fytyrat e njerëzve.

Kjo i përfshiu buzët e zbehta dhe tenin e zbehtë, lëkurën e vijëzuar ose me shkëlqim, këndet e ulura të buzëve, dhe sytë e fryrë ose të skuqur. Me përjashtim të lëkurës me shkëlqim, të gjithë të pranishmit në hulumtim i identifikuan faktorët e mbetur si vendimtar në bazën e të cilëve i njohën personat e sëmurë në fotografi. Studiuesit në punimin e publikuar në Proceedings of the British Royal Society B paralajmëruan se mbështetja ekskluzivisht në analizën vizuale gjithsesi mund të jetë mashtruese.

Për shembull, fytyrat e personave të lodhur ose të pikëlluar mund të ngatërrohen gabimisht me ato të të sëmurëve. Ky fenomen përputhet me studimet e tjera të mëhershme të cilat sugjerojnë se në shoqëri shmangen shumë njerëzit e lodhur.

## Galaxy Note 9 me baterinë më të madhe ndonjëherë!



Samsung Galaxy Note 8 është një telefon i madh, por bateria e saj është mjaft e vogël në 3.300mAh. Megjithatë, Samsung Galaxy Note 9 mund të përmirësojë masivisht gjërat në atë zonë, pasi thuhet se ka një bateri prej 4.000mAh. Një bateri e madhe duket e mundshme. Në fakt, është një pretendim që kemi dëgjuar më parë , megjithëse jo të gjitha burimet bien dakord, me një rrjedhje më të hershme që tregon një bateri ende të madhe pre 3.850mAh. Një gjë që të gjitha burimet deri tani duket të bien dakord është sepse bateria do të bëhet më e madhe. Në tërësi, Samsung Galaxy Note 9 është duke u formuar si një "anije: e mirë, me një Snapdragon 845, 6GB ose 8GB RAM dhe potencialisht edhe një skaner të gjurmëve të gishtave në ekran.

## Shitet në Londër çanta më e shtrenjtë

Çantat Hermes Birkin ishte parashikuar të dominonin këtë sezon e si për të vërtetuar se janë më të kërkuarat e momentit, një e tillë u shit në Londër për 162.500 paundëve, është pse ishte 10-vjeçare.

Ky është rekordi i ri europian për një çantë dore të shitur në ankand. Himalaya Birkin, e prodhuar ne 2008-ten me tokëzën dhe një dry të vogël të zbukuruar nga diamante 18 karatësh, e kapërceu ndjeshëm çmimin e parashikuar të 100.000 paundëve. Rekordin global të një çante të shitur në ankand e mban po një Hermes Birkin - që u dha vitin e kaluar në Hong Kong për 253.700 paundë.

"Nuk ka absolutisht asnjë dyshim se bëhet fjalë për çantën më të çmuar të botës", thanë drejtues të shtëpisë së ankandeve "Christie's". Kjo ishte hera e parë që Hermes Birkin, e prodhuar në mënyrë artizanale një dekadë më parë me lëkurë krokodili, u ofrua në një ankand në Europë.

Çanta ishte në ato që cilësohen si kushte të një "shkalle 2", pra pa dëmtime të dukshme. Është 30 cm, çka do të thotë më e vogël sesa çanta origjinale Hermes dhe ndërthur në mënyrë të përsosur 450 diamantë, floririn e bardhë me lëkurën e jo një, por tre krokodilëve të Nilit të rritur në fermë, specie kjo që ka më pak kocka e përgjithësisht, lëkurë më të butë se të tjerët. Në të gjithë botën, ekzistojnë më pak se 50 çanta të tilla.





## Telefoni është i rrezikshëm kur murmuron, ja çfarë duhet të bëni!

Meteorologët thonë që edhe verës është mundësia më e madhe që reja të godasë ndërtesat e ulëta. Ndër pyetjet më të shpeshta të qytetarëve është se çfarë duhet të bëjnë kur fillon të murmurojë, aq më parë çfarë duhet bëjnë me celularin, të cilin gjithmonë e kanë me vete?

Telegrafi sjell disa këshilla të dobishme të meteorologëve:

- Kur dëgjoni murmurimën, ju jeni pothuajse në rrezik. Reja mund të godasë dhe kur shtrëngata është 16 km larg jush.

- Assesi mos kërkoni strehë nën drunj, aq më parë mos kërkoni strehë nën drurin e vetmuar.

- Nëse jeni në shtëpi dhe e dini që po ndodhë shtrëngata, mbyllni dyert dhe dritaret, fikni aparatet elektrike, posaçërisht ato të cilat në atë çast nuk ju duhen - bojleri, TV-ja...

- Nëse jeni në veturë, mos u frikësoni nga reja, nëse jenë në objekt të mbyllur qëndroni aty derisa të pushojë shtrëngata.

- Mbyllni veshët me duar që t'i mbroni membranën e veshit.

- Ruajuni nga vërshimet e rrugëve.

- Nëse gjendeni në ambient të hapur, assesi mos u shtrini në tokë, sepse atëherë me tërë sipërfaqen e trupit jeni në kontakt me tokën. Pozita më e mirë është të uleni galiç me kokën midis gjunjëve. Në këtë pozitë shmangni që me flokë të prekni tokën. Nëse shtrëngata ende nuk ka pushuar, assesi mos provoni që të rregulloni pjesët e dëmtuara të shtëpisë.

- Nëse vetëtin dhe murmuron, mos përdorni telefonat, pa marrë parasysh a janë ata fiks apo celularë. Celularët patjetër fikni, posaçërisht nëse jeni në hapësirë të mbyllur.

- Shmangni përdorimin e objekteve të metalta, sepse ata janë përçues të shkëlqyeshëm të energjisë elektrike.

- Nëse jeni duke peshkuar, menjëherë lëreni kallamin e peshkimit.

- Shmangni shtyllat e rrëzuara apo të dëmtuara, shtyllat e energjisë elektrike, largpërçuesit, trafostacionet dhe objektet e tjera, të cilat shërbejnë për shpërndarje të energjisë elektrike. Kurrë mos prekni kabllot apo çfarëdo teli nga metali apo bakri të cilët janë djegur, janë shkëputur apo në ndonjë mënyrë janë dëmtuar.

DEKORIMI I GAFURR MAZREKUT

# VAJZA E AZEM HAJDARIT: AKTI I SHËMTUAR

Me 13 vota pro dhe 1 abstenim, Këshilli Bashkiak i Hasit shpalli Gafurr Mazrekun, "Qytetar Nderi", me motivacionin "Personalitet Intelektual, me kontribut të pashoq ne Pushtetin Vendor"

Në historinë shqiptare Gafurr Mazrreku njihet si i vetmi njeri që ka shkrehur një armë në ambientet e Parlamentit. Ishte viti 1997 kur Mazreku, atëherë deputet i Partisë Socialiste, qëlloi në drejtim të rivalit të tij demokrat, Azem Hajdari, duke e plagosur atë.

Për këtë, Gafurr Mazreku u dënua me 8 vjet burg, ndërsa 21 vjet më pas nderohet nga Këshilli Bashkiak i Hasit. E bija e Azem Hajdarit, Rudina, tashmë deputete, tregon si e përjetoi këtë vendim.

"Ky është një akt i shëmtuar. Nuk dua t'i futem thellë shumë këtij debati, sepse i gjithë opinioni publik e di që ky është një akt shumë u shëmtuar për popullin shqiptar. Për vetë faktin se ky njeri ishte i pari që bëri një akt të tillë në Parlament. Ky është një njeri që është dënuar dhe është kriminel. Nuk ka hapësirë për të justifikuar këtë gjë. Por nga ana tjetër të mos harrojmë se ishte Azem Hajdari që e fali këtë njeri. Më vjen keq që ne po promovojmë që persona të tillë të lartësohen në këtë mënyrë", u shpreh Rudina Hajdari.



Partia Demokratike reagoi menjëherë duke e konsideruar Kryeministrin Rama si autorin e këtij vendimi. "Vendimi i përfaqësuesve të Edi Ramës në Këshillin Bashkiak të Hasit u mor 3 ditë pasi Partia Demokratike i bëri thirrje Kryetarit të Partisë Socialiste të Shqipërisë të ndalojë vendimmarrjen kriminale të këshilltarëve, të cilët janë plotësisht nën kontrollin e tij. Prandaj, Edvin Kristaq Rama nuk fshihet dot sot dhe as mund të lajë duart si Pilati! Partia Demokratike e konsideron atë vetë, autorin e vendimit kriminal që nderoi me titullin më të lartë atentatorin e Tribunit të Demokracisë Azem Hajdari", tha Gent Strazimiri.

Edhe Presidenti i Republikës reagoi ashpër përmes zëdhënësit Tedi Blushi, duke dënuar si një provokim titullin e dhënë në nder të Gafurr Mazrekut: "Çdo akt që evokon konfliktet ekstreme dhe dhunën kriminale duhet dënuar dhe evituar në jetën publike. Ky vendim është një provokim i panevojshëm, në tejkalim të vlerave e moralit të shoqërisë sonë dhe perspektivës të saj të qartë europiane. Dekorimi i personave të dënuar me vendim gjykate për plagosje me armë, nuk përputhet me standardet e një shoqërie demokratike."

Përmes një reagimi zyrtar, zyra e Kryeministrit u distancua nga vendimi i Këshillit Bashkiak Has, duke e konsideruar atë gjithashtu një provokim të papërgjegjshëm të kujtdo që e ka propozuar dhe e ka miratuar atë.

"Kryeministri Edi Rama bën me dije se i ka kërkuar Prefektit të Kukësit refuzimin e firmosjes së atij vendimi, ndërkohë që sot në mbledhjen e grupit parlamentar e ka dënuar këtë shfaqje të shëmtuar papërgjegjshmërie të këshilltarëve të Hasit, pavarësisht se në Këshillin Bashkiak të Hasit Partia Socialiste ka vetëm një këshilltar, i cili nuk ka votuar pro vendimit.

Kryeministria i konsideron akuzat e Partisë Demokratike si vulgare dhe shpërdorim politik të emrit dhe kujtimit të Azem Hajdarit".

*(Shqip)*

## Raporti për vizat, javën tjetër

Komisioni Evropian më 28 qershor të këtij viti pritet ta publikojë raportin për liberalizimin e vizave me Kosovën. Ky raport pritet të dëshmojë nëse vendi e ka plotësuar kriterin e fundit për vizat, përkatësisht luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

"Vlerësimi i përmbushjes së kriterit sa u përket dëshmive në regjistrin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është duke vazhduar", ka thënë një burim brenda Komisionit Evropian.

Delegacioni faktmbledhës i kryesuar nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, Simon Mordue, erdhi në Prishtinë vetëm pak kohë pasi Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, si njëri ndër dy kriteret e fundit në procesin e liberalizimit të vizave.




Derisa drejtuesit e Qeverisë shprehen të bindur se liberalizimi do ta marrë "dritën e gjelbër", përfaqësuesit e opozitës rekomandojnë që të mos përmenden afate, shkruan gazeta "Zëri"

Me fundin e këtij muaji (qershor) pritet të vijë edhe lajmi për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Se a do të jetë lajm i mirë ose jo do ta dëshmojë së shpejti raporti i Komisionit Evropian (KE), i cili pritet të tregojë qartë nëse është përmbushur ose jo kriteri i fundit për liberalizimin e vizave, përkatësisht lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Krerët institucionalë në vend shprehen të bindur se ky lajm do të jetë pozitiv për Kosovën.

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë të ditur për këtë gazetë se me 28 qershor të këtij viti KE-ja do të dalë me rekomandim pozitiv për Kosovën.

Pritjet që ky raport të jetë pozitiv janë mjaft të mëdha, kështu vlerëson për "Gazeta Blic", njohësi i çështjeve të integrimeve evropiane, Avni Mazreku."Komisioni Evropian, edhe në herën e kaluar ka dhënë një rekomandim pozitiv, mirëpo të kushtëzuar për liberalizimin e vizave, në atë kohë ky rekomandim ka nënkuptuar edhe plotësimin e dy kritereve. Njëri kriter ka qenë ratifikimi i marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi, dhe kriteri i dytë ka qenë lufta efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sa i përket kriterit të parë kjo mund të aludohet se është përfunduar pra është ratifikuar kjo marrëveshje, ndërsa kur flasim për luftën efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e dimë që në asnjë shtet të botës nuk është zhdukur totalisht krimi i organizuar dhe korrupsioni, mirëpo shtetet bëjnë luftë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit", thotë Avni Mazreku për "Gazeta Blic"

## Thaçi dhe Vuçiqi të dielën takohen në Bruksel

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij serb, Aleksandër Vuçiq do të udhëtojnë të dielën për në Bruksel.Televizioni publik i Serbisë, njofton se me këtë takim do të nisë faza e re e dialogut Kosovë-Serbi, përcjell Klan Kosova.RTS raporton se në prag të takimit Thaçi-Vuçiq, do të ketë takime të delegacioneve të të dyja vendeve për bisedime teknike.



## Daçiq: Ekziston një listë sekrete e vendeve që po lobojnë për Kosovën

Ministri serb i Punëve të Jashtme, Ivica Daçiq në një intervistë për televizionin "First TV" ka thënë se Serbia është e vetëdijshme se ekziston një dokument sekret për Prishtinën – nga një listë e vendeve perëndimore që po bëjnë presion për të ndryshuar qëndrimin e tyre për Pavarësinë e Kosovës, raporton Periskopi.

Daçiq tutje ka thënë se Prishtina po planifikon që të ushtrojë presion tek këto vende, me qëllim që të fitojë anëtarësimin në disa organizata ndërkombëtare.

Sipas tij, tashmë ekziston edhe lista e shteteve perëndimore që janë të ngarkuara për ushtrimin e këtij presioni.

Mediat serbe raportojnë se vendet që duhet të ushtrojnë presion për Prishtinën janë përzgjedhur duke u bazuar në ndikimin dhe afërsinë që e kanë për vendet që duhet të 'disiplinohen'. Me këtë nënkuptohen vendet që mund të kenë dyshime lidhur me votimin për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Në njërën anë, në listën e vendeve që po bëjnë presion thuhet se janë SHBA'ja, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe vende tjera, ndërsa në anën tjetër, thuhet se janë vendet të cilave po u bëhet presion, si Armenia, Algjeria, Bolivia, Egjipti, Xhamajka, Meksika, Nepali, Sllovakia, Tunizia, Zimbia dhe vende të tjera. Ministri i jashtëm serb mëngjesin e sotëm e konfirmoi se Serbia është e informuar për të gjitha planet që ai pretendon se po bëhen nga Prishtina qe një kohë të gjatë. Madje, sipas tij kjo listë tashmë është bërë publike. Përveç kësaj liste sekrete të vendeve që do të lobojnë për Prishtinën, Daçiq thotë se janë duke u ndërmarrë edhe shumë aktivitete të tjera në bashkëpunim me vendet perëndimore.

"Tashmë janë duke u mbajtur edhe takime. Por, dihet se kush është përgjegjës për vendin me të cilin po diskutohet", citohet të ketë thënë Daçiq. Tutje, ai ka folur edhe për raportimet e medieve se Kosova ka paguar lobistë për të lobuar për Pavarësinë e Kosovës. Sipas tij kjo nuk është sekrete. Madje, përmend dy shtëpi lobimi që sipas tij janë të angazhuara, njëra thotë se gjendet në Francë e tjera në SHBA. Daçiq i cili gjatë tërë kohës po bën presion tek vende të ndryshme për tërheqjen e njohjes së Kosovës, ka thënë se vendeve po u bëhen oferta të pahijshme për njohjen e Kosovës. Daçiq përmend çmimet e shtrenjta të lobimit, për të cilat thotë se sillen nga 600 mijë euro në 2 milionë dollarë në vit.

# SA I SIGURT ËSHTË KAMPIONATI BOTËROR NË RUSI?



Autoritetet e sigurisë në Rusi po ndërmarrin të gjitha masat që Kampionati të kalojë pa incidente. Por të shtunën ndodhi një rast që paralajmëron për rreziqet.

Një moment trishtues në Moskë. Një shofer taksije futet me makinën e e tij të verdhë të shtunën, në afërsi të Sheshit të Kuq, në masën e njerëzve të mbledhur. Ai ka lënduar shtatë persona, ndër ta edhe fansa të Meksikës. Shoferi ishte nga Kirgistani, një vend aziatik i banuar me shumicë myslimane. Shumëkush në Rusi kishte frikë se fjala ishte për një sulm terrorist.

Por vetëm pak më vonë erdhi shpjegimi nga kryetari i bashkisë në Moskë, Sergej Sobyanin. Shoferi i taksisë e ka humbur kontrollin ndaj makinës! Pra, fjala nuk ishte për një sulm terrorist. "Më vjen keq", tha shoferi. Ai kishte dashur që pas një dite të lodhshme të shkonte në shtëpi, "për të fjetur". Duket se ka qenë i stërlodhur. Këtë të hënë do të nxirret para gjykatës, thonë agjensitë ruse të lajmeve.

### PARALAJMËRIMET NGA SULMET

Por kjo ngjarje ka hapur debatin për sigurinë në vend. Ngjarja ka shkaktuar frikë tek organizatorët, politikanët dhe banorët e Rusisë dhe Moskës. Të premten e kaluar autoritetet amerikane kanë publikuar një paralajmërim për sulme të mundshme terroriste në Rusi. Rreziku më i madh është tek monumentet e rëndësishme, në trafik apo dhe vendet tjera ku mblidhen shumë njerëz.

Në fillim të prillit të këtij viti në metronë e Shën Peterburgut ka ndodhur një sulm, ku një atentator vetëvrasës ka vrarë 14 persona. Rreth 9.000 luftëtarë me nënshtetësi ruse janë duke luftuar në radhët e të ashtuquajturit Shteti Islamik apo në Lindjen e Mesme. Shumë prej tyre janë me origjinë nga Kaukazi Verior. Autoritetet ruse janë të vetëdijshme se në mesin e tyre mund të ketë edhe terroristë potencialë, të cilët duan të kryejnë sulme gjatë Kampionatit Botëror.

### FANSAT NUK KANË FRIKË

Megjithë këto rreziqe, dhjetëra mijëra fansa të fubollit vazhdojë të lëvizin në brendësi të Moskës dhe qyteteve të tjera, duke festuar fitoret e ekipeve të veta – sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Në veçanti të zëshëm janë fansat e Argjentinës, ndonëse ndeshja e parë e kombëtares së tyre përfundoi me rezultat dëshpërues (1:1) kundër Islandës.

Policia me uniforma mund të shihet gjithandej në qendër. Por ka dhe shumë forca të sigurisë me veshje civile. Gjithandej në mure janë vënë edhe kamera të sigurisë, me sistemet për njohjen e fytyrave. Në afërsi të stadiumeve Lushniki und Spartak janë krijuar zona të posaçme të sigurisë. Banorët duhet të kenë leje të posaçme për lëvizje rreth shtëpive të tyre. Supermarketet dhe dyqanet tjera nuk guxojnë të shesin alkool gjatë apo pas ndeshjeve.

Policia nuk ka kurfarë tolerance ndaj fansave që krijojnë incidente. Ajo është konsultuar me kohë edhe me autoritetet e vendeve të tjera që marrin pjesë në kampionat dhe ka kërkuar që fansave të dhunshëm të mos u jepen viza. Shtetasit e huaj gjithmonë duhet ta kenë me vete pasaportën. Ai që e ka harruar në hotel, mund të ketë probleme. Ndërsa në stadium mund të futesh vetëm me Fan-ID dhe biletë.

### PATRULLAT E RREPTA

Rreth stadiumeve dhe në stadiume po patrollojnë dhe kontrollojnë forca të mëdha të policisë, ushtrisë, njësive speciale dhe gardës kombëtare (të ashtuquajturit Kozakët). Çantat kontrollohen gjithandej, ndërsa njerëzit filmohen me kamera të sigurisë. Ka të dhëna të ndryshme për forcat e angazhuara në Moskë, por ekspertët flasin për shumë më shumë se 100.000 forca të sigurisë dhe mbi 20.000 ndihmës vullnetarë.

Ekspertët janë duke kontrolluar në sfond edhe rrjetet sociale. Telefonat e rasteve emergjente janë në funksion tërë kohën. Në Rusi kanë shkuar edhe ekspertë të sigurisë nga Gjermania, por ata nuk duan që t'u përmendet emri. Ata janë duke bashkëpunuar me autoritetet ruse. Rusia po bën të pamundurën që Kampionati Botëror të kalojë pa probleme, thonë ekspertët./*DW*

# Trump dhe Putin do takohen në muajin korrik?

Takimi mes presidentëve Trump dhe Putin mund të ndodhë muajin e ardhshëm, pas samitit të NATO's dhe para finales së Botërorit.

Lajmin e bëjnë të ditur gazetat ruse, që citojnë burime të mirë informuara.

Takimi i shumëpritur mes presidentëve Vladimir Putin dhe Donald Trump mund të ndodhë më shpejtë nga sa mendohej, më 13 ose 14 Korrik. Lajmin e bën të ditur e përditshmja ruse "Kommersant", që ka kryer një analizë të detajuar të agjendave të dy presidentëve.



Hipoteza është konfirmuar edhe nga burime të besueshme të gazetës, të cilat megjithatë janë treguar të moderuara.Në Bruksel, më 11 dhe 12 Korrik do të mbahet samiti i NATO's dhe kështu, për Trump takimi me Putin mund të përbëjë pikun e turit të tij europian. Ndërkohë, presidenti rus do të ketë kohë për të takuar homologun e tij dhe të kthehet në Moskë më 15 korrik, dita kur do të luhet finalja e Botërorit.Vendi i duhur për këtë takim, sipas llogarive të gazetës ruse, i bie të jetë Vjena

## LAJME SHKURT

### Masakër në Suedi

Malmo, 19 qershor - Një person hapi zjarr në qëndër të Malmo në Suedi duke vrarë dy persona e duke plagosur katër të tjerë. Ngjarja e rëndë ndodhi gjatë festimeve të tifozeve për fitoren që skuadra nordike arriti në botërorin e Rusisë kundër Korese se Jugut. Agresori besohet se ka përdorur një armë gjysmëautomatike të hapur zjarr në një ambjent teper të populluar.

Dëshmitaret thanë autori zbriti nga një makine dhe lëshoi 15-20 plumba drejt një grupi personash para një internet-kafe në qëndër të Malmos. Viktimat janë të moshës 18 dhe 29 vjec.

Ndërkohe policia nisi gjuetine ndaj autorit të kësaj ngjarje të rëndë mbrëmjen e së hënës.

### UNHCR: 68.5 milionë njerëz braktisën shtëpite e tyre

Një raport I publikuar nga UNHCR, bëri të ditur se gjatë vitit 2017 në të gjithë botën 68.5 milion njerëz u detyruan të lënë shtëpitë e tyre. Shkaqet për levizjen e dhjetera milion njerëzve nga shtëpite e tyre dhe vendosjen në vende të tjera janë të ndryshme.

Mbi të gjitha kjo gjë lidhet me luftërat në disa vende të botës, dhunën etnike dhe fetare në vende të tjera si dhe shkaqe natyrore. Problemet më të mëdha janë vërejtur në Republikën Demokratike të Kongos, Sudanin Jugor dhe Bangladesh. NUmri 68.5 milion I atyre që kanë lëvizur nga shtëpite e tyre gjatë vitit të kaluar është I njëjte më popullsinë e Tajlandës.

### Kim Jong-un viziton Kinën

Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong-un po zhvillon një vizitë dy-ditore në Kinë, një javë pas takimit me Presidentin amerikan, Donald Trump.

Pritet që ai të diskutojë sanksionet dhe angazhimin që ai bëri në samitin me Trump , në terma të përgjithshëm, për denuklarizimin e gadishullit korean.

Pekini, aleati i vetëm ekonomik i Koresë së Veriut, tashmë ka sugjeruar se sanksionet kundër Koresë së Veriut mund të lehtësohen.

### Kanadaja legalizon kanabisin

Parlamenti i Kanadasë, ka miratuar një ligj që legalizon kanabisin. Në këtë kontekst Kanadaja bëhet vendi i parë e vendeve të G7 që lejon konsumimin e lirshëm të drogës. Projektligji u miratua nga 205 vota në 82 në Dhomën e Komuniteteve. Legjislacioni tani duhet të kalojë në Senat dhe të marrë pëlqimin mbretëror nga guvernatori i përgjithshëm para se të bëhet ligj, ndoshta deri në shtator.

REPUBLIKA E MAQEDONISË/РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА/REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITETI I TETOVËS / УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО / UNIVERSITY OF TETOVO
zyraperarsim@unite.edu.mk, tel.: 0389 44 356 507, Tetovë, 1200

Në bazë të nenit 110 të Ligjit për arsim sipëror të RM-së, Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për studimet e ciklit parë, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për numrin e studentëve të cilët regjistrohen në Institucionet e arsimit të lartë në vitin e parë të studimeve në vitin akademik 2018/19 nr .44-4492/1 të datës 02.05.2018 (Gazeta zyrtare e RM-së nr.84, 9 Maj 2018), Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për kuota plotësuese për regjistrimin e studentëve të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë në Institucionet e arsimit të lartë në vitin e parë të studimeve në vitin akademik 2018/19 nr.44-4495/1 të datës 02.05.2018, Vendimin e Qeverisë së RM-së për numrin e kuotave për studentë në çdo program studimor, ku të drejtën e prindit e kryen vetëm njëri prind, të cilët do të paguajnë gjysmën e shumës për kuotë shtetëore, respektivisht për koofinancim në vitin akademik 2018/19 nr. 44-4492/1 të datës 02.05.2018, Vendimin e Këshillit të Rekotratit të Universitetit të Tetovës me datë 14.03.2018, Universiteti i Tetovës shpall:

## KONKURS

**për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve në programet studimore të Universitetit të Tetovës në vitin akademik 2018/19**

**I. Numri i studentëve:** në fakultetet e Universitetit të Tetovës, në studimet e ciklit të parë në vitin e parë të vitit akademik 2018/19, do të mund të regjistrohet numri i studentëve si në vijim:

| FAKULTETI Programi studimor Drejtimi | | Të rregullt me kuotë shtetërore | Shuma e pagesës për vit (Euro) | Të rregullt me koofinancim | Shuma e pagesës për vit (Euro) | Korrespodencë | Shuma e pagesës për vit (Euro) | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO-NATYRORE** | ECTS** | 275 | 200 | 195 | 400 | 10 | 400 | 480 |
| **Biologji** | 240 | 30 | 200 | 20 | 400 | | | 50 |
| Drejtimi arsimor | | | | | | | | |
| Biokimi | | | | | | | | |
| **Fizikë** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | | | 30 |
| Drejtimi arsimor | | | | | | | | |
| Profesional | | | | | | | | |
| **Kimi-Fizikë** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | | | 30 |
| **Kimi** | 240 | 25 | 200 | 15 | 400 | | | 40 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| Profesional | | | | | | | | |
| Biokimi analitike | | | | | | | | |
| **Matematikë drejtimi arsimor** | 240 | 30 | 200 | 30 | 400 | | | 60 |
| **Informatikë** | 240 | 50 | 200 | 40 | 400 | | | 90 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| Profesional | | | | | | | | |
| Telekomunikime dhe teknologji kompjuterike | | | | | | | | |
| **Informatika në biznes** | 240 | 25 | 200 | 25 | 400 | | | 50 |
| **Informatika në gjuhën angleze** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | | | 30 |
| **Gjeografi** | 240 | 20 | 200 | 15 | 400 | 10 | 400 | 45 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| Profesional | | | | | | | | |
| **Matematika financiare** | 240 | 15 | 200 | 10 | 400 | | | 25 |
| **Ekologji** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | | | 30 |
| **FAKULTETI FILOZOFIK** | ECTS | 125 | 200 | 105 | 400 | 40 | 400 | 270 |
| **Filozofi** | 240 | 15 | 200 | 10 | 400 | 5 | 400 | 30 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| **Sociologji** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | 10 | 400 | 50 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| **Histori** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | 10 | 400 | 50 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| Profesional | | | | | | | | |
| **Psikologji** | 240 | 30 | 200 | 30 | 400 | | | 60 |
| Profesional | | | | | | | | |
| **Filologji orientale** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | 10 | 400 | 50 |
| Gjuhë dhe letërsi Turke | | | | | | | | |
| Gjuhë dhe letërsi Arabe | | | | | | | | |
| **Etnologji dhe antropologji*** | 240 | 20 | 200 | 5 | 400 | 5 | 400 | 30 |
| **FAKULTETI PEDAGOGJIK** | ECTS | 95 | 200 | 80 | 400 | 30 | 400 | 205 |
| **Mësim klasor** | 240 | 25 | 200 | 25 | 400 | 10 | 400 | 60 |
| **Drejtimi parashkollor** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | 10 | 400 | 40 |
| **Pedagogji- drejtimi profesional** | 240 | 20 | 200 | 15 | 400 | 10 | 400 | 45 |
| **Edukim special dhe rehabilitim** | 240 | 30 | 200 | 30 | 400 | | | 60 |
| **FAKULTETI FILOLOGJIK** | ECTS | 115 | 200 | 155 | 400 | 70 | 400 | 340 |
| **Gjuhë dhe letërsi shqipe** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | 10 | 400 | 50 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| **Gjuhë dhe letërsi angleze** | 240 | 30 | 200 | 50 | 400 | 20 | 400 | 100 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| **Gjuhë dhe letërsi maqedonase** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | 10 | 400 | 50 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| **Gjuhë dhe letërsi gjermane** | 240 | 30 | 200 | 50 | 400 | 20 | 400 | 100 |
| Arsimor | | | | | | | | |
| **Filologji romane*** | 240 | 15 | 200 | 15 | 400 | 10 | 400 | 40 |
| Gjuhë dhe letërsi italiane | | | | | | | | |
| Gjuhë dhe letërsi frënge | | | | | | | | |
| **FAKULTETI I ARTEVE** | ECTS | 75 | 200 | 75 | 400 | | | 150 |
| **Art figurativ** | 240 | 25 | 200 | 25 | 400 | | | 50 |
| Drejtimi arsimor | | | | | | | | |
| Pikturë | | | | | | | | |
| Dizajn grafik | | | | | | | | |
| Skulpturë | | | | | | | | |
| Grafikë | | | | | | | | |
| **Art muzikor** | 240 | | | | | | | |
| **Drejtimi teorik-pedagogjik** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | | | 40 |
| Drejtimi pedagogjik | | | | | | | | |
| Dirigjim | | | | | | | | |
| Kompozim | | | | | | | | |
| Muzikologji | | | | | | | | |
| Etnomuzikologji | | | | | | | | |
| **Drejtimi vokal-instrumental** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | | | 40 |
| Solo këndim | | | | | | | | |
| Piano | | | | | | | | |
| Violinë | | | | | | | | |
| Fiz-harmonikë | | | | | | | | |
| Violë | | | | | | | | |
| Violonçelo | | | | | | | | |
| Kontrabas | | | | | | | | |
| Klarinet | | | | | | | | |
| Oboa | | | | | | | | |
| Kitarë | | | | | | | | |
| Flaut | | | | | | | | |
| Fagot | | | | | | | | |
| Tubë | | | | | | | | |
| Korno | | | | | | | | |
| Trombë | | | | | | | | |
| Instrumente me goditje | | | | | | | | |
| **Arti dramatik** | 240 | 10 | 200 | 10 | 400 | | | 20 |
| Aktrim | Pauzë | | | | | | | |
| Dramaturgji | Pauzë | | | | | | | |
| Regji teatri | Pauzë | | | | | | | |
| TV dhe regji filmi | | | | | | | | |
| Kamerë | | | | | | | | |
| Montazh (TV dhe montazh filmi) | | | | | | | | |
| **FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE** | ECTS | 40 | 200 | 40 | 400 | 0 | 400 | 80 |
| **Kulturë fizike dhe shëndetësi** | 240 | 40 | 200 | 40 | 400 | | | 80 |
| **FAKULTETI JURIDIK** | ECTS | 130 | 200 | 120 | 400 | 20 | 400 | 270 |
| **Studimet e drejtësisë** | 180 | 50 | 200 | 50 | 400 | 20 | 400 | 120 |
| **Studime në gazetari** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | | | 40 |
| **Studime politike** | 240 | 20 | 200 | 20 | 400 | | | 40 |
| **Studime politike në gjuhë angleze** | 240 | 20 | 200 | | | | | 20 |
| **Kriminalistikë** | 180 | 20 | 200 | 30 | 400 | | | 50 |
| **FAKULTETI EKONOMIK** | ECTS | 105 | 200 | 105 | 400 | 50 | 400 | 260 |
| **Financa dhe kontabilitet** | 240 | 25 | 200 | 25 | 400 | 10 | 400 | 60 |
| **Marketing dhe menaxhment** | 240 | 25 | 200 | 25 | 400 | 10 | 400 | 60 |
| **Ekonomi dhe biznes** | 240 | 25 | 200 | 25 | 400 | 10 | 400 | 60 |
| **Turizëm** | 240 | 15 | 200 | 15 | 400 | 10 | 400 | 40 |
| **Biznes ndërkombëtar** | 240 | 15 | 200 | 15 | 400 | 10 | 400 | 40 |
| **FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT** | ECTS | 70 | 200 | 70 | 400 | | | 140 |
| **Teknologji ushqimore** | 180 | 30 | 200 | 30 | 400 | | | 60 |
| **Të ushqyerit** | 180 | 20 | 200 | 20 | 400 | | | 40 |
| **Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit** | 180 | 20 | 200 | 20 | 400 | | | 40 |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE** | ECTS | 210 | 200 | 90 | 400 | 60 | 400 | 360 |
| **Mjekësi e përgjithshme** | 360 | 60 | 200 | 20 | 400 | | | 80 |
| **Stomatologji** | 300 | 40 | 200 | 20 | 400 | | | 60 |
| **Farmaci** | 300 | 30 | 200 | 20 | 400 | | | 50 |
| **Infermieri** | 180 | 40 | 200 | 10 | 400 | 20 | 400 | 70 |
| **Akusheri** | 180 | 20 | 200 | 10 | 400 | 20 | 400 | 50 |
| **Fizioterapi** | 180 | 20 | 200 | 10 | 400 | 20 | 400 | 50 |
| **FAKULTETI I ADMINISTRIM BIZNESIT-KUMANOVË** | ECTS | 60 | 200 | 60 | 400 | 40 | 400 | 160 |
| **Administrim biznesi** | 240 | 30 | 200 | 30 | 400 | 20 | 400 | 80 |
| **Administratë publike** | 240 | 30 | 200 | 30 | 400 | 20 | 400 | 80 |
| **FAKULTETI I BUJQËSISË DHE BIOTEKNOLOGJISË** | ECTS | 60 | 200 | 30 | 400 | 30 | 400 | 120 |
| **Prodhimtari bimore** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | 10 | 400 | 40 |
| **Prodhimtari shtazore** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | 10 | 400 | 40 |
| **Agrobiznes** | 240 | 20 | 200 | 10 | 400 | 10 | 400 | 40 |

VAZHDON →

REPUBLIKA E MAQEDONISË/РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА/REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITETI I TETOVËS / УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО / UNIVERSITY OF TETOVO
zyraperarsim@unite.edu.mk, tel.: 0389 44 356 507, Tetovë, 1200

| FAKULTETI I SHKENCAVE TE ZBATUARA | ECTS | 200 | *200* | 150 | *400* | | | 350 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ndërtimtari** | 180 | **40** | *200* | **30** | *400* | | | **70** |
| Konstruktive | | | | | | | | |
| Infrastrukturë dhe rrugë | | | | | | | | |
| **Arkitekturë** | 240 | **50** | *200* | **40** | *400* | | | **90** |
| **Mekatronikë** | 180 | **30** | *200* | **30** | *400* | | | **60** |
| **Komunikacion-Inxhinieri transporti** | 240 | **30** | *200* | **20** | *400* | | | **50** |
| **Gjeodezi dhe gjeoinformatikë** | 180 | **30** | *200* | **20** | *400* | | | **50** |
| **Inxhinieri ekonomike** | 180 | **20** | *200* | **10** | *400* | | | **30** |
| **Gjithsej** | | **1560** | | **1275** | | **350** | | **3185** |

** ECTS: Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive. 240 ECTS= studime që zgjasin katër vite (VIII semestra), 180 ECTS=studimet që zgjasin tre vite (VI semestra).

* Programe në proces të akreditimit. Regjistrimet do të bëhen vetëm nëse programet do të marrin vendimin për akreditim dhe leje pune.

## II. Kushtet dhe kriteret për regjistrim

1. Të drejtë regjistrimi për studimet e ciklit të parë kanë kandidatët që kanë dhënë maturën shtetërore ose maturë ndërkombëtare,

2. Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët kanë dhënë maturë shkollore ose provim përfundimtar. Nëse në afatin e parë nuk paraqitet numër i mjaftueshëm i kandidatëve që i plotësojnë kushtet sipas pikës paraprake, të drejtë për regjistrim kanë edhe kandidatët të cilët e kanë të kaluar maturën shkollore ose provimin përfundimtar në shkollimin e mesëm të caktuar në shkollat e mesme të verifikuara me akt të Ministrisë së arsimit dhe shkencës.

3. Të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve kanë edhe kandidatët me shkollim të mesëm katërvjeçar të cilët nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm katërvjeçar para vitit akademik 2007/08.

Përjashtim bëjnë, personat me talent të veçantë, të cilët mund t'i regjistrojnë studimet në fakultetet e drejtimit të arteve edhe nëse nuk e kanë të mbaruar shkollën e mesme katërvjeçare, me kusht që atë ta kryejnë deri në fund të vitit të dytë të studimeve, në kushtet e përcaktuara sipas Statutit të Fakultetit. Nëse personi nga paragrafi i mëparshëm nuk i plotëson kushtet e theksuara, e humb statusin e studentit në fakultetin përkatës.

4. Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt të financuar nga shteti dhe studentë të rregullt me bashkëfinancim të studimeve.

Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe studentë me korrespodencë, nëse këtë e mundëson karakteri i programit studimor.

5. Në studimet e ciklit të parë të fakulteteve mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer arsimim të lartë apo sipëror, në fakultetet e ngjashme dhe shkollat e larta. Këta kandidatë regjistrohen jashtë kuotës, më së shumti deri në **10%** nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në fakultetin përkatës të përcaktuar në Konkurs. Kandidatët nga paragrafi i mëparshëm regjistrohen sipas suksesit nga arsimimi i mëparshëm, përveç në programet studimore për të cilët, për shkak të specifikave nevojitet kontrollimi i talentit. Ngjashmërinë e vërtetojnë dhe e shpallin fakultetet. Kandidatët nga kjo pikë regjistrohen me koofinancim të studimeve, si dhe kandidatët nga kreu V i konkursit.

6. Mënyra e seleksionimit të kandidatëve do të kryhet varësisht nga lloji i programeve studimore në të cilat konkurrojnë ata, edhe atë:

a) programe studimore ku seleksionimi i kandidatëve do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm;

b) programe studimore ku seleksionimi do të kryhet në bazë të suksesit nga arsimi i mesëm dhe me kontrollim të talentit të kandidatëve. Kjo ka të bëjë me programet studimore me specifika të veçanta.

c) programe studimore ku mësimi mbahet në gjuhën angleze, ku seleksionimi do të kryhet nga suksesi i shkollimit të mesëm dhe rezultati nga intervistimi nga komisioni përkatës.

7. Kriter bazë për seleksionimin e kandidatëve për regjistrim të studimeve deridiplomike është suksesi i arritur në arsim të mesëm, vlerësimi i suksesit të studentëve shprehet me pikë.

a. Në programet studimore ku seleksionimi kryhet vetëm përmes suksesit të arsimit të mesëm, kandidatët mund të fitojnë më së shumti **100 pikë**, edhe atë: suksesi i përgjithshëm në të gjitha lëndët merr pjesë me **60%,** ndërsa suksesi i arritur në maturën shtetërore merr pjesë me **40%.**

a. 1. Në programet studimore ku seleksionimi do të kryhet vetëm në bazë të suksesit të arritur në arsimin e mesëm, llogaritja e pikëve bëhet në këtë mënyrë: mblidhen të gjitha notat, të cilat janë të evidentuara në dëftesat e notave nga të gjitha vitet, shuma e përgjithshme e fituar pjesëtohet me numrin e notave, kështu që suksesi mesatar i fituar shumëzohet me numrin 12. Me këtë më së shumti mund të fitohen 60 pikë.

a. 2. Llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore prej vitit 2013/14 bëhet në këtë mënyrë: rangimi sipas përqindjes nga provimi i lëndës eksterne, e cila jepet në maturën shtetërore shumëzohet me koeficientin 10. Në të njëjtën mënyrë llogaritet edhe përqindja e pikëve nga provimi i lëndës së dytë dhe tretë eksterne dhe mund të fitohen maksimum 30 pikë. Rangimi sipas notës së lëndës interne (Lista 2) e përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 1,2, me të cilën fitohen maksimum 6 pikë, ndërsa lënda interne jo e përshtatshme me 0,6 me të cilën fitohen më së shumti 3 pikë. Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0,8. Në këtë bazë mund të fitohen më shumti 4 pika. Suksesi i përgjithshëm nga matura shtetërore më së shumti mund të sjellë 40 pikë.

a. 3. Llogaritja e pikëve të suksesit të arritur nga matura shtetërore deri në vitin 2012/13 bëhet në këtë mënyrë: rangimi sipas përqindjes nga provimi i lëndës eksterne, e cila jepet në maturën shtetërore shumëzohet me koeficientin 10. Në të njëjtën mënyrë llogaritet edhe përqindja e pikëve nga provimi i lëndës së dytë eksterne dhe mund të fitohen maksimum 20 pikë.. Rangimi sipas notës së lëndëve interne (Lista 2) të përshtatshme për programin studimor shumëzohet me koeficient 1,6, me të cilën fitohen maksimum 16 pikë, ndërsa lënda interne jo e përshtatshme me koeficient 0,8 dhe mund të fitohen maksimum 8 pikë. Nota e fituar nga detyra e projektit shumëzohet me koeficientin 0,8. Në këtë bazë mund të fitohen 4 pikë. Suksesi i përgjithshëm nga matura shtetërore mund të sjellë maksimalisht 40 pikë.

a. 4 Për kandidatët të cilët shkollën e mesme e kanë mbaruar në vitet e mëparshme shkollore (para vitit shkollor 2007/2008) dhe nuk kanë mbaruar maturë shtetërore, përveç llogaritjes së pikëve nga pika 7. a. 1, llogariten edhe më së shumti 40 pikë nga lëndët të cilët janë të rëndësishme për programin studimor, edhe atë: shuma e notave nga dy lëndë të rëndësishme për programin studimor dhe dy lëndët nga lëmia e gjuhëve (gjuhë amtare dhe një gjuhë botërore) pjesëtohet me 16, dhe kështu, suksesi mestar i secilës lëndë veçmas shumëzohet me 8. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti 10 pikë për një lëndë, përkatësisht 40 pikë për katër lëndët.

a. 5 Vlerësimi i suksesit të kandidatëve të cilët kanë dhënë maturë shkollore ose provim përfundimtar të shkollimit të mesëm katërvjeçar bëhet: Notat e lëndëve të përshtatshme të cilat i kalojnë në maturë shkollore shumëzohen me koeficientin 1,6, ndërsa me lëndë jo të përshtatshme me 0,8, kurse detyra projektuese me 0,8. Me këtë mund të fitohen maksimum **20 pikë.**

a. 6 Vlerësimi i suksesit në programet studimore me kontrollim të talentit: mblidhen të gjitha notat që janë përfshirë në dëftesat, nga të gjitha vitet, shuma e fituar pjesëtohet me numrin e notave dhe kështu, suksesi mestar i fituar shumëzohet me 12. Në këtë bazë mund të fitohen më së shumti 60 pikë. Vlerësimi i suksesit nga kontrollimi i talentit bëhet me fitimin nga 0 deri në 40 pikë. Kontrollimi ka karakter eliminues me minimum 10 pikë, ndërsa në Fakultetin Pedagogjik me 20 pikë. Kontrollimi i njohurive sipas procedurës së njëjtë do të bëhet në mjekësi të përgjithshme, stomatologji dhe farmaci për kandidatët shtetas të huaj, kandidatë me lëndë interne dhe eksterne jo të përshtatshme, kanditatë me maturë shkollore, kandidatët të cilët kanë kryer shkollimin e mesëm jashtë RM-së dhe kandidatët që nuk kanë dhënë maturë shtetërore, respektivisht kanë përfunduar shkollimin e mesëm para vitit shkollor 2007/08.

Kandidatët të cilët arrijnë më pak se 40 pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve nuk do të pranohen.

## III. Seleksionimi i kandidatëve

1. Për përcjelljen e realizimit të Konkursit, Rektorati formon Komision universitar të Konkursit.

2. Për llogaritjen e pikëve nga suksesi i arritur nga arsimi i mesëm dhe nga suksesi i maturës shtetërore ose maturës shkollore, Rektorati formon Komisione të konkursit për secilin fakultet veçmas, ndërsa programet studimore ku bëhet kontrolli i talenit, formojnë Komisione edhe për kontrollimin e talentit. Komisioni universitar i Konkursit e përcjell realizimin e Konkursit, kujdeset për respektimin e përpiktë të dispozitave të Konkursit, jep udhëzime dhe mendime në procesin e realizimit të tij.

3. Rangimin e kandidatëve e kryejnë Komisionet e veçanta të fakulteteve.

4. Komisioni për Konkurs, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin sipas poenave nga suksesi i arsimit të mesëm (suksesin mesatar), pikët e lëndëve eksterne, interne dhe nga rezultatet e kontrollimit të talentit nga programet studimore në të cilat ai zbatohet (*në tabelën e rezultateve do të shpallen edhe të dhënat:numri i dosjes, emri, prindi dhe mbiemri, vendbanimi, shtetësia, suksesi për çdo vit shkollor, pikët e fituara nga matura shtetërore/shkollore, pikët e fituara dhe statusi i pranimit*)

Pas shpalljes së rang **listës preliminare** të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh përmes arkivit ose formës online. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura.

Kundërshtimi ka të bëjë vetëm me lëshimet teknike-gabime të bëra gjatë llogaritjes së pikëve, dhe i njëjti i drejtohet Komisionit universitar për pranimin e studentëve.

Aktvendimi i Komisionit është përfundimtar. Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni universitar i Konkursit në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimin e studentëve **(Rang lista përfundimtare)**, në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ato të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankimi.

**Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk do të bëjnë regjistrim, respektivisht nuk do të dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim në shërbimet studentore të fakultetit në të cilin janë pranuar, konsiderohet se kanë hequr dorë nga studimet dhe vendi i tyre do të shpallet si i lirë në Konkursin e radhës.**

5. Fakultetet në të cilët edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit do të mbeten vende të paplotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.

6. Nëse në afatin e parë regjistrues, gjatë rangimit, në fund të listës së kandidatëve të pranuar ka më shumë kandidatë me numër të barabartë të pikëve (më së shumti pesë kandidatë), fakulteti i regjistron të gjithë kandidatët e tillë. Por, nëse numri i kandidatëve të tillë është më i madh se 5 (pesë), atëherë fakulteti kandidatët e tillë i rangon sipas kritereve plotësuese: përshtatshmëria e projekt detyrës së punuar gjatë dhënies së provimit të maturës shtetërore, çmimet e fituara në garat republikane dhe ndërkombëtare, anëtarë të reprezentacioneve sportive të Republikës së Maqedonisë, certifikatat e fituara për njohje të gjuhëve të huaja në nivel më të lartë etj.

7. Studentët në kuotën shtetërore regjistrohen duke paguar kompensim për bashkëfinancim të studime, të përcaktuar si në kreun I të Konkursit në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RM. Kompensimi për studime të studentëve nga paragrafi paraprak, për secilin program studimor në veçanti, është pjesë përbërëse e këtij konkursi. Pagesa e kompensimit kryhet në dy këste të barabarta.

Kompensimi nga paragrafit 1 i kësaj pike, studentët e dorëzojnë për çdo semestër sa zgjasin studimet e tyre me të gjitha detyrimet tjera financiare të përcaktuara me Aktvendim nga ana e universitetit. .

8. Drejtoria e Rektoratit sjell Udhëzim të veçantë për realizimin e Konkursit.

## IV. Regjistrimi i studentëve me korrespodencë

1. Në programet studimore të veçanta në fakultete, si student me korrespodencë mund të regjistrohen kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për regjistrim dhe kanë kontratë për punësim në kohë të pacaktuar, si dhe kandidatët të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk kanë mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt. Si shkaqe të arsyeshme nga paragrafi paraprak llogariten: invalid, i cili nuk është në gjendje ta ndjek mësimin e rregullt; sëmundje e rëndë afatgjate, e cila pamundëson vijimin e rregullt të mësimit më tepër se një semestër; prind i fëmijës deri sa zgjatë pushimi i lehonisë.

2. Studentët me korrespodencë regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta si studentët e rregullt, ndërsa rangohen në lista të veçanta të rangimit.

Studentët me korrespodencë regjistrohen me koofinancim të studimeve, sipas shumës së paraqitur në tabelën nr. I.

3. Gjatë paraqitjes për regjistrim, si studentë me korrespodencë, kandidatët dorëzojnë dëshmi për punësim në kohë të pacaktuar, ose vërtetim mjekësor për shkaqet e theksuara në pikën 1, paragrafi 2.

## V. Regjistrimi i studentëve me koofinancim të studimeve

1. Në fakultetet, si studentë të rregullt regjistrohen edhe kandidatë që i plotësojnë kushtet për regjistrim, ndërsa për shkak të kufizimit të kuotave nuk mund të regjistrohen në kategorinë e studentëve të financuar nga shteti.

2. Studentët që regjistrohen në këtë kategori, shumën e përcaktuar në kreun I të Konkursit e paguajnë në kundërvlerë të denarit, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RM-së, në ditën e pagesës, në së paku 2 këste të barabarta.

3. Fakulteti shpall listën e rangimit të kandidatëve që i plotësojnë kushtet për regjistrim në këtë kategori. Kandidatët që pajtohen të regjistrohen në këtë kategori studentësh, dorëzojnë deklaratë në afat prej 24 orësh pas shpalljes së listës përfundimtare të rangimit, se pajtohen gjatë gjithë kohës së studimeve të marrin pjesë në koofinancim të studimeve. Studenti i cili regjistron studimet sipas rezultateve të pranimit në koofinacim, konsiderohet se pranon të koofinancojë studimet.

Listën e kandidatëve të pranuar në këtë kategori e vërteton Komisioni i Konkursit në bazë të listës së rangimit dhe deklaratave të dorëzuara për pajtueshmëri për regjistrim në këtë kategori. Studentët me bashkëfinancim gjatë regjistrimit lidhin kontratë me fakultetin, për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në realizimin e procesit edukativo-arsimor.

## VI. Kandidatët me arsim të mesëm të kryer jashtë vendit

### a) Shtetasit e huaj

1. Shtetasit e huaj regjistrohen jashtë kuotave të përcaktuara në Konkurs dhe numri i tyre mund të jetë 20% nga numri i përgjithshëm i studentëve të përcaktuar me konkurs në nivel të fakultetit, përveç programeve studimore ku mësimin realizohet në gjuhën angleze.

2. Seleksionimi i shtetasve të huaj që paraqiten për studim në programet studimore të Mjekësisë së përgjithshme, Stomatologjisë, Farmacisë, Kulturës fizike, Artit dramatik, figurativ dhe muzikor, Kriminalistikë, Fakultetin pedagogjik programet studimore që mbahen në gjuhën angleze, Arkitekturë **kryhet me anë të kontrollit të diturive dhe aftësive.**

3. Gjatë paraqitjes, kandidatët e theksojnë në cilin fakultet, respektivisht program studimor dëshirojnë të studiojnë, se a janë bursistë të qeverisë së tyre, apo vetë i bartin shpenzimet e studimeve. Me fletëparaqitje dorëzojnë diplomë për mbarimin e arsimit të mesëm, si dhe dëftesa për të gjitha klasat, përkthim të vërtetuar të certifikatës së lindjes, vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase ose shqipe (të dhënë nga komisioni i Universitetit), dhe certifikatë për gjendjen shëndetësore (Hepatit C dhe Hiv). Shtetasit e huaj, për diplomën për mbarimin e shkollës së mesme, si dhe dëftesat për të gjitha klasat, para fillimit të vitit akademik duhet të dorëzojnë vendimin për nostrifikim nga institucioni kompetent i RM-së, respektivisht dokumentet për fillimin e procedurës për nostrifikim.

Universiteti organizon kurs përgatitor për mësimin e gjuhës shqipe dhe maqedonase në Qendrën për gjuhë dhe trajnime, ndërsa kandidati kryen detyrimet e duhura për ndjekjen e kursit.

Pagesa e studimeve për shtetasit e huaj për vitin 2018/19 është 300 euro për një semestër respektivisht 600 për një vit akademik, në programet studimore Infermieri, Fizioterapi dhe Akusheri, Shkencat e Zbatuara një semestër është 500 euro, respektivisht 1000 euro për një vit akademik, në programin studimor Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci, në të cilat pagesa e shkollimit është në shumë prej 1000 euro respektivisht 2000 për një vit akademik, nëse nuk është rregulluar ndryshe me kontratë për bashkëpunim të ndërsjellë mes universiteteve. Në këtë kategori të studentëve bëjnë pjesë edhe kandidatët, shtetas të huaj, prindërit e të cilëve apo vetë ata punojnë në përfaqësitë diplomatike në Republikën e Maqedonisë.

Kandidatët shtetas të Republikës së Turqisë do të mund të regjistrohen vetëm sipas kritereve të miratuara nga ana e Këshillit për arsim të lartë të Republikës së Turqisë-YOK, të cilët duhet të dorëzojnë dëshmi për dhënien e provimit pranues të organizuar nga YGS.

Shtetasit e huaj e mbajnë statusin e njëjtë deri në diplomim.

b) **Mërgimtarët dhe shtetasit e RM-së me arsim të mesëm të kryer në tërësi dhe me arsim të mesëm të kryer pjesërisht jashtë vendit, kanditatë me maturë ndërkombëtare dhe kanditatë me shkollim të mesëm privat në RM**

1. Kandidatët, prindërit e të cilëve janë mërgimtarë dhe kandidatët shtetas të RM, që **arsimin e mesëm të plotë** e kanë kryer jashtë vendit regjistrohen jashtë kuotave, me koofinancim të studimeve.

2. Seleksionimi i kandidatëve nga pika 1, në programet studimore të Mjekësisë së përgjithshme, Stomatologjisë, Farmacisë, Kulturës fizike, Artit dramatik, figurativ dhe muzikor, Kriminalistikës, Arkitekturë dhe Fakultetin pedagogjik **kryhet me kontrollim të njohurive dhe aftësive**.

3. Kompensimi për studime i kësaj kategorie të studentëve, në varësi të programeve studimore, është përcaktuar në kreun I të Konkursit (si për kandidatët nga kreu V), respektivisht 400 euro një vit akademik.

Kandidatët nga paragrafi i parë, mund të regjistrohen edhe sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Konkurs për kandidatët me arsim të mesëm të kryer në RM, në kuadër të kuotës shtetërore.

Kandidatët nga pika 1, bashkë me fletëparaqitjen dorëzojnë diplomë të nostrifikuar si dhe dëftesa të nostrifikuara për katër vitet e kryera të arsimit të mesëm jashtë vendit.

4. Kandidatët shtetas të RM-së, që një **pjesë të arsimit të mesëm** e kanë kryer jashtë vendit dhe kandidatët me maturë të mbaruar ndërkombëtare, regjistrohen me kushte dhe kritere të njëjta, si dhe kandidatët me shkollë të mesme të mbaruar në Republikën e Maqedonisë, me atë që përveç dokumenteve të tjera, dorëzojnë edhe dëftesa të nostrifikuara për pjesën e arsimit të mesëm të kryer jashtë vendit, përkatësisht me maturë të kryer ndërkombëtare.

VAZHDON →

REPUBLIKA E MAQEDONISË/РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА/REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITETI I TETOVËS / УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО / UNIVERSITY OF TETOVO
zyraperarsim@unite.edu.mk, tel.: 0389 44 356 507, Tetovë, 1200

Këta kandidatë rangohen në rang - listë të veçantë, kurse do të pranohen ata kandidatë të cilët do të fitojnë aq pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kuadër të kuotës shtetërore në programin studimor përkatës. Numri i këtyre kandidatëve mund të arrijë më së shumti 10%, kurse shpenzimet për studimet e tyre i bart Ministria për Arsim dhe Shkencë.

Kandidatët të cilët kanë fituar pikë, të paktën sa edhe kandidati i fundit i pranuar në kategorinë me koofinancim të studimeve, regjistrohen me kompensim për studime në lartësi të përcaktuar sipas kreut I të Konkursit. Për kandidatët të cilët regjistrohen në këtë kategori, me koofinancim të studimeve, vlejnë dispozitat nga kreu V i Konkursit.

Kandidatët nga kreu i VI, paraqiten në Rektoratin e UT-së, në afatet e përcaktuara me Konkurs.

5. Kanditatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm privat në RM, të cilët kanë dhënë maturë shtetërore, regjistrohen sipas kushteve dhe kritereve të njëjta me kanditatët që kanë kryer shkollim sipas kreut 1 të konkursit.

6. Kanditatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm privat, pa maturë shtetërore, regjistrohen me koofinancim të studimeve, deri në 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve për program studimor.

**VII. Kandidatët me të drejta të veçanta të përcaktuara sipas ligjeve të RM si dhe kandidatët të cilët pranohen në kuadër të kuotës së bashkësive të cilët nuk janë shumicë në R. Maqedonisë.**

1. Numri i studentëve, që i takojnë kategorisë së personave me të drejta të veçanta të përcaktuara me Ligjin për të drejta të veçanta të RM, regjistrohen në kuotë të veçantë (pa bartje të shpenzimeve për studime), numri i tyre mund të arrijë më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i studentëve në nivel të programit studimor.

2. Për sigurimin e përfaqësimit të drejt të kandidatëve të cilët u takojnë bashkësive të cilët nuk janë shumicë në R.Maqedonisë, në institucionet e larta të Universitetit, në vitin akademik 2018/19, në mënyrë plotësuese do të regjistrohen kandidatët të cilët u takojnë këtyre bashkësive, numri i të cilëve të mos e kalon 10 % nga numri i përgjithshëm i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë në nivel të fakultetit. Në kuadër të kësaj përqindjeje, në mënyrë të drejtë do të përfaqësohen kandidatët e të gjitha bashkësive, deri në përqindje me të cilin bashkësia është përfaqësuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në R.Maqedonisë.

3. Gjysmën e vlerës për regjistrim në kuadër të kuotës shtetërore dhe koofinancim të studimeve në vitin akademik 2018/19 do ta paguajnë studentët për të cilët të drejtën e prindit e realizon vetëm një prind dhe atë:

| Programet studimore me numër të vendeve në kuotë shtetërore (kreu I) | Numri i studentëve që mund të regjistrohen | Programet studimore me vende të lira me koofinancim (kreu I) | Numri i studentëve që mund të regjistrohen |
|---|---|---|---|
| Prej 20 deri 40 vende të lia | 1 | Prej 20 deri 40 vende të lia | 1 |
| Mbi 40 vende të lira | 2 | Mbi 40 vende të lira | 2 |

Mjetet e participimit për këto kanditatë do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

**VIII. Afatet për paraqitje, kontrollimin i njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi**

| REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2018/19 | AFATI I | AFATI II | Afati III |
|---|---|---|---|
| **Aplikimi (paraqitja e kandidatëve)** | **27-31 gusht** | **11-14 shtator** | **24-25 shtator** |
| **Kontrolli i njohurive dhe aftësive** (për programet dhe kategoritë e caktuara) | **1 shtator** | **15 shtator** | **26 shtator** |
| **Shpallja e rezultateve preliminare dhe afati i ankesave** | **3 shtator** | **17 shtator** | **27 shtator** |
| **Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve** | **4 shtator** | **18 shtator** | **28 shtator** |
| **Regjistrimi i kandidatëve** | **4, 5, 6, 7 shtator 2018** | **18-21 shtator 2018** | **1-3 tetor 2018** |

**IX. Dokumentet për aplikim dhe regjistrim**

1. **Kanditatët e plotësojnë formularin online në ueb faqen: www.unite.edu.mk (Regjistrimet 2018/19) me të dhënat përkatëse dhe sipas udhëzimeve që kërkohen;**
2. **Fletëaplikim** (merret në administratë gjatë dorëzimit të dokumenteve);
3. **Dëftesa origjinale nga shkollimi i mesëm;**
4. **Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme;**
5. **Certifikatë nga libri amzë i të lindurve;**
6. **Certifikatë për nënshtetësi;**
7. **Vërtetim për pagesat e:**

a) **1050 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

b) **600 denarë** mjete plotësuese për secilën lëndë të cilës kandidatët do ti nënshtrohen për provim pranues të theksuar në Listën shtesë-**1**, të Programit studimor përkatës, ku është paraparë provimi pranues: në emër të Komisionit për verifikimin e njohurive dhe aftësive dhe intervistimit (për programet në gjuhën angleze)

Kandidatët që aplikojnë në programet ku mundësohen studime me korrespodencë, krahas dokumentacionit të caktuar më lartë, duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse për arsyetimin e këtij statusi sipas kritereve të përcaktuara në këtë konkurs. Kanditatët të cilët aplikojnë në bazë të kuotës së veçantë, dorëzojnë dokumentet të cilat dëshmojnë kategorinë përkatëse.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (**pas shpalljes së listës përfundimtare**), gjatë **regjistrimit** duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studenti regjistrohet)
2. Tre fotografi ( *dy* fotografi 6 x 9 dhe *një* – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:

▪ **100 denarë** në xhiro-llogarinë 2401901047494695 (banka e pranuesit: Uni Banka AD Skopje): në emër të Parlamentit të studentëve në Universitetin e Tetovës (SHPSUSHT)

---

▪ **1200 denarë,** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indexit.

▪ **750 denarë,** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.

▪ **Pagesën e mjeteve për semestrin e parë:** në emër të Komisioneve për vërtetimin e diturisë dhe dijes.

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti Shtetëror i Tetovës,
❖ Në ,,banka e marrësit" (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
❖ Në ,,llogaria" (**сметка**) – 100000000063095,
❖ Në ,,shuma" (**износ**" – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,
❖ Në ,,llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues" (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**" – 1600160054 788 10;
❖ në ,,shifra dhe programi i të hyrave" (**приходна шифра и програма**) – 723**019** 43, ndërsa në ,,mënyra" (начин) – 2;
❖ Në ,,thirrja në numrin" (**повикување на број – задолжување**) shënohet numri i fakultetit në të cilin studion, në këtë mënyrë:

- 723019 – 01: Fakulteti Ekonomik,
- 723019 – 02: Fakulteti Juridik,
- 723019 – 03: Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore,
- 723019 – 04: Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë,
- 723019 – 05: Fakulteti Filologjik,
- 723019 – 06: Fakulteti Filozofik, Fakulteti pedagogjik
- 723019 – 08: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë
- 723019 – 09: Fakulteti i Kulturës Fizike,
- 723019 – 10: Fakulteti i Arteve,
- 723019 – 11: Fakulteti i Administrimit të Biznesit.
- 723019 – 07: Fakulteti Shkencave të Zbatuara,

❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës (kontrollimi i njohurive dhe aftësive, semestri etj)

Konkursi është shpallur në faqen e internetit: http://www.unite.edu.mk

**Lista 1. Programet studimore në të cilat përveç zgjedhjes së lëndëve interne adekuate të dhëna në listën nr. 2, për shkak të specifikave të studimit kryhet kontrollimi i talentit dhe njohurive**

Programet studimore në të cilat regjistrimi bëhet ***me provim pranues:***

a) Mjekësi e përgjithshme
b) Stomatologji
c) Farmaci
e) Art figurativ
f) Art muzikor
g) Art dramatik
h) Kulturë fizike: Aktivitet fizik, rekreacion dhe shëndetësi, Sport
i) Informatika në gjuhën angleze
j) Studime politike në gjuhën angleze
k) Kriminalistikë
l) Mësim klasor
ll) Drejtim parashkollor
m) Arkitekturë

**1. Kontrollimi i njohurive për të gjithë kandidatët:**

**1.1 Fakulteti i Arteve**

- **Kontrollimi i talentit në programin studimor të Artit figurativ do të mbahet në:**

a. Vizatim –portret i modelit të gjallë

**- Kontrollimi i talentit në programin studimor të Artit muzikor do të mbahet në:**

a) Solfezh b) Piano obligat c) Harmoni

**- Kontrollimi i talentit në programin studimor të Artit dramatik do të mbahet në:**

A. Ndjenjë e ritmit dhe dëgjimit,
B. Interpretimi i një monologu dramatik dhe i një kënge nga zgjedhja e kandidatit dhe një nga zgjedhja e Komisionit,
C. Improvizimi i temës së dhënë;

- Drejtimi **Regjia e filmit dhe TV:**

A. Ese (punim me shkrim) në temën e dhënë (analiza e një filmi artistik) dhe bisedë me kandidatët;

-Drejtimi **Montazh**:

A. Kontrollim i talentit muzikor
B. Provim me shkrim- analizë e montazhit të filmit të treguar në një film artistik

-Drejtimi **Kamerë:**

A. Prezantim i koleksionit personal të fotografive (10 fotografi bardh e zi, të përpunuara në laboratorin fotografik në konvencionin jo digjital me teknikë fotografike dhe format më të vogël 18 x 24 cm)
B. Informimi, motivimi si dhe përcaktimi i njohurive, dhe shkathtësive të kandidatëve për studime në artin dramatik do të përcaktohet përmes bisedës me kandidatët.

Provimet në të gjitha programet, respektivisht drejtimet e Fakultetit të Arteve do të mbahen në hapësirat përkatëse të programeve më: **1 shtator 2018 (e shtunë), ora 10.$^{00}$**. (për informata më të hollësishme vizitoni faqen zyrtare të Universitetit)

**1.2. Fakulteti i Kulturës Fizike - Provimi pranues në Programin studimor Kulturë fizike, Aktivitet fizik, rekreacion dhe shëndetësi, Sport do të mbahet nga:**

A. Not
B. Hendboll, basketboll,volejboll, gjimnastika sportive
C. Atletikë

Provimi pranues do të mbahet më: **1 shtator 2018 (e shtunë) ora 09$^{00}$** në hapësirat e Fakultetit të Kulturës fizike. Kandidatët me vete duhet të marrin përgatitje sportive dhe dokument identifikimi.

**1.3 Intervista në programet studimore ku mësimi do të mbahet në gjuhën angleze:**

Intervista për njohurit dhe aftësitë në gjuhën angleze para komisionit përkatës do të mbahet më: **1 shtator 2018 (e shtunë) ora 10$^{00}$,** në hapësirat e Universitetit afër Rektoratit.

**1.4 Kriminalistikë:**

Provimi pranues do të mbahet më: **1 shtator 2018 (e shtunë),** në hapësirat e Fakultetit Juridik në:

A. Testim psikologjik në inteligjencë joverbale: ora **10$^{00}$**
B. Testimin e lëvizjeve motorike: ora **12$^{30}$**: kandidatët duhet të kenë përgatitje sportive

**1.5 Fakulteti pedagogjik:mësim klasor dhe drejtimi parashkollor**

**Provimi do të mbahet më 1 shtator 2018, në këto fusha:**

- Testim i aftësive intelektuale, test i inteligjencës jo verbale dhe Intervistë e strukturuar për aftësitë e komunikimit ora **09$^{30}$**
- Testimi i lëvizjeve motorike: ora **13$^{00}$**: kandidatët duhet të kenë përgatitje sportive

**1.6 Fakulteti i Shkencave të Zbatuara - provimi pranues në Arkitekturë do të mbahet nga:**

- **A.** Vizatim – kreacion i lirë i objekteve
- Provimi pranues do të mbahet më: **1 shtator 2018 (e shtunë) ora 10$^{00}$** në hapësirat e në hapësirat e Arkitekturës.

**2. Programet studimore, lloji dhe përmbajtja e testimit/seleksionimit (përmes kontrollit të njohurive dhe aftësive) për kandidatët të cilët kanë kryer shkollim të mesëm dhe nuk kanë dhënë maturë shtetërore (2007/08), shtetas të RM-së me shkollim jashtë shtetit, kandidatë me lëndë interne dhe eksterne jo të përshtatshme dhe kandidatë shtetas të huaj:**

**2.1 Provimi pranues në programet studimore të Mjekësi të përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci:**

A. Biologji (njohuri të fituara nga arsimi i mesëm)
B. Kimi (njohuri të fituara nga arsimi i mesëm)

*Kandidatët të cilët nga lëndët A dhe B, kanë dhënë së paku njërën në lëndë eksterne ose interne, provimit pranues do t'i nënshtrohen vetëm në njërën nga lëndët. Kandidatët të cilët lëndët e përmendura i kanë në pjesën interne, komisioni qendror do të sjell vendim për pjesëmarrje në provim pranues.*

Provimi pranues do të mbahet më: **1 shtator 2018 (e shtunë) ora 11$^{00}$,** *në hapësirat e Universitetit te objekti i ri (rektorati).* Kandidatët duhet të kenë me vete dokument identifikimi.

**Lista 2. Lëndët interne dhe eksterne të përshtatshme për regjistrim**

| Fakulteti | Lëndë eksterne dhe interne të përshtatshme | |
|---|---|---|
| **Fakulteti i shkencave matematike-natyrore** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Informatikë, matematikë, biologji, kimi ose një lëndë nga fusha e shkencave natyrore, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti Filozofik** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Informatikë, matematikë, biologji, sociologji, histori, gjuhë e huaj, filozofi, estetikë, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti Pedagogjik** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Pa kufizim |
| **Fakulteti Filologjik** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Gjuhë e huaj, Informatikë, matematikë, sociologji, filozofi, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti Ekonomik** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Gjuhë e huaj, Informatikë, matematikë, biznes, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti Juridik** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Kriminalistikë: pa kufizim<br>Gjuhë e huaj, matematikë, histori, filozofi, estetikë, sociologji, biznes, filozofi varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti i Arteve**<br><br>**Fakulteti i Kulturës fizike** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Pa kufizim |
| **Fakulteti i Shkencave Mjekësore** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | *Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji, Farmaci:*<br>Kimi, biologji,<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e shëndetësisë<br>*Infermieri, Akusheri, Fizioterapi:*<br>Informatikë, biologji, kimi, gjuhë e huaj, varësisht lëndëve eksterne<br>Lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale nga profili i arsimimit |
| **Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Informatikë, biologji, matematikë, gjuhë e huaj, kimi, fizikë, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti i Administrim biznesit-Kumanovë** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Gjuhë e huaj, matematikë, informatikë, filozofi, biznes, sociologji, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti i Bujqësisë dhe bioteknologjisë** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | Informatikë, matematikë, biologji, kimi ose një lëndë nga fusha e shkencave natyrore, , gjuhë e huaj, fizikë varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale në fushën e caktuar |
| **Fakulteti i Shkencave të Zbatuara** | Gjimnaz<br>Shkollë profesionale<br>Shkolla e mesme artistike | *Arkitekturë*: pa kufizim<br>*Programet tjera studimore*:<br>Informatikë, matematikë, kimi, fizikë, estetikë, gjuhë e huaj, varësisht lëndëve eksterne<br>Një lëndë nga lista e përgjithshme e lëndëve profesionale |

Për të gjitha Fakultetet dhe Programet studimore, lëndën e dytë interne, respektivisht lëndën interne, maturanti e zgjedh nga lista e lëndëve profesionale në varshmëri prej profilit të përgatitjes arsimor të kandidatit.

SHKËNDIJA KUNDËR TNS NË "CHAMPIONS"

# OSMANI: KUNDËRSHTAR SERIOZ, POR DO TË BËJMË ÇMOS QË TA ELIMINOJMË

Skuadra nga Uellsi ndoshta ka qenë kundërshtari më i dëshirueshëm prej favoritëve që ishin në këtë vazo dhe që kishin mundësi ti bien Shkëndijës. Kur them më i dëshirueshëm nuk them se është kundërshtar i dobët. Përkundrazi, bëhet fjalë për një ekip i cili në Evropë pa 50 ndeshje, kurse në kampionat është shpallur 12 herë kampion, që donë të thotë se bëhet fjale për një ekip serioz, megjithatë ne do të bëjmë çmos që ta kalojmë këtë xhiro", pohon trajneri i kuqezinjve Osmani



*Shkup, 19 qershor* - Ka qenë me fat Shkëndija e Tetovës, në kompeticionin e Ligës së kampionëve. Kuqezinjtë peshkuan kundërshtarin më të dobët nga vazoja e tyre dhe do të kenë përballë uellsianët e "The New Stations", një ekip pa shumë eksperiencë në arenën evropiane dhe mëse i kalueshëm për Shkëndijën që në dy vitet e fundit ka kaluar tre xhiro në "Europa League" duke u eliminuar në plej-of nga Genti dhe Milani. Edhe pse bënin pjesë në vazon e skuadrave jo-favorite fati i buzëqeshi Shkëndijës që kapi një prej kundërshtarëve më të dobët të vazos së parë duke evituar një përballje të mundshme me ekipe të mëdha si Apoel Nikosia, Karabag, Sherifi i Tiraspolit apo hungarezët e Videoton, klube të cilat ishin në vazon e kundërshtarëve të mundshëm të Shkëndijës. Ndryshe, pasi kanë mësuar kundërshtarin, ka folur trajneri Qatip Osmani. Ai ka vlerësuar pozitivisht shortin, mirëpo në të njëjtën kohë kërkon kujdes dhe respekt për oponentin nga Uellsi. "Skuadra nga Uellsi ndoshta ka qenë kundërshtari më i dëshirueshëm prej favoritëve që ishin në këtë vazo dhe që kishin mundësi ti bien Shkëndijës. Kur them më i dëshirueshëm nuk them se është kundërshtar i dobët. Përkundrazi, bëhet fjalë për një ekip i cili në Evropë pa 50 ndeshje, kurse në kampionat është shpallur 12 herë kampion, që donë të thotë se bëhet fjale për një ekip serioz, megjithatë ne do të bëjmë çmos që ta kalojmë këtë xhiro. Edhe tek lojtarët ekziston një optimizëm se ky kundërshtar duhet të kalohet", deklaroi Osmani. Nëse UEFA nuk sjell ndryshime plotësuese, shorti përcaktoi Shkëndijën vendase në ndeshjen e parë që do të luhet më 10 ose 11 korrik, ndërsa takimi i kthimit në Uells do të zhvillohet më 17 ose 18 korrik.

## NË XHIRON E DYTË KUNDËR TORPEDOS OSE SHERIF TRIASPOL

Në rast se skuadra e Shkëndijës arrin ta eliminojë skuadrën e TNS, në xhiron e dytë kualifikuese të Ligës së kampionëve do të ballafaqohet me më të mirin nga përballja mes Torpedo nga Gjeorgjia dhe Sherif Triaspol nga Moldavia. Favorit në këtë përballje është skuadra nga Moldavia, që donë të thotë se Shkëndija do të ballafaqohet me skuadrën e Sherif, kuptohet nëse në xhiron e parë eliminon skuadrën nga Uellsi.

### EDHE KUKËSIT I BUZËQESH FATI

Një kundërshtar nga Malta për Kukësin në turin e parë kualifikues të "UEFA Champions League". Verilindorët peshkuan kampionen e shtetit ishullor skuadrën e Valletës. Në shortin e hedhur në Nion të Zvicrës, Kukësi bënte pjesë në vazon e skuadrave favorite për shkak të koeficientit të lartë në renditjen e UEFA-s për klube dhe parashikohej një short i lehtë në letër për nënkampionët e Shqipërisë të cilët zëvendësojnë Skënderbeun në këtë kompeticion. Një rival mëse i kalueshëm për Kukësin pasi edhe pse Valleta është skuadra me më shumë emër në Maltë dhe merr pjesë rregullisht në kompeticionet evropiane ka pak eksperiencë dhe është një klub me një buxhet modest. Kukësi eviton Spartak Trnavën kundërshtarin më të rrezikshëm me të cilin mund të përballej në këtë raund. Ndeshjen e parë verilindorët do ta zhvillojnë në Shqipëri në datën 11 ose 12 korrik ndërsa atë të kthimit 1 javë më pas në kryeqytetin e Maltës, Valleta.

SHKËNDIJA (Maq) - The New Saints (Uell)
Torpedo Kutaisi (Gjeo) - Sheriff (Mol)
Suduva (Lit) - APOEL (Qip)
Olimpia Lubjana (Sll) - Karabak (Azer)
F91 Dudelanzh (Luks) - Videoton (Hun)
Fituesi i raundit paraeliminator - Malme (Sue)
HJK Helsinki (Fin) - Vikingur (Ishujt F)
Ludogorets (Bull) - Krusaders (Irlanda V.)
Kork Siti (Irl) - Legia V. (Pol)
Valur Rejkjavik (Isl) - Rosenborg (Nor)
KUKËSI (Shqi) - Valletta (Mal)
Flora Tallinn (Est) - Hapoel B.Sh. (Izr)
Spartaks J. (Lit) - Crvena Z. (Ser)
Alashkert (Arm) - Seltik (Sko)
Spartak T. (Sllovaki) - Zrinjski (BeH)
Astana (Kaz) v Sutjeska (Mali Zi)

### DRITA E PAFAT

Nuk pati të njëjtin fat Drita. Skuadra kampione e Kosovës nëse arrin të fitojë raundin paraeliminator që do të zhvillohet në Gjibraltar do të ketë përballë në turin e parë kualifikues të "Champions League" skuadrën suedeze të Malmes, me ndeshjen e parë që do të zhvillohet në Kosovë gjithmonë në rast kualifikimi të skuadrës gjilanase.

# Batha, përforcimi i ri i Shkëndijës?



*Shkup, 19 qershor* - Idriz Batha pritet të jetë futbollisti më i ri Shkëndijës së Tetovës. Ish-mesfushori i Partizanit, i cili vetëm pak ditë më parë zyrtarizoi largimin nga të kuqtë, mësohet se do të jetë blerja më e re e kuqezinjve të Tetovës", bën të ditur "Supersport", transmeton gazeta KOHA. Batha pritet të firmosë një kontratë 2-vjeçare me Shkëndijën, ndaj prej të dielës në mbrëmje ka udhëtuar drejt Tetovës për të finalizuar marrëveshjen me kampionët e Maqedonisë. Kështu Batha te Shkëndija pritet të zërë vendin e lënë bosh nga Ferhan Hasani, i cili ka vendosur të mos rinovojë kontratën, pasi është në pritje të një tjetër aventure jashtë Maqedonisë. Skuadra tetovare deri më tani ka rinovuar me Armend Alimin, Visar Musliun, Izair Eminin, Bazhe Todorovski e Mevlan Muratin si dhe ka afruar disa lojtarë të rinj si Remizfaik Selmani e Kostandin Çeshmexhiev. Batha ishte një ndër lojtarët kryesorë të Partizanit për 4 sezone me radhe, duke qenë titullar i padiskutueshëm madje edhe kapiten në sezonin që sapo u mbyll.

# Shkupi në Çair sjell talentin Veliu

*Shkup, 19 qershor* - Skuadra e Shkupit derisa po vazhdon përgatitjet për fazën e parë të Ligës së Evropës, kryesia e klubit po kërkon që investimet ti bëjë në futbollistë të talentuar, të cilët në të ardhmen pritet të jenë perspektivë e futbollit vendor. Prej dje FC Shkupit i është shtuar edhe një emër i ri. Fjala është për 20 vjeçarin Artan Veliu, i cili vjen nga Gostivari, bëjnë të ditur nga klubi bardhekaltër, transmeton gazeta KOHA. Veliu ka një karrierë me disa ekipe, ndërsa kishte filluar të luaj me gjeneratat e reja te KF Shkëndija, që më pas të transferohet te SC YF Juventus Cyrih në Zvicër, ndërsa nga Zvicra do të kaloj në Sllovaki për të veshur fanellën e skuadrës FC Haniska. Sezonin që lamë pas ai luajti me ekipin e seniorëve të KF Gostivari ku tregoi paraqitje të mrekullueshme, duke e mbyllur sezonin në pozitën e dytë në tabelë dhe ishin në ndeshjen e balotazhit, që Gostivari nuk arriti të luajë ndeshjen për kualifikim në Ligën e Parë. "Falënderoj Zotin e madh dhe shfrytëzoj rastin të përshëndes edhe kryesin dhe trajnerin e FC Shkupit që më kanë dhënë besimin të jem pjesë e kësaj skuadre", ka thënë shkurt talenti Veliu. Shkupi dhe Veliu kanë nënshkruar kontratë një vjeçare. Ndërkohë, kryesia e klubit ka arritur të nënshkruaj kontratë profesionale me futbollistin Fati Ismaili, me të cilin është arritur akord për besnikëri dy vjeçare.



Republika e Maqedonisë

**INSTITUCIONI PUBLIK PËR PËRKUJDESJE TË FËMIJËVE ME PROBLEME EDUKATIVE SOCIALE DHE SJELLJE TË PAHIJSHME SHKUP**

Në bazë të nenit 110 e të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), ndërsa në lidhje me nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18) dhe Rregulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësim të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe evidentimit të regjistrit të personave që kanë dhënë informacione të pavërteta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15), UD Drejtori i IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukative sociale dhe sjellje të pahijshme publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 2/2018**
**Për punësim për kohë të pacaktuar të 14 (katërmbëdhjetë) ofruesve të shërbimeve publike të kategorisë A profesionale (Edukatorë) në Institucionin publik për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukative sociale dhe sjellje të pahijshme në vendet e punës në vijim**

1. **SOZ0303A05014 Edukator –** nëpunës i pavarur profesional në IMS të nivelit të pestë, 14 (katërmbëdhjetë) realizues**:**
   - **Shërbimi për jetesë të përbashkët të fëmijëve me probleme edukative sociale**
     - Njësia organizative 1 – 2 (dy) realizues
     - Njësia organizative 2 – 2(dy) realizues
     - Njësia organizative 3 – 4 (katër) realizues
     - Njësia organizative 4 – 4 (katër) realizues
     - Njësia organizative 5 – 2 (dy) realizues

**Kushtet e përgjithshme**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

**Kushtet e posaçme**
- Për nivelin A5 të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (për realizuesit në njësinë organizative 1, njësinë organizative 3, njësinë organizative 4, njësinë organizative 5 – **Punë sociale dhe politikë sociale, Psikologji dhe Pedagogji,** njësinë organizative 2 **– Punë sociale dhe politikë sociale, Psikologji dhe Defektologji**) dhe së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale,
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

**Kompetencat e përgjithshme të punës në nivel të mesëm:**
- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Realizim të rezultateve,
- Punë me të tjerë/punë ekipore,
- Orientim ndaj palëve/palët e prekur dhe
- Menaxhim financiar

**Orari i kohës së punës:**
- **Ditët e punës**: e hënë – e premte
- **Orët e punës në javë**: 40 orë,
- **Orari i punës**:
  - Ndërrimi i parë: prej 07:00 deri më 14:00,
  - Ndërrimi i dytë: prej 13:00 deri më 20:00,
  - Ndërrimi i tretë: prej 20:00 deri më 07:00

Orari i punës mund të adaptohet në pajtim me nevojat e punëdhënësit.
**Neto shuma e pagesës në të holla**: 23.197,00 denarë
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit).
Fletëparaqitja për shpalljen mund të merret nga arkivin i institucionit ose të shkarkohet nga internet faqja e IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukative sociale dhe sjellje të pahijshme – www.domzadeca.mk.
Kandidatët obligohen që fletëparaqitjen ta parashtrojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike pas përfundimit të të njëjtës do të informohen për kohën dhe vendin për kontrollimin e besueshmërisë së dëshmive dhe realizimin e intervistës, në internet faqen e IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukative sociale dhe sjellje të pahijshme - www.domzadeca.mk.
Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në formë origjinale ose kopje të vërtetuar në noter.
Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dokumentet e nevojshme për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme:
- Certifikatë të shtetësisë,
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore,
- Vërtetim/Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Dëshmi për përvojë përkatëse të punës,
- Dëshmi – Diplomë/Certifikatë për arsim të mbaruar,
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim për vitin 2018, punësimet janë paraparë për 9 (nëntë) shqiptarë, 2 (dy) romë, 1 (një) serb, 1 (një) boshnjak dhe 1 (një) – të tjerë.
**Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët ta parashtrojnë në arkivin e institucionit në rr. "Petar Manxhukov" pn Shkup, me shenjë "Për shpallje publike 02/2018"**
Fletëparaqitjet e dorëzuar pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Kontakt telefoni: 02 2 611 016 / 070 244 725,
E-mail adresa: juzdvsp-sk@mtsp.gov.mk/ ose violetamasevska@gmail.com

**UD DREJTOR**
**Daniell Aleksovski**

---

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 35/18), nenit 20-a dhe 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në SHFK "Koço Racin" Kratovë nr. 01-201/2 nga 04.05.2015, Pëlqimit për mjetet e siguruara financiare nga MASH nr. 12-1132/1 nga 30.01.2018 dhe Planit vjetor për punësim për vitin 2018 nr. 04-92/1 nga 24.03.2017 dhe Vendimit të Drejtorit nr. 04-303/1 nga 18.06.2018, SHFK "Koço Racin" Kratovë publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për punësim të kuadrit jomësimor për kohë të pacaktuar të punës**

**I. Kuadri jomësimor (teknik)**
**1.** OBN 04 01 A01 002 Mirëmbajtës i higjienës **– 1** realizues me orar jo të plotë të punës (20 orë), neto pagesa fillestare në shumë prej 6.033,00 denarë;
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme është e nevojshme që:
- Të ketë të mbaruar arsimin fillor ose arsimin e mesëm;
- Me ose pa përvojë pune;

Orari ditor i punës është prej ora 06.00 deri ora 10.00, çdo ditë pune prej ditës së hënë deri ditën e premte. Punëtori ka të drejtë për pushim ditor dhe javor.
***Dokumentet e nevojshme për aplikim:***
- Fletëparaqitje për punësim në formë me shkrim;
- Dëftesë ose Diplomë për arsim të mbaruar përkatës (*origjinal ose kopje të vërtetuar në noter*);
- Certifikatë të shtetësisë; (*origjinal*)
- Vërtetim për përvojë pune; (*nëse ka*)

*Vërejtje:* Punësimet e parapara në pajtim me Planin vjetor për punësim të SHFK "Koço Racin" Kratovë për vitin 2018 janë: Maqedonas(e) 1.
**Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.**
Vendimi për zgjedhje do të sillet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje në shpalljen publike.
Dokumentet e nevojshme parashtrohen në adresën e shkollës "Mihaillo Apostollski" nr. 11 Kratovë ose drejtpërdrejtë në arkivin e shkollës.
Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
**SHFK "Koço Racin" Kratovë**

---

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 pika 7 dhe nenit 128 paragrafi 3 dhe nenit 132 paragrafi 5 dhe 6 e LAF (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 119/2014, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2016, 145/2015, 30/2016 dhe 67/2017 ), Këshilli i shkollës së SHFK "Kiril i Metodi" – Sveti Nikole publikon:

SHPALLJE

Për zgjedhje të drejtorit të SHFK "Kiril i Metodi" Sveti Nikole

Për drejtor të shkollës fillore zgjidhet personi i cili krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj duhet të përmbushë edhe kushtet në vijim:

Dokumentacioni i nevojshëm

- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar
- Të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional
- Biografi të shkurtë
- Vërtetim për përvojë pune
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë
- Vërtetim për përvojën e punës prej së paku 5 vjet në punë edukativo arsimore
- Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Programi për punë për periudhë prej 4 (katër) viteve.

Orari i punës prej ora 07,oo deri në ora 15,oo, neto pagesa bazë 26.762 denarë
Shpallja zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit të shpalljes. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve pas kalimit të afatit të shpalljes. Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen te këshilli i shkollës së SHFK "Kiril i Metodi" Sveti Nikole rr. "Angell Trajçev" nr. 40.

Këshilli i shkollës së SHFK "Kiril i Metodi" Sveti Nikole
Personi për kontakt Kiro Panev 032 / 443 -110

---

KORRIGJIM I SHPALLJES SË PUBLIKUAR MË DATË 18.06.2018
PËR PUNËSIM TË 7 (SHTATË) PERSONAVE PËR KOHË TË CAKTUAR NË DREJTORINË PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

1. Bashkëpunëtor i ri arkivist – bibliotekist, në departamentin për punë juridike Sektori për punë të përbashkëta – 1 realizues

Korrigjim: në vend të dy vjet përvojë pune bëhet korrigjim dhe duhet të qëndrojë
- **me ose pa përvojë pune në profesion**

5. Referent i pavarur – arkivues, departamenti për inspektorat të përgjithshëm - 1 realizues

Korrigjim: në vend të me ose pa përvojë pune bëhet korrigjim dhe duhet të qëndrojë
- **së paku 3 vjet përvojë pune në profesion**

6. Referent i pavarur për drejtim, mirëmbajtje dhe servisim të mjeteve tekniko-materiale, pajisjeve dhe korrier në DRDMSH Manastir, Sektori për operativë dhe logjistikë – 1 realizues

Korrigjim: në vend të me ose pa përvojë pune bëhet korrigjim dhe duhet të qëndrojë
- **së paku 3 vjet përvojë pune në profesion.**

7. Këshilltar për planifikim, organizim dhe realizim të masave për mbrojtje dhe shpëtim në DRDMSH – Krushevë – 1 realizues,

Korrigjim: - në vend të mbrojtje ose shkenca juridike bëhet korrigjim dhe duhet të qëndrojë
- **mbrojtje, arsim ose shkenca politike**
  - në vend të me ose pa përvojë pune bëhet korrigjim dhe duhet të qëndrojë
- **së paku 3 vjet përvojë pune në profesion**

**Afati për parashtrimin e dokumentacionit të nevojshëm është tetë (8) ditë nga dita e korrigjimit të publikuar në shtypin ditor.**
**Dokumentacioni i nevojshëm duhet të parashtrohet në adresën në vijim: Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim të RM në rrugën "Vasko Karangelleski" nr. 8 – Shkup – Aerodrom (kazerma Goce Dellçev) me shenjë për Shpallje për punësim.**

---

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160, 164-b të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), UD Drejtori i IPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR NEUROKIRURGJI ka sjellë:

VENDIM
Për anulim të shpalljes publike

1. Shpallja publike nr. 03-663/1 të datës 11-06-2018 , të publikuar më 13-06-2018 për punësim të 1 (një) doktor të medicinës specializant i neurokirurgjisë dhe 6 (gjashtë) motrave medicinale për kohë të pacaktuar **ANULOHET.**

2. Ky Vendim futet në fuqi në ditën e sjelljes.

Arsyetim
Shpallja publike nr. 03-663/1 e datës 11-06-2018, të publikuar më datë 13-06-2018 për punësim të 1 (një) doktor të medicinës specializant i neurokirurgjisë dhe 6 (gjashtë) motrave medicinale për kohë të pacaktuar të publikuar në Nova Makedonija, Veçer dhe Koha anulohet për shkak të mangësive teknike**.**
Kandidatët të cilët deri tani kanë parashtruar dokumentet mund ti marrin nga arkivi i IPSH Klinika universitare për neurokirurgji, për çka do të informohen edhe personalisht. Pas mënjanimit të mangësive teknike të shpalljes publike i njëjti do të publikohet serish.
Në bazë të asaj të theksuar më lartë u vendos si në dispiozitiv të këtij vendimi.

U. D Drejtor
Ass m-r sci d-r Vlladimir Rendevski

---

**Nr. P 688/2018**

**SHPALLJE PUBLIKE**
**(në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)**
Përmbaruesi Vanço Markovski duke vepruar në bazë të kërkesës për përmbarim të kreditorit Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime SIGNAS-AGRO SHPKNJP eksport-import f. Veleshtë nga Struga me seli në f. Veleshtë, kundër borxhliut Sanija Fejzullai nga Çellopeku me NVP dhe vendbanim në f. Çellopek, për shkak të realizimit të kërkesës në të holla në shumë prej 276.300,00 denarë **më datë 18.06.2018**

**FTON**
Borxhliun Sanija Fejzullai e lindur më datë 02.12.1953 nga f. Çellopek me vendbanim në f. Çellopek të paraqitet në zyrën e përmbaruesit në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për shkak të dorëzimit të Urdhëresës për përmbarim Nr. P 688/2018 të datës 12.06.2018, në përpiluar në bazë të nenit 166 të LP, të shënuar me **NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITË,** duke konsideruar nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit.
**PARALAJMËROHET** borxhliu Sanija Fejzullai se mënyra e këtillë e parashtrimit konsiderohet si e rregullt dhe për pasoja negative që mund të dalin i bartë vet pala.
Kjo shpallje paraqet **SHPALLJEN e dytë** të thirrjes publike.

**PËRMBARUES**
**Vanço Markovski**

---

**I nr. 1823/2017**

**SHPALLJE PUBLIKE**
(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përmbarim Gazeta Zyrtare nr. 72 e datës 12.04.2016 )
Përmbaruesi **Aleksandar Kuzmanovski** nga **Gostivari** në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori **Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup** nga Shkupi me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, bazuar në dokumentin përmbarues ODU nr. 1747/13, ODU nr. 1748/13 të datës 15.11.2013 të Noter Sebaedin Dauti – Gostivar, kundër borxhlinjve **1. Xhezmi Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë **2. Gjumazije Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, **3. Fatime Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe **borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai** nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 12.064.787,00 den., më datë 18.06.2018:

**FTON**
Borxhlinjtë **Xhezmi Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, **Gjumazije Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë, **Fatime Emro** nga Gostivari me seli në f. Llakavicë dhe **borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai** nga Gostivari me seli në rr. Nikolla Parapunov nr. 236 për shkak të dorëzimit të:

**-Vlerësim të vlerës së pronës së patundshme nr. 0302-26/2018 të datës 27.04.2018 të NT Zaharievski Konsalting Tetovë,**
**-Konkluzion për përcaktim të vlerës së patundshmërisë në bazë të nenit 177 të LP P nr. 1823/2017 të datës 28.05.2018,**
**-Konkluzion për Shitje publike me gojë në bazë të nenit 179 paragrafi (1), nenit 181 paragrafi (1) dhe nenit 182 paragrafi (1) e LP P. nr. 1823/2017 të datës 28.05.2018.**
**Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në mjetet e informimit.**
**PARALAJMËROHEN borxhlinjtë Xhezmi Emro, Gjymazije Emro, Fatime Emro dhe borxhliu pengmarrës Shukrije Mulai,** se mënyra e këtillë e parashtrimit konsiderohet si e dorëzim i rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pala.
**KJO PARAQET SHPALLJEN E PARË.**

**Përmbarues**
**Aleksandar Kuzmanovski**



Në bazë të nenit 3 dhe nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), Rregullores për sistematizim të vendeve të punës të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup – Fakulteti i medicinës (Aneksi 5) dhe pajtimeve për punësim nga Ministria e financave të RM nr. 18-5854/2 nga 22.05.2018, nr. 18-5850/2 nga 22.05.2018 dhe korrigjimit nr. 18-5850/4 nga 01.06.2018, Dekani i Fakultetit të medicinës në Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE NR. 01/2018

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup – Fakulteti i medicinës – Shkup – ka nevojë të punësojë për kohë të pacaktuar me orar të plotë të punës të 4 (katër) personave për kryerje të punëve dhe detyrave të punës në vendin e punës në vijim:

1. Doktor i medicinës 1 (një) realizues për Institutin për patologji;
2. Doktor i medicinës 1 (një) realizues për Institutin për histologji;
3. Farmaceut i diplomuar/Magjistër i farmacisë 1 (një) realizues për Institutin për patologji;
4. Laborant 1 (një) realizues për Institutin për fiziologji patologjike dhe medicinë nukleare.

Kandidatët e interesuar për paraqitje në shpallje duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për punësim:

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase,
- Me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme
- Arsim sipëror të mbaruar – Fakulteti i medicinës – të arritura së paku 360 kredi sipas SETK ose shkallë të VII sipas Kornizës së Maqedonisë për kualifikime (për vendin e punës me nr. 1 dhe 2);
- Arsim sipëror të mbaruar – Fakulteti i farmacisë – programi studimor të arritura së paku 300 kredi sipas SETK ose shkallë të VII sipas Kornizës së Maqedonisë për kualifikime (për vendin e punës me nr. 3);
- Arsim të mbaruar të shkallës VA sipas Kornizës së Maqedonisë për kualifikime dhe së paku të arritura 60 kredi sipas SETK ose arsim të mesëm (për vendin e punës me nr. 4);
- Posedim të licencës për punë (për vendin e punës nr. 1 dhe 2);
- Me ose pa përvojë pune (për të gjitha pozitat);
- Njohje të punës me kompjuter (për të gjitha pozitat); dhe
- Njohje të gjuhës angleze ose gjuhë tjetër të huaj (për të gjitha pozitat).

Si shtojcë e fletëparaqitjes, ndërsa si dëshmi për plotësimin e kushteve, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Biografi personale (CV) e domosdoshme me të dhëna për kontakt (adresë të banimit ose qëndrimit, numri i telefonit dhe e-mail adresë)
-Shtetësi
- Certifikatë (diplomë) për mbarim të arsimit sipëror (me mesatare të suksesit) në kopje të vërtetuar në noter
- Licencë për punë (për vendet e punës nr. 1 dhe 2) në kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë mjeku për aftësi të përgjithshme shëndetësore jo më të vjetër se 6 muaj, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Fotokopje të letërnjoftimit
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa të zgjasin pasojat e ndalesës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Kandidatët të cilët kanë përfunduar arsimin përkatës jashtë vendit duhet të posedojnë:
- Diplomë të nostrifikuar me arsim përkatës;
- Dokument për ekuivalencë të notave, të dhëna nga Ministria e arsimit dhe shkencës.

- Neto pagesa fillestare (për vendin e punës nr. 1): 31.712,00 denarë
- Neto pagesa fillestare (për vendin e punës nr. 2) : 28.726,00 denarë
- Neto pagesa fillestare (për vendin e punës nr. 3) : 31.712,00 denarë
- Neto pagesa fillestare (për vendin e punës nr. 4) : 21.969,00 denarë

Orët e punës në javë për të gjitha vendet e publikuara të punës: 40. Orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00. Ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet ti plotësojnë në momentin e paraqitjes. Dokumentacioni i vonuar, i pakompletuar dhe i parregulluar, nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e Fakultetit.

Me kandidatët të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të rregulluar për vendin e punës do të realizohet intervistë për të cilën do të informohem me shkrim.

Afati për paraqitje në shpallje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Si ditë të parë të publikimit llogaritet dita e publikimit të fundit në shtypin ditor. Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme dorëzohen deri në arkivin e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup – Fakulteti i medicinës – Shkup, rr. 50-ta Divizija nr. 6, 1000 Shkup, me shenjë për: “SHPALLJE nr. 01/2018”.

Universitetiti “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup
Fakulteti i medicinës – Shkup

---

QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1, pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për kulturë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98; 49/03; 82/05; 24/07; 116/10; 47/11; 51/11; 136/12; 23/13; 187/13; 44/14; 61/15; 154/15, 39/16 dhe 11/18) dhe në lidhje me nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit për muze (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 66/2004, 89/2008, 116/2010, 51/2011, 88/2015, 152/2015 dhe 39/2016), Kryetari i Qytetit të Shkupit publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit Publik**
**„ Muzeu i Qytetit të Shkupit“ – Shkup**

1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
   - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
   - në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
   - të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;
   - ka minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave për punë;
   - ka një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

   TOEFEL IBT – më së paku 74 pikë,
   IELTS (IELTS) - më së paku 6 pikë,
   ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2 (B2),
   FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të përfunduar
   BULATS (BULATS) - më së paku 60 pikë ose
   APTIS (APTIS) - më së paku nivel B2 (B2)

**Vërejtje: nëse kandidati nuk e plotëson kushtin nga pika 1 alineja 5 të shpalljes për njohjen e gjuhës angleze ka si obligim ligjor ta plotësojë të njëjtin në afat kohor prej një viti nga dita e emërimit të tij, në të kundërt i ndërpritet mandati** (në përputhje me nenin 9 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kulturë – Gazeta zyrtare e R.M. nr.11/2018).

2. Kandidatët janë të obliguar që përveç dëshmive për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:
- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër
- Dëshmi për stazh pune
- Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit

3. Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët janë të obliguar ta deponojnë në origjinal ose kopje të vërtetuar te noteri.
4. Afati për deponimin e dokumentacionit të nevojshëm është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
5. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i pakompletuar dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet e shpalljes publike deponohen në adresën e mëposhtme:

**Institucioni publik “Muzeu i Qytetit të Shkupit” – Këshilli drejtues**
**(për konkursin)**
**Adresa e institucionit: „Shën Kirili dhe Metodij“ p.n.**
**1000 Shkup. R. e Maqedonsë**

**Qyteti i Shkupit**
**Kryetari i Qytetit të Shkupit**

**Petre Shilegov**

---

**UNIVERSITETI “SHËN KIRILI DHE METODI”**
**FAKULTETI FILOLOGJIK « BLLAZHE KONESKI » SHKUP**

Bul. Krste Misirkov pn 1000 Shkup, R. Maqedonisë
Dekanat: +389 2 3240 401, Qendra: +389 2 3240 400
Faks: +389 2 3223-811

Nr. ____________________
____________________
Shkup

Në bazë të nenit 175 paragrafi 2 dhe nenit 176 paragrafi 1 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82 e 8 maj 2018) dhe dispozitat nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe tituj bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, të sjellë në mbledhjen e 15 të Senatit universitar më datë 26.12.2013, Dekani i Fakultetit filologjik “Bllazhe Koneski” në Shkup pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, publikon

**KONKURS**
Për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor

- Një mësimdhënës (në të gjitha titujt) në sferën mësimore – shkencore Albanologji (Sintaksa e gjuhës shqipe 1, Sintaksa e gjuhës shqipe 2, Gramatika e gjuhës shqipe 7 dhe Gramatika e gjuhës shqipe 8).

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme me Ligjin për arsim të lartë të RM dhe Rregulloren për kriteret e vetme dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.
Marrëdhënia e punës bëhet për kohë të pacaktuar.

Fletëparaqitjet, shtojcat (biografi, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, realizime pedagogjike dhe të tjera nga fillimi i karrierës e deri në ditën e paraqitjes), dëshmitë se kandidatët kanë arritur shkallën e caktuar shkencore magjistër, gjegjësisht doktor të shkencave filologjike, nga fusha shkencore për të cilën zgjidhen, dërgohen në 4 (katër) kopje në Arkivin e Fakultetit filologjik “Bllazhe Koneski” në Shkup, në afat prej 8 ditëve nga publikimi i Konkursit.

Përveç asaj kandidatët duhet të dorëzojnë edhe nga një kopje të punimeve shkencore dhe profesionale.

Fillimi, përfundimi dhe orari i punës dhe shuma në të holla e pagesës bazë për mësimdhënës janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin zgjidhet mësimdhënësi.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh për shqyrtim.

**DEKAN**
**i Fakultetit filologjik**
**Prof. Dr. Aneta Duçevska**

---

Në bazë të nenit 128 paragrafi 3 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM 103/2008), nenit 73 nga Statuti i SHF “Dame Gruev” – Manastir, Vendimit nr. 08-493/1 të datës 18.06.2018 nga Kryetari i Komunës së Manastirit, Këshilli i shkollës në mbledhjen më datë 19.06.2018 publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të SHF “Dame Gruev” – Manastir

1. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në punë edukativo arsimore;
- Të ketë të dhënë provimin për drejtor;
- Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

2. Me përjashtim, nëse nuk ka të paraqitur kandidat me provim të dhënë për drejtor, për drejtor mund të zgjidhet edhe personi i cili nuk ka të dhënë provimin për drejtor por obligohet të njëjtin ta japë në afat prej 1 viti nga dita e zgjedhjes për drejtor.

3. Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
- Diplomë për arsim të mbaruar;
- Vërtetim për përvojë të punës në institucion edukativo arsimor;
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;
- Program për punë për periudhë prej 4 vjet;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në gazetën ditore Slloboden Peçat, Nezavisen Vesdnik dhe Koha.
Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri te Këshilli i shkollës në rr. Gjorçe Petrov nr. 7, Manastir.

Këshilli i shkollës
SHF “Dame Gruev”
Manastir

---

Në pajtim me nenin 22 dhe nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM” nr. 143/2014 dhe 167/2015), si dhe pëlqimit për punësim për kohë të pacaktuar nga MASH (financim i vjetër) për vitin shkollor 2017/2018 nr. 12-2956/4 të datës 31.05.2018, SHFK “Goce Dellçev” Demir Hisar publikon

**SHPALLJE**
**për punësim për kohë të pacaktuar të punës së**

1. Një mirëmbajtës të higjienës me orar të plotë të punës me neto pagesë prej 12.000,00 denarë

Kushtet e përgjithshme janë:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Të ketë të mbaruar arsimin fillor,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Orari i punës gjatë javës është 40 orë punë, të shpërndarë gjatë ditës prej ora 06:30 deri në ora 14:30.

Kandidatët fletëparaqitjen së bashku me dokumentacionin e nevojshëm ta parashtrojnë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e publikimit në shtypin ditor ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të punës pas përfundimit të shpalljes.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme (Certifikatë të shtetësisë, Certifikatë të lindjes, Dëftesa për arsim të mbaruar dhe Certifikatë për evidencë penale) të parashtrohen drejtpërdrejtë në shkollë ose në adresën në vijim: SHF “Goce Dellçev” Demir Hisar, rr. Bitollska pn, 7240 Demir Hisar, tel. 047/276331.

UD Drejtor,
Valentina Reshnjak

---

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor dhe nenit 77 paragrafi 1 e Statutit të SHFK “Kiril i Metodi” f. Oraovica/Radovish, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më datë 19.06.2018 publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**
**Për zgjedhje të drejtorit të shkollës**

**Kushtet**: Për drejtor të shkollës fillore zgjidhet personi i cili krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, përmbushë edhe kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore dhe ka së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore, provim të dhënë për drejtor dhe test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.

Mandati i drejtorit zgjatë 4 (katër) vjet dhe fillon të rrjedhë prej ditës kur është sjellë Vendimi për zgjedhje nga ana e Kryetarit të komunës.

Kandidatët e interesuar krahas lutjes, duhet të parashtrojnë diplomë për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter), certifikatë për provim të dhënë për drejtor, certifikatë se nuk është i dënuar, vërtetim për përvojën e punës, certifikatë të shtetësisë dhe vërtetim/certifikatë për provim të dhënë psikologjik dhe test për integritet.

Shpallja publike zgjatë **5** (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në adresën e SHFK “Kiril i Metodi” f. Oraovica Radovish, ose në arkivin e Shkollës.

**Këshilli i shkollës pranë**
**SHFK “Kiril i Metodi” f. Oraovica**
**Kryetar, Marge Janeva**

# KATËR YJET E MËDHA QË U PËRJASHTUAN NË MES TË BOTËRORIT

Nuk është vetëm Kaliniç, ai i cili largohet në mes të Botërorit. Më herët kjo u ka ndodhur edhe katër futbollistëve tjerë si Xhonston (Skoci), Maradona (Argjentinë), Kin (Republika e Irlandës) dhe Anelka (Francë)

Kroacia zyrtarisht e ka konfirmuar largimin e sulmuesit të Milanit, Nikola Kaliniç. Trajneri i Kroacisë, Zllatko Daliç, ka thënë se i nevojiten lojtarë të gatshëm. Ai ka refuzuar të futet në lojë në vend te Mario Manxhukiç në ndeshje me Nigerinë. Por, Kaliniç nuk është i pari që përjashtohet për arsye disiplinore ose të tjera. "Në marrëveshje me stafin teknik, kryetrajnerin Zlatko Daliç, ne kemi vendosur që ta largojmë Nikola Kaliniç nga skuadra në Kampionatin Botëror. Kaliniç e ka lënë kampin në Roshçino të hënën për tu kthyer në Kroaci", thuhet në njoftimin e Federatës. Por, nuk është vetëm Kaliniç, ai i cili largohet në mes të Botërorit. Më herët kjo u ka ndodhur edhe katër futbollistëve tjerë si Xhonston (Skoci), Maradona (Argjentinë), Kin (Republika e Irlandës) dhe Anelka (Francë)



**UILLIE XHONSTON – SKOCI, ARGJENTINA 1978**

Skocia luante ndeshjen fillestare ndaj Perus në kampionatin e vitit 1978 në Argjentinë, ku Xhonston doli pozitiv në testet e dopingut dhe u përjashtua. Ai u përjashtua përgjithmonë nga Kombëtarja e tij.

**DIEGO MARADONA – ARGJENTINA, SHBA 1994**

Maradona i zhvilloi vetëm dy ndeshje duke shënuar një gol ndaj Greqisë, por doli pozitiv në testin e dopingut, pasi kishte përdorur efedrin (ephedrine). Në autobiografi, Maradona thotë se trajneri personal i kishte dhënë pa vetëdije.

**ROJ KIN – REPUBLIKA E IRLANDËS, KORE/JAPONI 2002**

Kapiteni Kin u dërgua sot në shtëpi pasi kritikoi përgatitjet e trajnerit para turnirit. MekKarty pas përjashtimit tha: "Unë nuk mund dhe nuk do të lejoj që të flas me mua në atë nivel, kështu që e dërgova në shtëpi".

**NIKOLAS ANELKA – FRANCË, AFRIKË E JUGUT 2010**

Anelka u dërgua në shtëpi pasi u raportua se e sulmoi trajnerin Rajmond Domeneç pas pjesës së parë kundër Meksikës ku ishin duke humbur 2-0. Incidenti u raportua më vonë nga mediat dhe lojtari nuk pranoi të kërkojë falje publike, ku u dërguan në shtëpi. Ditën tjetër, pjesa tjetër e skuadrës nuk pranoi të shkojë në stërvitje duke protestuar kundër dëbimit të Anelkës.

## "Lufta" e lojtarëve anglezë me insektet

Derisa Anglia hynte në fushë në "Volgograd Arena" të hënën në mbrëmje, ata kishin një kundërshtarë më shumë se Tunizinë me të cilin kishin për t'u ndeshur. Jesse Lingard, Rahim Sterling dhe Denni Uelbek ishin disa nga ata në mesin e atyre që u sulmuan. Insektet irrituan lojtarët, ku shihej Sterling, i cili ishte duke fërkuar fytyrën. Eshli Jang madje iu drejtua zhveshtoreve pasi ishte me pantallona të shkurtër. Uelbek, Henderson dhe Aleksander-Arnold, shfrytëzuan rastin dhe u mbuluan veten nga koka deri te këmbët. Megjithatë, ky nuk ishte fundi i çështjes, pasi lojtarët e të dyja skuadrave vazhduan luftën me insekte deri në mesnatë. Në këtë kohë të vitit insektet janë në çdo anë, udhëtojnë në tufa dhe janë të vogla. Zyrtarët e qytetit kishin thënë se kanë spërkatur zonën e Volgogradit dhe kënetat aty pranë, por pak ka pasur efekt. Duket se insektet janë një tipar i rregullt në verë në këtë qytet, për shkak të ajrit të ngrohtë dhe bazës së tyre pjellore që e vënë buzë lumit Volga.









## Brazili kërkon hetime për golin e Zvicrës

Përfaqësuesja braziliane ka vendosur të hidhet në sulm dhe të ushtrojë presion ndaj FIFA-s. Ajo ka kërkuar në një dokument zyrtar, që t'i dërgojë imazhe dhe audio të asaj që u tha në VAR, të dielën, gjatë ndeshjes kundër Zvicrës. Federata e Futbollit të këtij vendi nuk e kupton se si u dha goli i Zvicrës si i rregullt, rast në të cilën ka një shtytje të dukshme të Zuber ndaj Mirandas. Për pasojë, është kërkuar nga presidenti Infantino dhe institucioni që ai drejton, që të shpjegojë se si u veprua në atë ndeshje. "Selecao", gjithashtu, ka kërkuar të shqyrtojë penalltinë e mundshme për Gabriel Jesus në minutën e 74-t të ndeshjes. CBF bën tri pyetje: a ka dikush nga VAR-i, që të sugjerojë shqyrtimin kolegjial të këtyre veprimeve? A ka kërkuar arbitri meksikan, Cesar Ramos, të kërkojë një konsultim me anëtarët e VAR-it? Çfarë komunikimi ka pasur mes palëve?, pyesin nga përfaqësuesja e Brazilit.



MES ARMËVE DHE TOPIT

## Botërori vendos fatin e Son!



Son Heung-min është pa diskutim ylli i shndritshëm i Koresë së Jugut. Te sulmuesi i Totenhemit varen edhe fatet e një populli të tërë në Botërorin rus, pasi sytë e të gjithëve janë nga ai. Në sfidën debutuese ndaj Suedisë, Son nuk shkëlqeu dhe Koreja e Jugut u mposht 1-0 nga përfaqësuesja skandinave me një gol të Granqvist me penallti, 11-metërsh që u akordua nga ndërhyrja e VAR. Një humbje që i ka sjellë probleme jo vetëm kombëtares aziatike por edhe vetë sulmuesit që luan në Angli. Një eliminim që në fazën e grupeve do të ishte i rrezikshëm për fatet e Son. Siç raportojnë mediat angleze koha e tij po skadon dhe gjithçka ka të bëjë me faktin se Son duhet të kryejë shërbimin militar pra të marrë armët në dorë dhe t'i bashkohet ushtrisë koreano-jugore. Deri në moshën 28-vjeçare çdo qytetar koreano-jugor duhet të kryejë 2 vjet shërbim ushtarak. Megjithatë ligji nuk vlen njësoj për të gjithë pasi ka edhe përjashtime. Për momentin Son nuk do të shkojë në ushtri deri në verën e vitit 2019-të të paktën ky ka qenë vendimi paraprak i qeverisë koreano-jugore, por në rast të një eliminimi të shpejtë të Koresë së Jugut nga Kupa e Botës, shpëtimi i Son për të mos u qethur tullac do të jenë Lojërat Aziatike që do të zhvillohen në Indonezi mes muajve shtator dhe tetor të këtij viti por që ky eveniment nuk njihet nga FIFA dhe Totenhemi mund të mos e lejojë lojtarin të marrë pjesë, ndërsa shpëtimi i fundit mund të jetë Kupa e Azisë që do të mbahet në Emiratet e Bashkuara Arabe në janar të vitit tjetër aty ku duhet që Koreja e Jugut të shpallet kampione dhe Son të shkëlqejë në mënyrë që t'i shpëtojë edhe për ca kohë shërbimit ushtarak.

## DASHI 21. mars - 20. prill

Jeta ne çift do vije duke u përmirësuar dita ditës. Duke filluar qe sot do ia shprehni me shume ndjenjat atij qe keni ne krah dhe e ardhmja pritet te jete me e ndritur. Beqaret do kenë takime te shumta dhe ne fund te ditës do iu duhet te marrin vendime te rëndësishme. Ne planin financiar do jeni me te qete fale një shume qe keni marre kohet e fundit.

## DEMI 21. prill - 21. maj

Marrëdhënia juaj me partnerin do filloje te përmirësohet gjate kësaj dite. Do flisni me lirshëm për gjithçka qe iu mundon dhe do i zgjidhni brengat. Edhe për beqaret gjithçka do jete e mundur. Bëjini sytë katër sepse mundësitë për takime do jene te mrekullueshme. Me financat nuk do i keni punët shume mire, kështu qe duhet te mos shpenzoni pa kufij.

## BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Edhe pse marrëdhënia ne çift do jete shume e mire, nuk duhet te merrni vendime te rëndësishme për te ardhmen. Tregohuni pak me te duruar nëse doni qe gjithçka te shkoje për se mbari. Beqaret do tregohen impulsive dhe mund te bëjnë gabime te renda. Ne planin financiar ka mundësi t'iu gjeni zgjidhje te gjitha problemeve qe keni pasur me pare.

## GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeta ne çift do jete me e bukur gjate kësaj dite. Do rruani një komunikim te mire me partnerin dhe do kaloni momente mjaft sensuale. Për sa iu përket beqareve ata do vazhdojnë te jene ne kërkim te dashurisë se madhe, por pa ndonjë rezultat specifik. Ne planin financiar do jeni me fat dhe do arrini te rregulloni problemet qe iu kishin dale me herët.

## LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite shume e bukur kjo e sotmja për gjithë te dashuruarit. Do qëndroni me shume kohe pranë atij qe dashuroni dhe do i sqaroni përfundimisht te gjitha dilemat qe keni pasur. Beqaret duhet te tregohen me realiste dhe te mos ëndërrojnë gjera te paqena. Financat do jene te qëndrueshme kështu qe mund te bëni investimet e duhura pa pasur asnjë rrezik.

## VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Flisni me takt dhe diplomaci gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift sepse përndryshe do keni debate te shumta. Tregohuni edhe pak me te kuptueshëm. Beqaret do vazhdojnë edhe sot te kenë te njëjtin status kështu qe është e kote te mundohen te gjejnë një person. Ne planin financiar situata do jete e qëndrueshme. Përfitoni për te lare borxhet qe keni pasur.

## PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Çështjet e zemrës do shkojnë me se miri sot. Nuk do i mbani aspak mëri partnerit për ndonjë kritike qe do iu beje sepse do e kuptoni qe ai ka te drejte. Beqareve nuk do iu ecin gjerat shume mire. Kujdes me personat qe do iu joshin sepse edhe mund t'iu lëndojnë. Ne planin financiar do e përmirësoni situatën fale një shpërblimi qe do merrni nga puna.

## AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Nëse kohet e fundit marrëdhënia mes jush dhe partnerit ishte ftohur duhet te gjeni mënyrën e duhur për ta përmirësuar. Mos i lini gjerat pas dore sepse situata edhe mund te ndërlikohet. Beqaret do kenë takime shume interesante te cilat nuk duhet t'i humbin për asnjë lloj arsyeje. Financat do i menaxhoni me shume kujdes dhe maturi.

## SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ka rrezik qe rutina ta pushtoje gjate gjithë kohës jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Nuk do i kushtoni rëndësinë e duhur ambientit ne çift pa menduar se kjo mund te jete shkatërruese per ju. Beqaret duhet ta heqin turpin dhe ti shprehin me tepër ndjenjat. Me financat do keni disa probleme te vogla te cilat mund t'i zgjidhni nëse tregoheni te kujdesshëm.

## BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Bashkëpunimi do mbizotërojë gjate gjithë kohës sot ne jetën tuaj ne çift. Do filloni te thurni edhe projekte te rëndësishme për një te ardhme te ndritur bashke. Beqaret do ndihen shume mire me statusin qe kane dhe nuk do kërkojnë me ngulm te fillojnë një lidhje. Ne planin financiar nuk duhet te alarmoheni me problemin me te vogël. Me maturi mund te zgjidhni gjithçka.

## UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do jeni me humor te keq gjate kësaj dite dhe asgjë nuk do shkoje ashti si e kishit menduar ne çift. Zënkat me partnerin do jene shume te shpeshta. Beqaret do kenë takime te rëndësishme, por nuk duhet te nguten për asgjë. Ne planin financiar tregohuni me realiste dhe mos shpenzoni shuma te mëdha kur e dini qe situata nuk është aq e favorshme.

## PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Nëse ende jeni ne një lidhje, dita e sotme do jete e mrekullueshme. Si ju ashtu edhe ai qe keni ne krah do i kushtoni vëmendjen dhe përkushtimin e duhur njeri-tjetrit. Beqaret ka shume mundësi te gjejnë personin e tyre te ëndrrave. Hiqeni sa me shpejt turpin dhe lëreni veten te lire. Ne planin financiar do kryeni transaksione te rëndësishme qe do e përmirësojnë situatën.

## Fjalëkryq – Mensur Mamuti

Përkufizimet (sipas rendit në skemë):

- VENDLINDJA E AKTORIT NË FOTO
- MBËRRITJE
- KAFSHOHET LEHTË / FILM I AKTORIT NË FOTO
- K
- FSHAT AFËR LIQENIT TË STRUGËS
- ISH POLITIKANI IRAKIAN, AZIZ / QERRJA
- K
- KËNGËTARJA TURKE, XHAN / FUTBOLLISTI FRËNG, SAMYEL
- U
- AJNSHTAJNI
- SHUMA / BESËLIDHËS
- POETI KUMANOVAR, JAHIU
- IMPULSI
- ISH FUTBOLLISTI GJERMAN, HENES / E BËN TË FORTË SI GUR
- VARGMALE PËRGJATË OQEANIT PAQËSOR, KORDILERE
- AKTORI I FAMSHËM NË FOTO
- KOHA
- GRAMI / HYJNI ASIRIANE
- RAB EMIRATES / FILM I AKTORIT NË FOTO, "GJURMËT NË..."
- ALUMINI
- BANOR I NJË QYTETI SHQIPTAR / NDARJA NË LISTA
- D
- PËREMËR PRONOR
- QË BËN NAZE
- SHTETËSIA (E LINDJES) E AKTORIT NË FOTO
- SATANIC RITUAL ABUSE
- PARTNERJA E AKTORIT NË FOTO, DE HEVILEND / AJNSHTAJNIUMI
- ISH FUTBOLLISTI PORTUGEZ, ANTONIO SOUSA
- S. J. / E. A.
- ZORRO / RANISHTJA
- KUNDËR RELIGJIOZE
- REOMIRI
- ANGSTREMI / AGIM VINCA
- QË NUK MERREN ME FENË / TIRANA
- KRYETARI I 27-TË I SHBA-VE, UILIAM / KAFEHANE ME MUZIKË
- VATERPOLISTI KROAT, BALIQ / Ë
- T
- KRAHINË INDUSTRIALE NË GJERMANI




**ZGJIDHJET:** K, TARIK, KARROCA, SIBEL, UMTITI, AJN, SH, NEHAT, I, ULI, ANDE, G, AE, D, AUSTRALIAN, SRA, OLIVIA, TONEL, SJ, Z, ANTIFETARE, R, A, LAIKËT, TAFTI, MARO, TAVERNË, SAR.

## Sudoku

### shumë i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 4 | 8 | | 6 | | 3 | 9 | |
| 7 | | | 5 | 3 | | | | 4 |
| | | | | | | | | |
| | 5 | | | | 1 | 4 | | |
| 8 | 1 | | | | | | 5 | 9 |
| | | 4 | 2 | | | | 3 | |
| | | | | | | | | |
| 5 | | | | 9 | 8 | | | 2 |
| | 2 | 6 | | 7 | | 9 | 1 | |

### mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 8 | | | | 4 | | | |
| | 9 | | 7 | 8 | | | | |
| | | 6 | | | | | | 9 |
| 8 | | | | 4 | 7 | | 3 | |
| | 4 | | 8 | | 2 | | 1 | |
| | 2 | | 3 | 9 | | | | 8 |
| 9 | | | | | | 1 | | |
| | | | | 5 | 9 | | 6 | 7 |
| | | | 1 | | | | | 3 |

**Shumë i lehtë:** 148762395, 762539184, 935814726, 253981467, 817643259, 694257831, 489126573, 571398642, 326475918. **Mesatar:** 785914326, 293786451, 416235879, 861547932, 349862715, 527391648, 952673184, 138459267, 674128593.

# NASA në gjyq për shkak të pluhurit të Hënës



Laura Murray Cicco ngriti një padi kundër Agjencisë Amerikane të Hapësirës NASA në Gjykatën e Qarkut të SHBA në Kanzas. Bëhet fjalë për një masë parandaluese për të përcaktuar pronësinë e grimcave të Hënës që ajo posedon në rast që ndonjë një ekipi të NASA-s të mos i bie ndërmend të thotë se mostra është e tyre. Avokati i saj, Chris McHugh tha se Laura suvenirin nga Hëna e mori nga astronauti Neil Armstrong. NASA ka kohë që pretendon se i gjithë materiali i marrë nga Hëna iu takon autoriteteve amerikane. Por Cicco pretendon se mostra e Armstrong, njeriu i parë që shkeli sipërfaqen e Hënës, i dhuroi babait të saj, Tom Murray, i cili me astronautin u bë mik derisa po ndiqte mësimet në Departamentin e Inxhinierisë Aeronautike të Universitetit Cincinnati. Dhurata ishte dedikuar për Laura, e cila shoqërohet nga një mesazh që thuhet se e nënshkroi Armstrong dhe me të cilin astronauti i dëshironte asaj shumë lumturi.

## Efektet e vitaminës C në shëndetin tonë

Vitamina C i parandalon sëmundjet e enëve të gjakut të zemrës duke i rritur nivelet natyrale të glutationit, i cili i mbron arteret e zemrës. Vitamina C i forcon muret e enëve të gjakut duke mundësuar sintezën e kolagjenit në indet lidhëse të mureve arteriale. Vitamina C e përmirëson zgjerimin e enëve të gjakut dhe rrjedhimisht parandalimin e sëmundjeve të zemrës. Varësisht nga mosha që keni, ekspertët rekomandojnë të merrni 1000 mg vitaminë C në mëngjes dhe 1000 mg në mbrëmje por gjithashtu të hani edhe ushqime të pasura me vitaminë C, si brokoli, domatet, dredhëzat, portokajtë, etj.



# Seks në këmbim të lajmeve, gazetarja e NYT në telashe





Që në vitin 2013 shkruante "Dua të jem si Zoe Barns". Dhe pikërisht për të dashur të imitojë reporterët e "House of Cards", sot Ali Watkins, gazetare e "New York Times", ka përfunduar në telashe serioze. Në jetën e vërtetë, gazetarja ka pasur një lidhje me James Wolfe, ish-funksionar përgjegjës i sigurisë së Senatit, ku kishte marrë lajme të klasifikuara dhe gazeta e saj tashmë ka nisur një hetim për të.

Gazetarja është autore i një numri të madh investigimesh, duke filluar me ato të publikuara në Politico dhe Buzzfeed, dhe pastaj duke kaluar në NYT, ku shkarkohet në dhjetor 2017, pikërisht kur përfundon lidhja me zyrtarin e lartë. Përmes komisionit të inteligjencës të Senatit amerikan, për të cilin Wolfe ishte përgjegjëse, kanë kaluar hetimet më delikate parlamentare, duke filluar me "Russiagate". Ndër "scoop"-et e publikuara nga gazetarja, është edhe takimi i Carter Page, një prej këshilltarëve të Trump, i cili kishte takuar një ish-spiun rus gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2016. Wolfe përfundoi nën hetim dhe u arrestua më pas nga FBI, për zbulimin dokumenteve të dorëzuara nga shërbimet sekrete të sigurisë në komisionin e inteligjencës. Ai e ka mohuar, por pastaj doli që Wolfe ishte nën përgjim dhe mesazhet e telefonatat e tij të shkëmbyera me Watkins, u kapën të gjitha nga Drejtësia e SHBA.

# Vendoset busti i ri i Cristianos në aeroportin e Madeiras



Aeroporti i Madeiras, që mban emrin e Cristiano Ronaldos tashmë ka një bust të ri. Me nënshkrimin e familjes, këtë javë ka ndryshuar skulptura që ishte vendosur vitin e kaluar, pasi u bë virale për shkak të mos-ngjashmërisë së madhe me fytyrën e Cristianos. Skulptori i veprës, Emanuel Santos, mori shumë kritika për bustin e parë dhe kishte vendosur të krijoj një të re që e përfundoi në muajin mars, transmeton ksp. Këtë javë, më në fund busti i ri i Portugezit gjendet i vendosur në aeroportin Cristiano Ronaldo.




## KALENDARI HISTORIK 20 QERSHOR

656 - Ali ibn Ebu Talib zgjedhet kalif i Islamit.

1397 - Bashkimi i Kalmarit e themeluar mes Danimarkës, Suedisë dhe Norvegjisë.

1462 - Vlladi III tenton të vret Mehmedin II (Sulmi i natës) duke detyruar atë të largohet nga Vllahia.

1579 - Kryengritja anti-angleze në Irlandë.

1609 - Holanda, Anglia dhe Franca nënshkruajnë marrëveshje 12 vjeçare.

1631 - Mumtaz Mahal vdes gjatë lindjes. Burri i saj, Mughal, perandor Shah Xhahan I pastaj për 20 vjet ndërton varrin e saj, Taxh Mahal.

1938 - Japonia i shpall luftë Kinës.

1940 - Gjenerali De Gol largohet nga Bordo për në Londër.

1940 - BRSS okupon Estoninë.

1944 - Islanda shpall pavarësinë nga Danimarka.

1950 - Egjipti, Libani, Arabia Saudite dhe Siria nënshkruajnë pakt të sigurisë.

1980 - Led Zeppelin fillojnë turneun e tyre të fundit nëpër Evropë.

## A E DINI SE...



Këtë të diel është publikuar një studim i ri, pas një iniciative në të cilën synim ishte studimi i shëndetit të grave. Me theks është trajtuar shkaku se për çfarë më së shumti stresohen gratë. Dhe nga studimi i të dhënave, ka dalë se 37 për qind e grave stresohen për shëndetin e prindërve të tyre. Jo kaq edhe për fëmijët. Vetëm 23 për qind e afro dy mijë grave kanë deklaruar se i brengos shëndeti i fëmijëve dhe vetëm 15 për qind për bashkëshortët. "Kujdesi për fëmijët nuk është e vështirë, por është më e definuar dhe e parashikueshme", kurse është krejt e kundërta për prindërit", janë deklaruar gratë.

## BARSOLETA



**PROFESIONI I BURRIT**

- Çfarë është burri yt me profesion?
- Është agronom i nivelit muzikor?
- Si ashtu?
- Thjesht, i ruan dhentë dhe i bie fyellit.

## THËNIA E DITËS



Një person i tretë asnjëherë nuk krijon problem midis dy njerëzve. Është një problem midis të dyve që krijon hapësirë për personin e tretë!